



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

SHENJAT E KIJAMETIT DHE PARALAJMËRIMET PROFETIKE

Osman Abazi

Botuar nga: Përplekja Rinore

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit

PARATHËNIE	11
PARALAJMËRIMET KUR'ANORE	15
MREKULLIA E PËRHERSHME KUR'ANORE DHE PAMUNDËSIA E RIVALIZIMIT TË SAJ	16
REALIZIMI I PREMTIMIT TË ALL-LLAHUT SE DO TA MBROJË KUR'ANIN	18
ROMAKËT DO TË TRIUMFOJNË MBI PERSIANËT BRENDA PAK VITEVE	19
EBU LEHEBI DHE GRUAJA E TIJ DO TË VDESIN MOSBESIMTARË	21
POLITEISTËT DO TË PËSOJNË DISFATË NË BETEJËN E BEDRIT	21
MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE BESIMTARËT DO TË HYJNË NË MEKKE DHE PAS KËSAJ DO TË ÇLIROHET AJO	22
MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE MUSLIMANËT DO TË MBIZOTËROJNË NË TOKË	23
REALIZIMI I PREMTIMIT TË ALL-LLAHUT XHEL-LE SHANUHU SE MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE ISLAMI DO TË TRIUMFOJNË	25
MUSLIMANËT DO TË PASUROHEN MEQË KISHIN FRIKË VARFËRINË	25
MEKKA DO TË ÇLIROHET DHE NJERËZIT DO TË HYNË GRUPE-GRUPE NË FE	26
PREZENTIMI I ARGUMENTEVE TË GJALLA NË TRUPIN E NJERIUT DHE NË GJITHËSI, DERISA NJERËZIMI TË BINDET SE KJO FE ËSHTË E VËRTETË	27
AJETET KUR'ANORE RRETH ZBULIMEVE SHKENCORE BASHKËKOHORE JANË ARGUMENT I GJALLË SE KY KUR'AN ËSHTË FJALË E TË GJITHËDIJSHMIT	28
VIJAT NË MAJE TË GISHTËRINJVE NUK JANË TË NJËJTA TE ASNJË PERSON	29
LËKURA ËSHTË AJO QË NDJEN DHEMBJEN E JO I GJITHË TRUPI	29
GJITHËSIA ISHTE NJË TËRËSI PASTAJ FILLOI TË NDAHET DHE TË ZGJEROHET	30
DITA DHE NATA VAZHDIMISHT NDJEKIN NJËRA-TJETRËN	31

QIJEJT DHE TOKA QËNDROJNË MBI SHTYLLA TË PADUKSHME	32
SHTYPJJA ATMOSFERIKE ULET ME NGRITJEN NGA SIPËRFAQJA E TOKËS	33
NJERËZIMI DO TA KALOJË (DEPËRTOJË) RRUZULLIN TOKËSOR, POR VETËM ME NJË FUQI	33
NJERËZIMI DO TË PËRDORË MJETE TË TJERA TRANSPORTUESE PËRVEÇ GOMARIT, KALIT ETJ.	34
TOKA RROTULLOHET DHE KODRAT LËVIZIN SIKUR RETË NË QIELL	35
ERËRAT DËRGOHEN PËR MBARËSIM	35
QIELLI ËSHTË NJË CATI MBROJTËSE	36
LARGËSIA MES UJEVE DHE FSHEHTËSIA E VENDQËNDRIMEVE TË TYRE	37
DRITA E HËNËS ËSHTË E HUAZUAR, NDËRSA E DIELLIT ËSHTË NGA VETË AI	38
PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE NË FILLIM GJITHËSIA ISHTE TYM	39
PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE DIELLI LËVIZ DREJT NJË CAKU TË TIJ	39
PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE CDO GJË KRIJOI NË ÇIFT (DY LLOJE)	40
PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE EKZISTON TËRËSI MË E VOGËL SE ATOMI	41
MES DY DETEVE KA NJË MUR QË NUK LEJON TË PËRZIHEN	42
KODRAT JANË SHTYLLAT E TOKËS	42
BRENDIA E DETIT DHE E TOKËS ËSHTË E ZJARRTË DHE DETET DO TË NDIZEN	43
QIELLI DO TË ÇAHET DHE UJET DO TË SHUHEN	44
PARALAJMËRIMET E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM	46
PARALAJMËRIMET E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM TË CILAT U REALIZUAN ASHTU SIÇ I PARALAJMËROI AI	48

PARALAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR ÇDO GJË QË DO TË NDODHË DERI NË DITËN E KIJAMETIT	48
PËRCAKTIMI I VENDVRASJEVE TË POLITEISTËVE NË BEDR PARA VRASJES SË TYRE	49
PARALAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR VRASJEN E UDHËHEQËSVE TË BETEJËS SË MU'TES PARA ARDHJES SË LAJMIT	50
LAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR LETRËN E HATIBIT QË UA DËRGOI MEKKASVE	50
ÇLIRIMI I HAJBERIT TË NESËRMEN DHE SHËRIMI I SYVE TË ALIUT NGA LUTJA E TIJ	52
NJË LUFTËTAR QË LUFTONTE ME MUSLIMANËT ËSHTË PREJ BANORËVE TË ZJARRIT	53
NËNA E EBU HUREJRES (TRANSMETUESI I MADH I HADITHEVE) PRANON ISLAMIN NGA LUTJA E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM	54
UMERI DHE UTHMANI, RADIALLL-AHAU ANHUMA, DO TË VDESIN SHEHIDË	56
ALIU, RADIALLL-AHAU ANHU, GJITHASHTU DO TË BIE SHEHID	57
ÇLIRIMI I PERSISË DHE SHTIMI I PASURISË	57
ÇLIRIMI I SHAMIT DHE I EGJIPTIT	59
ARDHJA E UVEJS EL-KARNIT DHE PËRSHKRIMI I TIJ	60
HASANI, RADIALLL-AHAU ANHU, DO TË PAJTOJË DY GRUPE TË MËDHA TË MUSLIMANËVE	60
HUSEJNI, RADIALLL-AHAU ANHU, DO TË BIE SHEHID	61
MUSLIMANËT DO TA ÇLIROJNË KONSTANTINOPOJËN (STAMBOLLIN) DHE ROMËN	62
MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DO TË VDESË NGA SËMUNDJA E TIJ E FUNDIT DHE FATIMEJA (VAJZA E TIJ) ËSHTË E PARA NGA FAMILJA E TIJ QË DO T'I BASHKANGJITET	63
NË NJËRIN KRAH TË MIZËS ËSHTË SËMUNDJA KURSE NË TJETRIN ËSHTË SHËRIMI	64
PERSIANËT DO TË MARRIN FUND SË SHPEJTI, PËRGJITHMONË, KURSE ROMAKËT (SHTETET E PERËNDIMIT) DO TË MBIJETOJNË NDËR SHEKUJ ..	65
POPUJT DO TË BASHKOHEN KUNDËR MUSLIMANËVE ASHTU SIÇ BASHKOHEN NGRËNËSIT RRETH PJATËS	66

UMMETI ISLAM DO T'I IMITOJË POPUJT E TJERË, EDHE NËSE ATA HYJNË NË BIRËN E HARDHUCËS, DO TË SHKOJË PAS TYRE	66
GJENDJA POLITIKE E UMMETIT ISLAM DERI NË FUND TË KOHËS	67
LAJMET E KOHËS SË FUNDIT DHE SHENJAT E KIJAMETIT	69
DITA E KIJAMETIT PA DYSHIM DO TË VIJË	71
SHENJAT E VOGLA DHE SHENJAT E MËDHA	73
A ËSHTË AFËR KIJAMETI?!	73
ASKUSH POS ALL-LLAHUT NUK DI KOHËN E NDODHJES SË TIJ	74
SHENJAT E KIJAMETIT QË KANË NDODHUR	75
DËRGIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM DHE ÇARJA E HËNËS	75
ZJARRI I HIXHAZIT QË SHNDRITI BASRËN NË IRAK	76
NDËRPRERJA E XHIZJES DHE HARAÇIT	78
SHENJAT E KIJAMETIT QË KANË NDODHUR NJË HERË DHE MUND TË PËRSËRITEN PRAPË	79
ÇLIRIMET DHE LUFTËRAT	79
PARAQITJA E GËNJESHTARËVE DHE E PROFETËVE TË RREJSHËM	80
FRIKËSIMI NGA TRAZIRAT E SHPESHTA	81
1) VRASJA E HALIFIT TË FAMSHËM, UTHMANIT, RADIAL-LLAHU ANHU, DHE PËRÇARJA E UMMETIT:	82
2) TË GJITHA TRAZIRAT DHE LUFTËRAT QË NDODHËN MES MUSLIMANËVE QË NGA VRASJA E UTHMANIT E DERI NË DITËT TONA TË SOTME	84
CILA ËSHTË RRUGA E SHPËTIMIT NGA KËTO TRAZIRA?	84
MARRJA E POZITAVE TË NDRYSHME NGA ATA QË NUK JANË TË ZOTËT	87

PRISHJA, SHKATËRRIMI DHE FESADI I MUSLIMANËVE	88
ROBËRESHA LIND ZONJËN E SAJ DHE NGRITJA E TË ZBATHURVE, TË ZHVESHURVE DHE E BARINJVE TË DELEVE NË PALLATE	89
BASHKIMI I POPUJVE KUNDËR MUSLIMANËVE	90
SHTIMI I PASURISË, PËRHAPJA E MUZIKËS, E VEGLAVE MUZIKORE DHE KONSUMIMI I ALKOOLIT	91
DHËNIA SELAM VETËM ATYRE QË I NJOHIM, PËRHAPJA E TREGTISË DHE NDERPRERJA E MARRËDHËNIEVE ME TË AFËRMIT	92
ZHVLERËSIMI I VLERAVE DHE KRITEREVE	92
POLICIA E KOHËS SË FUNDIT E CILA RRAH DHE KEQTRAJTON QYTETARËT	93
PARAQITJA E TELEVISIONIT DHE AFRIMI I KOHËS	94
SHENJAT E KIJAMETIT QË ENDE NUK KANË NDODHUR	95
SHAFITJET (E TOKËS), DEFORMIMI (SHNDËRRIMI NË QENIE TË TJERA) DHE HEDHJA (NGA QIELLI) QË DO TË NDODHIN NË KËTË UMMET	95
FRYRJA E HËNËS SË RE	97
TË FOLURIT E EGËRSIRAVE DHE E GJËRAVE TË NGURTA	98
PARAQITJA E NJË KODRE TË ARIT NËN LUMIN EUFRAT	99
RRETHIMI I MUSLIMANËVE NË MEDINE	99
PARAQITJA E MBRETIT EL-XHEHXHAH	100
TRAZIRA (FITNETI) E AHLASIT, E SERRASË DHE E DUHEJMASË	101
ARDHJA E IMAM MEHDIUT	102
KOHA E PARAQITJES SË TIJ	103
SHENJAT E MËDHA TË KIJAMETIT	104

KRONOLOGJIA E SHENJAVE TË MËDHA SIPAS REALIZIMIT TË TYRE	104
1-2-3) TRI SHAFITJET E TOKËS	106
4) DALJA E DEXHXHALLIT	107
ÇDO TË THOTË EMRI DEXHALL	108
GJENDJA E MUSLIMANËVE NË KOHËN E PARAQITJES SË TIJ	108
THERTORJA (LUFTA EL-MELHAMETUL-KUBRA) DHE ÇLIRIMI I KONSTANTINOPOJËS (STAMBOLLIT)	109
THATËSIA DHE URIA QË MBRETËROJNË PARA LAJMËRIMIT TË DEXHXHALLIT	111
CILËSITË E DEXHXHALLIT DHE SHENJAT E TIJ	112
CILËSITË E PËRGJITHSHME	112
VERBËSIA E DEXHXHALLIT	113
MES DY SYVE TË TIJ SHKRUAN KAFIR	113
AI NUK LIND FËMIJË	114
MUNDËSITË E DEXHXHALLIT QË SHKAKTOJNË TRAZIRA	114
SHPEJTËSIA E LËVIZJES NËPËR TOKË	114
XHENNETI DHE ZJARRI I TIJ	115
BASHKËPUNIMI I TIJ ME SHEJTANËT	115
MATERIET E NGURTA DHE SHTAZËT I PËRGJIGJEN URDRIT TË TIJ	116
VRASJA E NJË TË RIU MUSLIMAN DHE RINGJALLJA E TIJ	116
VENDI I DALJES SË DEXHXHALLIT	117

KOHA E QËNDRIMIT TË TIJ NË TOKË	118
PASUESIT E DEXHXHALLIT	118
DEXHXHALLI NUK MUND TË HYJË NË MEKKE DHE MEDINE	119
LUTJA ALL-LLAHUT QË TË NA MBROJË NGA DEXHXHALLI	119
VRASJA E DEXHXHALLIT DHE E PASUESVE TË TIJ	120
DISA FJALË RRETH DEXHXHALLIT	120
5) ZBRITJA DHE ARDHJA E ISAUT ALEJHIS-SELAM	120
SI ËSHTË REALITETI?!	122
KOHA E ZBRITJES SË TIJ	125
ME ÇKA DO TË GJYKOJË ISAU ALEJHIS-SELAM PAS ZBRITJES SË TIJ?	126
ISAU ALEJHIS-SELAM VRET DEXHXHALLIN	127
ROLI I ISAUT PAS VRASJES SË DEXHXHALLIT DHE PAS SHKATËRRIMIT TË JE`XHUXHËVE DHE ME`XHUXHËVE	129
ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË NGA KËTO CITATE PËR ÇËSHTJEN E ISAU ALEJHI-SELAM	130
SA DO TË QËNDROJË ISAU ALEJHIS-SELAM NË TOKË?	131
VLERA E ATYRE QË DO TA SHOQËROJNË ISAUN ALEJHIS-SELAM	132
6) DALJA E JE`XHUXHËVE DHE ME`XHUXHËVE	132
7) TYMI (ED-DUHAN)	137
8) DALJA E SHTAZËS	138
9) LINDJA E DIELLIT NGA PERËNDIMI	139

SHKATËRRIMI I QABES NGA DORA E DHUS-SUVEJKATEJNIT	141
ZHUKJA E ISLAMIT, NGRITJA E KUR'ANIT DHE ZHUKJA E NJERËZVE TË MIRË	142
10) ZJARRI QË I TUBON NJERËZIT	143
FUNDI I KËSAJ BOTE APO DITA E KIJAMETIT	144
PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E DISA SHENJAVE TË KIJAMETIT TË ARDHURA NË HADITHET SAHIHE (TË VËRTETA), HASEN (TË MIRA) DHE DAIFE (TË DOBËTA)	145
FJALA E FUNDIT	155

PARATHËNIE

Falënderimi i qoftë All-llahut, Krijuesit të Gjithësisë dhe paqja e Tij qoftë me Muhammedin alejhis-selam, me familjen e tij të pastër dhe me të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij.

“Elif, Lamë, Mimë. Ky është Libri (Kur'ani) që nuk ka dyshim në të (se është i zbritur nga Zoti), ai është udhëzues për ata që janë të devotshëm. Për ata të cilët e besojnë të fshehtën (botën e ardhme dhe çdo gjë që i bashkangjitet asaj)...” (El-Bekare: 1-2)

“O ti pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmues, lajmëtar (përgëzues) dhe qortues.” (El-Ahzab: 45)

“A mos ata presin tjetër, pos Kijametit, i cili do t'u vijë befas, e parashenjat e tij tashmë kanë ardhur...” (Muhammed: 18)

“Kijameti u afrua dhe hëna u çka në dy pjesë. Por ata (pabesimtarët) edhe nëse shohin të gjitha shenjat (mrekullitë e Zotit), zbrapsen e thonë: “kjo është një magji e pandërprerë!” (El-Kamer: 1-2)

Vëlla dhe lexues i dashur! Kjo botë i ngjanë anijes e cila kalon nga njëri breg i detit në tjetrin, kurse ne jemi udhëtarët e saj. Ne shohim se në këtë botë nuk jeton përgjithmonë askush, andaj edhe All-llahu i Lartësuar i thotë Muhammedit alejhis-selam: “Ti je i vdekur dhe ata janë të vdekur” dhe “Ai (All-llahu) është që jep jetë dhe jep vdekje”. Fitimtari më i madh në mesin tonë

është ai që i fiton të mirat e kësaj bote dhe të mirat e botës së ardhme, kurse njeriu më i shkatërruar është ai që humb botën e ardhme. Transmetohet se Muhammedi alejhis-selam tha:

“NJERËZIT JANË NË GJUMË, KUR TË VDESIN - ZGJOHEN”.

Sot u bë e qartë se kjo Gjithësi dhe njeriu kanë një fillim të tyre dhe ata nuk u krijuan vetvetiu e as që e krijuan veten. Atëherë, vallë cili është qëllimi i krijimit të saj dhe cili është qëllimi i krijimit të njeriut? Nuk ka dyshim se Ai që e krijoi atë dhe njeriu është All-llahu, Krijuesi i çdo gjëje. Por, a thua Ai e krijoi kot njeriun, pa asnjë qëllim, apo i caktoi atij një qëllim? All-llahu i Lartësuar në Kur'an thotë: “Ai është i cili krijoi vdekjen dhe jetën, që t'ju sprovovë se kush nga ju është më vepërmiri”; ky pra, është qëllimi i krijimit të njeriut. All-llahu e la njeriun të lirë, që të dijë se cili do ta ndjek rrugën e pastër e cili të ndyrën dhe që secilin ta shpërblejë për veprën e tij: “Ai që bën mirë, bën mirë për vete dhe ai që bën keq, bën keq për vete” dhe “Zoti yt nuk është mizor ndaj njerëzve”.

All-llahu i Lartësuar i dërgoi njerëzimit, gjatë gjithë historisë së tij, të dërguar dhe libra që ta udhëzojnë atë në rrugë të drejtë. Muhammedi alejhis-selam është i Dërguari i fundit nga ata të dërguar dhe libri që i zbriti atij është fjala e fundit e All-llahut që iu drejtua njerëzimit.

All-llahu i prezantoi njerëzimit argumente dhe mrekulli të shumta, që të binden në qenien e Tij dhe në fjalët e të dërguarve. Paralajmërimet e të dërguarve dhe të librave hyjnorë janë argumente se ato janë nga Zoti i Gjithëdijshëm.

Paralajmërimet e Kur'anit dhe të Muhammedit alejhis-selam dhe Shenjat e kijametit janë mrekulli e madhe e Fesë Islame. Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se ç'do të ndodhë deri në Ditën e

kijametit dhe ç'do të ndodhë pas asaj dite. Një numër i madh i tyre u realizua në të kaluarën ashtu siç i paralajmëroi ai, disa nga to janë duke u realizuar në kohën tonë, ndërsa disa do të realizohen në të ardhmen. Pas gjithë kësaj, a mund të thuhet se ai nuk është i Dërguar i All-llahut?! Beto hem në Zotin se ai është i Dërguari i kohës së fundit, i paralajmëruar në të gjitha librat e mëparshëm hyjnorë.

Nuk ka dyshim se me njohjen e këtyre paralajmërimeve dhe shenjave, ne si muslimanë kemi dobi të mëdha, e nga ato:

1. Besimi në to, pasi që të bindemi se janë transmetime të vërteta, është obligim dhe mohuesi i tyre ka mohuar Zotin dhe të Dërguarin e Tij.
2. Realizimi i tyre në të kaluarën, sot dhe në të ardhmen forcon besimin e besimtarit dhe bind njerëzimin se ato janë nga All-llahu i Lartësuar.
3. Forcimi i besimit për ndodhjen e Ditës së kijametit, sepse besimi në të është nga fshehtësitë që jemi të obliguar t'i besojmë. Realizimi i atyre paralajmërimeve dhe i shenjave, ashtu siç u paralajmëruan, është argument se edhe Dita e premtuar e Kijametit do të vijë.
4. Këto paralajmërimë e shenja na mësojnë se ç'duhet e ç'nuk duhet vepruar ne si muslimanë. Më poshtë do të vijojë shtjellimi i të gjitha këtyre çështjeve.
5. Nga disa prej atyre paralajmërimeve e shenjave, dijetarët muslimanë mund të nxjerrin konkludime dhe gjykime të shariatit, siç është rasti me anulimin e xhizjes në kohën e zbritjes së Isaut alejhis-selam, kur ai nuk do të pranojë nga çifutët dhe të krishterët asgjë pos përqaftimit të Islamit, etj.

6. Njeriu gjithmonë është i interesuar ta njohë të fshehtën dhe ta dijë të ardhmen, e sa të shumtë janë ata që mundohen ta komentojnë të ardhmen. Andaj, këto paralajmërimë dhe shenja janë fjala e fundit për të ardhmen, sepse ato janë fjalët e All-llahut të Gjithëdijshëm dhe të të Dërguarit të Tij.

Gjatë përpilimit të këtij libri jam mbështetur në këto libra:

1. - Kur'ani i madhërishtëm;
2. - *Argumentet e Shpalljes*, nga Abdul-Melik Ali el-Kulejb;
3. - *Mrekulia shkencore e Kur'ant*, nga Mahmud Mehdi el-Istambuli;
4. - *Dita e Fundit dhe Kijameti i vogël*, nga dr. Umer Sulejman el-Eshkar;
5. - Përmbledhje e lajmeve të kohës së fundit dhe e shenjave të Kijametit, nga Abdull-llah el-Mishali;
6. - *Bibla*, nën kujdesin e Kishës së krishterë ungjillore të “Vëllezërve”
7. - *Ungjilli i Barnabas*, i botuar në arabisht më 1986 në Kuvajt.

O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët në Ditën e dhënies së llogarisë (Kijametit).

Osman Abazi

Universiteti i Mbretit Saud, Fakulteti Pedagogjik - Katedra e Shkencave Islame, Arabia Saudite

Rijad, 9 Muharrem 1416 h.

PARALAJMËRIMET KUR'ANORE

Çdo libër i Zotit përmban në vete paralajmërime të cilat janë argumente të gjalla se ai libër është Fjalë e Zotit. Ashtu si Teurati, Zeburi dhe Inxhili, edhe Kur'ani përmban në vete shumë paralajmërime. Megjithëse librat e shpallur para Kur'anit pësuan devijime e ndryshime të shumta nga duart e njerëzve, siç thotë All-llahu u Lartësuar në Kur'an, prapëseprapë ka mbetur një numër i madh paralajmërimesh të vërteta në to, të cilat janë në pajtim të plotë me paralajmërimet kur'anore dhe të Muhammedit alejhis-selam. Nga më të njohurat prej tyre janë ardhja e Muhammedit alejhis-selam dhe shumë e shumë paralajmërime të tjera që kanë të bëjnë me Islamin dhe me ndodhitë tjera. Realizimi i tyre në të kaluarën, sot dhe në të ardhmen, është argument i gjallë se ato janë të vërteta. Prandaj, paralajmërimet e të Dërguarit patjetër duhet të realizohen, e nëse ato nuk realizohen - ai i dërguar është gënjeshtar.

Në këtë kapitull do të paraqesim disa nga ato paralajmërime kur'anore, që janë argumente solide se Kur'ani është Fjalë e All-llahut të Lartësuar. Gjithashtu, në këtë kapitull nuk kam për qëllim t'i paraqes mrekullitë kur'anore, të cilat janë të panumërta, por vetëm ato që kanë të bëjnë me paralajmërimet e qarta. All-llahu na ndihmoftë!

MREKULLIA E PËRHERSHME KUR'ANORE DHE PAMUNDËSIA E RIVALIZIMIT TË SAJ

Kjo është mrekullia më e madhe dhe paralajmërimi më i rëndësishëm i Kur'anit. All-llahu i Lartësuar ia zbriti Kur'anin fisnik Muhammedit alejhis-selam, i cili ishte analfabet, që nuk dinte as shkrim-leximin e as që kishte njohuri për ndodhitë që kanë kaluar prej fillimit të krijimit të kësaj bote dhe për ato që do të ndodhin deri në ardhjen e çastit të fundit të Kijametit dhe pas tij. Andaj, All-llahu i Lartësuar kërkoi prej arabëve, të cilët shumë mirë e dinin mrekullinë retorike të Kur'anit, të përpilonin diç të ngjashme me Kur'anin, pastaj kërkoi nga mbarë njerëzimi, po edhe sikur të bashkohen njerëzit e xhindet, të bëjnë një Kur'an sikur ky, apo vetëm një kaptinë sikur kaptinat e Kur'anit.

All-llahu i Lartësuar kërkoi një gjë të tillë nga njerëzit e xhindet, sepse politeistët pretenduan se Kur'ani është vetëm poezi, magji apo shpallje e xhindeve. All-llahu i Lartësuar thotë:

“A mos ata (pabesimtarët) thonë: 'Ai (Muhammedi) e trilloi!' Jo, por ata nuk besojnë. Le të sjellin një fjalim sikurse ai (Kur'ani) nëse ata janë të sinqertë.” (Et-Tur: 33-34)

“Apo, ata thonë: ‘Ai (Muhammedi) trilloi atë (Kur'anin).’ Thuaj (Muhammed): ‘Na paraqitni pra, dhjetë kaptina si ai (Kur'ani) ashtu të trilluara (siç pretendoni ju) dhe thirrni këdo që të mundeni, përveç All-llahut, nëse jeni të sinqertë. E nëse ata nuk u përgjigjen juve, atëherë dine se ai (Kur'ani) u zbrit nga dija e All-llahut dhe se nuk ka zot tjetër përveç Tij. Pra, a do të jeni ju muslimanë (të dorëzuar Atij)?’” (Hud: 13-14)

“Nëse keni dyshim në atë që Ne ia zbritëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur’ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) përveç All-llahut, nëse jeni të sigurtë. E pasi që nuk e bëtë (deri tani) dhe nuk do ta bëni kurrë, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët, e që është përgatitur për mosbesimtarët.” (El-Bekare: 23-24)

“Thuaju (Muhammed): “Edhe sikur të tubohen njerëzit e exhinet për të bërë një Kur’an si ky, nuk do të bëjnë një të tillë sado që do të ndihmonin njëri-tjetrin.” (El-Isra: 88)

Shiko pra, vëlla i dashur, se si Kur’ani thërret në dyluftim të gjithë njerëzimin që të krijojnë një Kur’an të tillë, por, edhe pse pati disa përpjekje nga disa arabë, të cilët njihnin poezinë dhe retorikën, prapëseprapë ato përpjekje ishin të kota dhe nuk meritojnë as të përmenden. Fshehtësia më e madhe në Kur’an është se ai përmban në vete retorikë të lartë, por edhe mrekulli kuptimore, reale, ligjore, rrëfimore etj. Pra, nuk u paraqit në historinë njerëzore, e as që do të paraqitet, ai i cili do të bëjë një Kur’an sikurse ky. Mohimi i paraqitjes së atij që do ta komprometojë Kur’anin, është argument solid se ai është nga All-llahu i Gjithëdijsëm. Orientalistja italiane dr. Lora Fishija Fagliri, në librin e saj Mbrojtja e Islamit thotë:

“Mrekullia më e madhe e Islamit është Kur’ani, i cili erdhi deri te ne me transmetim të fortë e të pandërprerë. Në të ka lajme të sigurta që na bëjnë të mos dyshojmë në të. Shprehjet e tij janë të plota dhe përmbledhëse, e megjithëkëtë ai ka formë të përshtatshme, nuk është më i gjatë sesa nevojitet e as më i shkurtë sesa duhet, ndërsa metoda e tij është thelbësore dhe e veçantë dhe nuk ekziston diçka e tillë në letërsinë arabe, që mbeti nga shekujt që i paraprinë atij. Citatet e tij janë të gjitha në një shkallë të lartë të retorikës, madje edhe kur shtjellon tema çfarë patjetër duhet të lënë

ndikim në tingëllim, siç janë trashëgimi, ndalesat e të ngjashme me ato. Ai përsëritë rrëfimet e profetëve, fillimin e Gjithësisë dhe fundin e saj, cilësitë e Zotit dhe shpjegimin e tyre, por këtë përsëritje e bën në një mënyrë mahnitëse dhe kalon prej një teme në tjetrën pa humbur fuqinë e saj... Ne lexojmë në të, bashkë me shumë gjëra të tjera, lajmërimet për disa ngjarje të ardhme dhe përshkrime të ngjarjeve që kanë ndodhur shumë shekuj më parë e që ishin të panjohura në përgjithësi; ai sinjalizon ligje të shumta natyrore dhe dituri të ndryshme fetare e të tjera. Ne në të shohim thesar të gjerë të njohurive çfarë nuk mund të bëjë askush, e për këto arsye (dhe të tjera) Kur'ani nuk mund të jetë krijim i një njeriu të paarsimuar, i cili kaloi jetën në një shoqëri të vetmuar e të largët nga dijetarët e fetarët, dhe i cili gjithmonë ngulte këmbë se është vetëm njeri sikur të tjerët. Ai me këtë përshkrim nuk mund t'i bënte këto mrekulli nëse nuk e ndihmonte Zoti i Gjithëfuqishëm...”

REALIZIMI I PREMTIMIT TË ALL-LLAHUT SE DO TA MBROJË KUR'ANIN

All-llahu i Lartësuar ia zbriti Muhammedit alejhis-selam një ajet qysh në fillim të zbritjes së tij, ku i premtoi atij se Ai do ta mbrojë Kur'anin. Ai thotë:

“Njëmend, Ne e zbritëm Kur'anin dhe njëmend Ne do ta mbrojmë atë!” (El-Hixhr: 9)

Pra, All-llahu i Lartësuar premtoi se asnjëherë nuk do të mund të ndryshohet apo të devijohet Kur'ani i madhëruar, qoftë edhe për një shkronjë. Ja pra, sot jemi në vitin 1416 h. dhe Kur'ani

është po ai Kur'an që iu shpall Muhammedit alejhis-salam. All-llahu i Lartësuar bëri që Kur'ani të shkruhet dhe në të njëjtën kohë të mësohet përmendësh nga besimtarët, qysh prej kohës së Muhammedit alejhis-salam e deri në ditët tona.

Edhe pse u bënë shumë përpjekje për devijimin e Kur'anit, prapëseprapë në Kur'an nuk mundi të shtohet madje as një germë e vetme. Dhe sa e sa herë gjatë historisë muslimanët ranë nën pushtimin e të huajve, atë nuk arriti ta ndryshojë askush, dhe ai do të mbetet i tillë deri në Ditën e gjykimit.

“Ai (All-llahu) është që e dërgoi Të dërguarin e Tij me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fe, edhe nëse këtë e urrejnë politeistët.”

ROMAKËT DO TË TRIUMFOJNË MBI PERSIANËT BRENDË PAK VITEVE

“Elif, Lamë, Mimë. U mundën romakët. Në tokën më të ulët (tek Deti i Vdekur), por ata pas disfatës së tyre do të triumfojnë. Brenda pak viteve, çështja është e All-llahut, para kësaj dhe pas kësaj (para fitores dhe pas fitores). Atë ditë (kur do të fitojnë romakët) do të gëzohen besimtarët. Për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, Mëshirues. Premtimi i All-llahut, All-llahu nuk e then premtimin e Tij, por shumica e njerëzve nuk dinë.”
(Err-Rrum: 1-6)

Ky premtim u realizua ashtu siç premtoi All-llahu i Lartësuar. Pasi që persianët i mundën romakët, u gëzuan idhujtarët e Mekkes dhe u hidhëruan muslimanët, sepse persianët me idhujtarinë e tyre ishin më të afërt me politeistët, ndërsa romakët e krishterë ishin më afër Islamit dhe muslimanëve . Por, All-llahu i Lartësuar i paralajmëroi politeistët se gëzimi i tyre do të kthehet në hidhërim.

Meqë romakët triumfuan pas disfatës, ashtu siç paralajmëroi Kur’ani, Islamin e pranuan një numër i madh politeistësh, ngase ata ishin betuar se nëse realizohet ky premtim, do ta pranojnë Islamin. Dita e triumfit të romakëve mbi persianët është e njëjta ditë kur muslimanët triumfuan mbi politeistët në Bedr, e që ishte beteja e parë ndërmjet muslimanëve dhe politeistëve, siç transmeton Tirmidhiu nga Ebu Seidi - radiall-llahu anhu.

Historiani Eduard Gibon, në librin e tij “Historia e rënies dhe shkatërrimit të Perandorisë Romake”, shkruan:

“Asokohe, kur Kur’ani paralajmëroi këtë gjë, nuk kishte asnjë paralajmërim që ishte më larg realitetit sesa ky paralajmërim, ngase dymbëdhjetë vitet e para të pushtetit të Herakliut sinjalizonin fundin e Perandorisë Romake.”

EBU LEHEBI DHE GRUAJA E TIJ DO TË VDESIN MOSBESIMTARË

“Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai më është i shkatërruar! Pasuria e tij nuk i bëri dobi e as ajo që fitoi! Ai do të hyjë në zjarr të ndezur flakë! E edhe gruaja e tij, bartësja e ferrave! Në qafën e saj ajo do të ketë një litar të përdredhur!” (El-Mesed)

Pra, All-llahu i Lartësuar premtoi se xhaxhai i Muhammedit alejhis-selam, Ebu Lehebi dhe gruaja e tij, do të vdesin si pabesimtarë, respektivisht, nuk do ta pranojnë Islamin. Këta të dy e urrenin shumë Muhammedin alejhis-selam. Gruaja e Ebu Lehebit bartte ferra dhe i hedhte në rrugën ku kalonte Muhammedi alejhis-selam, ndërsa Ebu Lehebi aktivizoi fushatë kundër Muhammedit alejhis-selam ndër arabët që vinin në Mekke, për ta vizituar shtëpinë e Zotit.

është për t'u çuditur se si Ebu Lehebit asnjëherë nuk iu kujtua të paraqitet ta pranojë Islamin, vetëm për të thënë se - ja, premtimi i All-llahut nuk u realizua. Ai vdiq kur dëgjoji për triumfin e muslimanëve në Ditën e Bedrit, kurse gruaja e tij u mbyt nga litari me të cilin bartte ferra.

POLITEISTËT DO TË PËSOJNË DISFATË NË BETEJËN E BEDRIT

“A mos thonë ata (politeistët): Ne të gjithë së bashku do të triumfojmë (kundër muslimanëve). Të gjithë ata do të pësojnë disfatë dhe do të ikin.” (El-Kamer: 44-45)

Ky ajet kur'anor zbriti qysh në Mekke, kur politeistët e sulmonin Muhammedin alejhis-selam dhe muslimanët duke u thënë atyre se do të pësojnë disfatë. Por, All-llahu i Lartësuar u premtoi muslimanëve se politeistët do të pësojnë disfatë dhe do t'i kthejnë shpinat e tyre duke ikur. Beteja e Bedrit ishte beteja e parë në të cilën politeistët pësuan disfatë dhe ikën, edhe pse ata ishin afro 1000 veta ndërsa muslimanët 315 veta. Për këtë ngjarje zbritën ajete të shumta dhe pothuajse e tërë kaptina el-Enfal e përshkruan këtë ngjarje. Në këtë betejë morën pjesë edhe një numër i madh melaqesh në krye me Xhibrilin dhe Mikailin.

MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE BESIMTARËT DO TË HYJNË NË MEKKE DHE PAS KËSAJ DO TË ÇLIROHET AJO

“All-llahu e vërtetoi ëndrrën e Të dërguarit të Tij në realitet: Se me vullnetin e All-llahut do të hyni në Xhaminë e Shenjtë (në Qabe) të siguruar, të rruara e të shkurtuara flokët e kokave tuaja dhe nuk do të keni frikë. Pra, Ai diti atë që ju nuk dinit, dhe pas kësaj ju dha një fitore të afërme.” (El-Fet’h: 27)

Muhammedi alejhis-selam kishte parë në ëndërr se ai dhe muslimanët do të hyjnë në Mekke të siguruar, dhe këtë ëndërr ua tregoi shokëve të tij të cilët u gëzuan pa masë sepse do të ktheheshin në vendlindjen e tyre. Ky premtim u realizua një vit pas marrëveshjes së Hudejbisë në vitin 7 të hixhretit, pasi që mushrikët nuk i kishin lejuar të hyjnë në vitin 6.

Ajeti i lartpërmendur premtoi se do të ndodhë një çlirim i shpejtë pas kësaj ngjarjeje, e ky çlirim ishte çlirimi i Mekkes.

MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE MUSLIMANËT DO TË MBIZOTËROJNË NË TOKË

“All-llahu u premtoi atyre që besuan nga mesi juaj dhe bënë vepra të mira se do t'i bëjë zotërues në Tokë, ashtu siç i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre, dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Mua do të më adhurojnë dhe nuk do të më shoqërojnë asgjë. E ai që pas kësaj mohon, të tillët janë ata të prishurit.” (En-Nur: 55)

Thotë ibn Kethiri (komentuesi i njohur i Kur'anit): All-llahu i Lartësuar e realizoi premtimin e Tij, sepse ende pa vdekur Muhammedi alejhis-selam u çliruan Mekka, Hajberi, Bahrejni, Jemeni dhe vende të tjera të Gadishullit Arabik në përgjithësi dhe ai mori xhizjen nga mexhusitë (zjarrputistët) e Hixhrit dhe nga disa pjesë të Shamit, ndërsa Herakli, mbreti i romakëve në Sham, Mukavkisi, mbreti i Egjiptit dhe i Aleksandrisë, mbreti i Omanit dhe Nexhashiu, mbreti i Etiopisë, e përqaftuan Islamin - All-llahu i mëshiroftë. Kur vdiq Muhammedi alejhis-selam, pushtetin pas tij e mori zëvendësi i tij Halifi Ebu Bekr Es-Sidiku i cili e dërgoi ushtrinë islame në krye me Halid ibn Velidin në Persi me ç'rast u çliruan disa vende të saj. Një ekspeditë tjetër luftarake e udhëhoqi Ebu Ubejde, radiall-llahu anhu, në vendet e Shamit, kurse ushtrinë e tretë e udhëhoqi Amr Ibnul-Asi në vendet e Egjiptit. Në kohën e tij u çliruan Basra, Damasku dhe

vendet e Havranit. Pas vdekjes së tij, halifatin e mori Umeri, radiall-llahu anhu, në kohën e të cilit u çliruan të gjitha vendet e Shamit dhe të Egjiptit, si dhe Persia dhe pasuritë e tyre u shpenzuan në rrugën e Zotit, ashtu siç kishte premtuar Muhammedi alejhis-selam:

“Kur të zhduket Kajseri nuk ka Kajser më pas tij, dhe kur të zhduket Kisraja, nuk ka më Kisra pas saj. Beto hem në Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, ju do t’i shpenzoni thesarët e tyre në Rrugën e Zotit.”

Pastaj, në kohën e Uthmanit, radiall-llahu anhu, Shteti Islam u zgjerua në Lindje e në Perëndim, që nga Maroku e deri në fund të Kinës, e gjithashtu, në kohën e tij u vra Kisrau dhe përgjithmonë mori fund pushteti i tij.

Shiko pra, vëlla i dashur, se si u realizua premtimi i All-llahut të Lartësuar që në kohën e sahabëve (shokëve të Muhammedit alejhis-selam), të cilëve drejtpërdrejtë u foli Kur’ani. Ja pra, ata që nuk mund të sundonin asnjë fis, vetëm pas disa vjetëve e zgjeruan Shtetin Islam nga Lindja e deri në Perëndim. Ky pra është një argument shumë bindës se ky Kur’an është Fjalë e Zotit të Lartësuar. Mjerë ai që nuk kupton.

REALIZIMI I PREMTIMIT TË ALL-LLAHUT XHEL-LE SHANUHU SE MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DHE ISLAMI DO TË TRIUMFOJNË

“All-llahu ka përcaktuar (e ka bërë obligim për Vete): ‘Unë dhe të dërguarit e Mi, patjetër do të triumfojmë!’ All-llahu është i fortë, ngadhënjyes.” (El-Muxhadele: 21)

“Ata (jomuslimanët) dëshirojnë ta shuajnë Dritën e All-llahut me gojët e tyre, por All-llahu do ta plotësojë Dritën e Tij edhe pse e urrejnë këtë jobesimtarët. Ai (All-llahu) është që e dërgoi Të dërguarin e Tij me udhëzim të qartë e Fe të vërtetë për ta bërë mbizotëruese mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë këtë.” (Es-Saff: 8-9)

Nuk kaluan shumë vite që kur u shpallën këto ajete, derisa muslimanët mbizotëruan Gadishullin Arabik në përgjithësi, edhe pse muslimanët ishin pakicë dhe pa armatim të mjaftueshëm, kurse pabesimtarët ishin të shumtë, me armë dhe ushtri të panumërta. Ky pra ishte triumfi i All-llahut dhe i pejgamberit dhe kurdo që rikthehet një gjeneratë sikurse ishte gjenerata e parë e muslimanëve, ata do të mbizotërojnë në tokë.

MUSLIMANËT DO TË PASUROHEN MEQË KISHIN FRIKË VARFËRINË

“... nëse i frikësoheni skamjes, All-llahu me dëshirën e Vet do t’ju pasurojë me mirësitë e Tij...” (Et-Tevbe: 28)

Dhe me të vërtetë ndodhi kështu. Ata që emigruan nga Mekka në Medine dhe lanë familjet e pasuritë e tyre vetëm për All-llahun dhe Të dërguarin e Tij, u pasuruan shumë shpejt, meqë detyruan popuj të ndryshëm të paguajnë xhizjen sepse nuk hynë me dëshirën e tyre në Islam. Ata pranuan ta paguajnë xhizjen, ndërsa muslimanët u pasuruan aq shumë saqë nuk kishin kujt t'ia japin zekatin.

MEKKA DO TË ÇLIROHET DHE NJERËZIT DO TË HYNË GRUPE-GRUPE NË FE

“Kur të vijë ndihma e All-llahut dhe çlirimi (i Mekkes), dhe i sheh njerëzit grupe-grupe duke hyrë në Fenë e All-llahut. Atëherë ti lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është mëshirues i madh.” (En-Nasr)

Dita e çlirimit të Mekkes ishte dita kur shumë fise arabe vinin te Muhammedi alejhis-selam duke deklaruar hyrjen e tyre në Islam, pasi që më parë ishin zotuar se nëse realizohet ky premtim do të hynë në Islam. Gjithashtu, ky ajet premtoi çlirimin e Mekkes nga politeistët, gjë që edhe u realizua.

PREZENTIMI I ARGUMENTEVE TË GJALLA NË TRUPIN E NJERIUT DHE NË GJITHËSI, DERISA NJERËZIMI TË BINDET SE KJO FE ËSHTË E VËRTETË

“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet Tona në Gjithësi dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë (prej Zotit). A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fussilet: 53)

Kur’ani që nga zbritja e tij e deri në ditët tona vazhdon të jetë burim i pashtershëm i zbulimeve të ndryshme në çdo lëmi të jetës, siç e përshkruajti Muhammedi alejhis-selam: “Çudirat e tij kurrë nuk marrin fund” dhe “Atë nuk e turbullojnë kohët”.

Pra, Kur’ani është përplot mrekulli të tilla. Ne do t’i paraqesim vetëm disa nga ato, të cilat, njëkohësisht, janë paralajmërime të zbuluara në kohën tonë apo në kohën bashkëkohore të zbulimeve shkencore.

AJETET KUR'ANORE RRETH ZBULIMEVE SHKENCORE BASHKËKOHORE JANË ARGUMENT I GJALLË SE KY KUR'AN ËSHTË FJALË E TË GJITHËDIJSHMIT

Duke marrë parasysh kohën kur jetoi Muhammedi alejhis-selam dhe errësirën e madhe në të cilën asokohe gjendej bota, është e pamundur që ajetet që flasin për zbulimet më të reja shkencore të jenë fjalë njerëzore. Ato ajete janë të pathyeshme dhe asnjëherë nuk ndryshojnë, ngaqë janë fjalë e Zotit. Ndërsa, ne shohim se disa nga zbulimet shkencore ndryshojnë prej kohe në kohë.

Zbulimet shkencore, në realitet, nuk janë paralajmërime në bazën e tyre, sepse ato ishin vetëm të pazbuluara dhe u zbuluan në kohën pas zbritjes së Kur'anit dhe shumica e tyre u zbuluan në kohën bashkëkohore. Ne i paraqitëm ato në këtë libër, sepse në të vërtetë, ato për ne janë paralajmërime, edhe pse ato nuk ndryshojnë derisa All-llahu i Lartësuar të dëshirojë. Ne jemi të bindur se Kur'anit përmban në vete edhe shumë sekrete të tjera çfarë mendja e njeriut nuk i ka menduar, por ato do t'i zbulojë koha. Prandaj, i lus muslimanët që ta studiojnë këtë burim të madhërisëm të tyre dhe ta praktikojnë në jetën e tyre të përditshme, të jenë Kur'an i gjallë që ec mbi tokë.

Ne këtu do të paraqesim vetëm disa nga ato paralajmërime të tilla. All-llahu i Lartësuar qoftë në ndihmën tonë.

VIJAT NË MAJE TË GISHTËRINJVE NUK JANË TË NJËJTA TE ASNJË PERSON

Në suren el-Kijame, në ajetet 3-4, All-llahu i Lartësuar thotë:

“A mendon njeriu se nuk do t’i tubojmë eshtrat e tij (Ditën e ringjalljes). Gjithqysh, Ne jemi të fuqishëm t’ia rikthejmë edhe majet e gishtave të tij.”

Pra, derisa njeriu mendon se Zoti nuk do ta ringjallë atë pasi të bëhet pluhur, Ai i vërteton atij se do t’ia ringjallë edhe majet e gishtërinjve ashtu siç i kishte. Vallë, pse All-llahu përmendi këtu në veçanti majet e gishtërinjve e jo ndonjë pjesë tjetër të trupit?! Ngase shkenca në shekullin e kaluar zbuloi se ato dallohen nga një person në tjetrin, prandaj edhe merren gjurmët e gishtërinjve kur dëshirohet zbulimi i ndonjë krimineli nga ana e policisë. Kush është pra ai që e lajmëroi Muhammedin alejhis-selam për këtë fshehtësi të madhe përveç All-llahut të Gjithëdijshëm.

LËKURA ËSHTË AJO QË NDJEN DHEMBJEN E JO I GJITHË TRUPI

“Njëmend, ata që mohuan argumentet tona, do t’i hedhim ata në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurët atyre, Ne ua ndërrojmë në lëkura të tjera që ta shijojnë dënimin. All-llahu është i plotfuqishëm dhe i drejtë (në atë që vepron).” (En-Nisa: 56)

Deri vonë mjekësia dhe njerëzimi mendonte se i gjithë trupi i njeriut përjeton ndjenjën e dhembjes, por disa vjet më parë mjekësia zbuloi se realiteti nuk është ashtu, sepse dhembjen e ndjen vetëm lëkura ku gjenden shqisat ndijuese. Atëherë, a nuk është ajeti i lartpërmendur një sinjalizim për këtë. Përndryshe, çfarë kuptimi ka fjala e All-llahut: “sa herë që u digjen lëkurët e tyre, Ne ua ndërrojmë në lëkurë të tjera që ta shijojnë dënimin (e zjarrit)”. Muhammedi alejhisselam nuk jetoi në kohën tonë që të zbulojë diç të tillë me mjetet bashkëkohore të mjekësisë, por atë e mësoi Njohësi i çdo fshehtësie, Krijuesi i njerëzimit.

GJITHËSIA ISHTE NJË TËRËSI PASTAJ FILLOI TË NDAHET DHE TË ZGJEROHET

“A nuk shohin ata që nuk besojnë se qiejt dhe Toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?” (El-Enbija: 30)

Ky ajet i Kur’anit zbuloi një fshehtësi të madhe të Gjithësisë - se qiejt dhe Toka ishin të bashkuara e të ngjitura në një tërësi e pastaj u ndanë dhe filluan të zgjerohen në Gjithësi. Ky është zbulimi bashkëkohor për Gjithësinë, sepse dijetarët në kohën tonë zbuluan se materia në fillim ishte një tërësi e palëvizshme dhe se ishte në formë të gaztë, e nxehtë, e trashë dhe e ngjitur, pastaj u shkaktua një shpërthim (me urdhrin e All-llahut) në këtë materie para më se 5.000.000.000.000 vjetësh kështu që ajo tërësi filloi të zgjerohet dhe të largohet, ndërsa materia u vu në lëvizje të përhershme, siç thotë All-llahu i Lartësuar:

“Dhe qiellin Ne me duart Tona e krijuam, dhe Ne, patjetër, e zgjerojmë atë.”

Prandaj, vëllau im, mendo, qoftë edhe një herë, se nga është nisur kjo Gjithësi. Pa dyshim, është duke u rikthyer tek Ai që e lëvizi herën e parë.

DITA DHE NATA VAZHDIMISHT NDJEKIN NJËRA-TJETRËN

“...Ai (All-llahu) e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e ndjek atë...” (El-A’rafë:54)

“... Ai (All-llahu) natën ia mbështjell (vendit të) ditës dhe ditën ia mbështjell natës...” (Ez-Zumer: 5)

“Ti (o Zot) e fute natën në ditën dhe Ti (o Zot) e fute ditën në natë...” (Ali Imran: 27)

Shiko pra, vëlla i dashur, se si All-llahu i Lartësuar na paralajmëron se nata dhe dita ndjekin dhe kërkojnë njëra-tjetrën vazhdimisht, e një gjë e tillë nuk ndodh, përveç nëse toka është e rrumbullakët, e kjo është ajo që thirri Galileu (meqë ndoshta kishte dëgjuar nga muslimanët një gjë të tillë), të cilin Kisha e ndoqi për ta likuiduar.

Jurij Gagarini pas kthimit nga udhëtimi i tij rreth Tokës, tha se kishte vërejtur ndjekje të shpejtë të errësirës dhe dritës mbi Tokë për shkak të rrotullimit të saj.

QIEJT DHE TOKA QËNDROJNË MBI SHTYLLA TË PADUKSHME

“All-llahu është Ai që ngriti qiejt me shtylla që nuk i shihni...” (Err-Rra’d: 2)

Ky ajet është i përshtatshëm me kohën kur zbriti, sepse njeriu i asaj kohe shihte në këtë Gjithësi planetë të ndryshme që qëndrojnë pa asnjë shtyllë të dukshme. Por, në të njëjtën kohë, ajeti sqaron se qiejt (e të cilët janë shtatë, që shkenca ende nuk i ka zbuluar) dhe Toka kanë shtylla, por të padukshme.

Sot kur shkenca përparoi arritit edhe ta vërtetojë këtë thënie të Kur’anit, sepse dijetarët zbuluan se planetët qëndrojnë në pozicionet e tyre sipas Ligjit të Gravitacionit, të cilin e krijoi All-llahu i Lartësuar, andaj, planetët qëndrojnë në pozicionet e tyre, përndryshe, do të shkatërrohej çdo gjë.

Ibni Kethiri në komentin e ajetit “... me shtylla që nuk i shihni...” thotë: Transmetohet nga ibni Abbasi, Muxhahidi, El-Hasani, Katade dhe të tjerë se kanë thënë: “Ata (qiejt dhe Toka) kanë shtylla por nuk shihen’.”

Shiko pra, vëlla i dashur, këtë fshehtësi të madhe të Kur’anit të cilën e vërtetuan zbulimet shkencore shumë të vonshme. A mund të jetë një person i shekullit të shtatë ai që e zbuloi këtë, sikur të mos ekzistonte ndihma e Të Gjithëdijshtmit?

SHTYPJA ATMOSFERIKE ULET ME NGRITJEN NGA SIPËRFAQJA E TOKËS

“Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën atij për (ta pranuar) Islamin. Kurse atë që dëshiron ta lërë të humbur, gjoksën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell (në lartësi të larta)...” (El-En’amë: 125)

Ky ajet i All-llahut të Lartësuar zbulon dy fshehtësira: e para, sa më lart që të ngrihet njeriu nga rruzulli tokësor, i ngushtohet frymëmarrja, e kjo është ajo që shkenca bashkëkohore e dëshmoi. E dyta: nga ky ajet nënkuptohet se njeriu një ditë do ta përjetojë këtë vetvetiu dhe do të ngjitet në lartësitë qiellore. Ja pra, janë ditët tona ato që argumentojnë këtë. Më thuaj, atëherë, a mund të jetë kjo fjalë e Muhammedit alejhis-selam?!

NJERËZIMI DO TA KALOJË (DEPËRTOJË) RRUZULLIN TOKËSOR, POR VETËM ME NJË FUQI

“O turmë e exhinëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni prej kufijve të qiejve e të Tokës, ju dilni, por, nuk do të mundeni të dilni pos me një fuqi të fortë (që ju në këtë kohë të shekullit të shtatë nuk e posedoni).” (Err-Rrahman: 33)

Është shumë e qartë se ç'nënkupton ky ajet i madh. Zhvillimi teknik bashkëkohor argumentoi, apo më mirë të themi praktikoi, këtë fjalë të All-llahut të Lartësuar me urdhrin e Tij. Pra, All-llahu u thotë njerëzve se: ju mund t'i kaloni kufijtë e qiellit vetëm nëse posedoni fuqi të madhe, e dihet se çfarë fuqie e madhe nevojitet për çarjen e qiellit.

NJERËZIMI DO TË PËRDORË MJETE TË TJERA TRANSPORTUESE PËRVEÇ GOMARIT, KALIT ETJ.

“Edhe kuajt (i krijoi Zoti yt), edhe mushkat edhe gomarët, për t’ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai do të krijojë (për hipje) çka ju (tani) nuk dini.” (En-Nahl: 8)

Shtazët e përmendura në ajet ishin mënyra e vetme e njohur transportuese e asaj kohe, por All-llahu thotë se në të ardhmen do të krijojë mjete të reja çfarë ti o njeri i shekullit të shtatë nuk i njeh. Ja, pra, edhe koha e veturave dhe e aeroplanëve e vërtetoi këtë Fjalë të madhe të All-llahut të Lartësuar. Ajeti i lartshënuar nuk përcaktoi se sa janë ato mjete transportuese, e nuk do të thotë se njeriu, me ndihmën e All-llahut, nuk do të prodhojë mjete të reja transportuese. Andaj, muslimanët duhet të jenë të parët të cilët duhet të mendojnë për këtë.

TOKA RROTULLOHET DHE KODRAT LËVIZIN SIKUR RETË NË QIELL

“E ti (Muhammed dhe ti njeri) sheh kodrat e mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato kalojnë sikurse kalojnë retë, (kjo është) mjeshtria e All-llahut që përsosi çdo send, e Ai është hollësisht i njohur se ç’punoni!” (En-Neml: 88)

Betohem në Atë, që jeta jonë është në dorën e Tij, se ky Kur’an është fjalë e All-llahut të Lartësuar. Ky ajet është argument shumë i madh për këtë që pretendoj. Ai sinjalizon se Toka rrotullohet, e përndryshe, ç’do të thotë lëvizja e kodrave. Ky realitet u zbulua pesë shekuj më parë nga ana e dijetarit Kopernik, të cilin Kisha e akuzoi si mosbesimtar dhe e dogji në vitin 1543. Pra, nuk mund të thuhet se Koperniku është i pari që e tha këtë realitet, por atë e tha Kur’ani qysh në shekullin e shtatë. Pra, është mëkat të mos pranohet ky realitet, kur e dimë se ende thuhet se i pari që thirri në këtë realitet është Koperniku.

ERËRAT DËRGOHEN PËR MBARËSIM

“Ne i dërgojmë erërat mbarësuese, e nga qielli (retë) lëshojmë shi...” (El-Hixhr: 22)

Ky ajet kur’anor sinjalizon mbarësimin mes reve nga i cili lind shiu dhe i njëjti mbarësim bëhet edhe mes bimëve, kurse erërat janë shkak, pas All-llahut, që të bëhet ky mbarësim. Vallë, ç’është ky mbarësim?! Njeriu i kohës së zbritjes së Kur’anit shihte retë se si tubohen dhe si nga ato derdhet shiu, por ai nuk dinte asgjë për fshehtësinë e këtij mbarësimi. Sot, është e njohur se

ngurtësimi i avullit të ujit në formë të pikave të shiut nuk ndodh edhe nëse lagështia në atmosferë arrin 400 për qind, derisa të bashkohen në thërmija shumë të vogla të kripura apo në formë akulli, e të cilat i bartin erërat, dhe kur ato takohen me atmosferë të lagësht fillon të dendësohet ajo dhe pastaj me urdhrin e All-llahut lëshohet shiu nga ato re. Gjithashtu, erërat bartin farat mbarsëse prej një luleje me gjene mashkullore në atë femërore dhe me këtë mbijnë frytet me urdhrin e All-llahut të Lartësuar. A mund ta paramendonin këtë njerëzit e shekullit të shtatë?!

QIELLI ËSHTË NJË ÇATI MBROJTËSE

“Dhe Ne qiellin ua bëmë si një kulm të sigurt, por ata refuzojnë ajetet tona”. (El-Enbija: 32)

Qielli, pra, është ai që mbron Tokën sikurse kulmi që mbron shtëpinë. Vallë prej çka e mbron atë?! Dijetarët bashkëkohorë thonë: sikur shtypja atmosferike tokësore të ishte pak më e ulët se që është nga rruzulli tokësor, atëherë shkëndijat e shumta të cilat çajnë horizontet e jashtme do ta goditnin Tokën në të gjitha pjesët e saj, dhe me këtë rast do të ndizej çdo gjë ndezëse, atëherë qielli nuk do të ishte mburojë.

Biologu Frenk Alen thotë:

“Toka është e mbështjellur me një materie të gaztë, e cila përmban gazrat e nevojshëm të jetës dhe ajo ngrihet mbi rruzullin tokësor më tepër se 500 milje. Kjo mbështjellje e Tokës arrin dendësinë e nevojshme që ta pengojë derdhjen e miliona shkëndive vrasëse për çdo ditë në

Tokë... dhe kjo mbështjellje atmosferike ruan shkallën e nxehtësisë së nevojshme për jetë. Po ashtu ajo bart avullin e oqeaneve dhe të deteve në vende të largëta brenda kontinenteve, ku edhe shndërrohet në shi i cili ringjallë Tokën pas vdekjes së saj. Kurse shiu është burimi kryesor i ujit të ëmbël, i cili sikur të mos ekzistonte, Toka do të shndërrohej në një shkretëtirë pa shenjë jete. Për këtë, ne vërejmë se atmosfera dhe oqeanet përbëjnë rrotën e baraspeshës në natyrë.”

(Nga libri Zoti zbulohet në shekullin e diturisë)

LARGËSIA MES YJEVE DHE FSHEHTËSIA E VENDQËNDRIMEVE TË TYRE

“Betohem në vendqëndrimin e yjeve. E ky betim është i madh, sikur ta dini.” (El-Vakia: 75-76)

Kur All-llahu i Lartësuar betohet në një krijesë të Tij, kjo do të thotë se ajo është me rëndësi shumë të madhe. Njeriu i shekullit të shtatë nuk dinte asgjë për largësinë e yjeve dhe për madhësinë e tyre. Grupi i yjeve më të afërta me qiellin tonë është larg nesh afro 700.000 mijë vjet drite, kurse drita për një sekondë kalon 300.000 km.

Mirëpo, sekreti më i madh në këtë ajet është “vendqëndrimi i yjeve”, gjë që sot e kësaj dite i mundon dijetarët. Koha kur dijetarët do ta përcaktojnë vendqëndrimin e yjeve dhe do të mund ta vizatojnë hartën e tyre, do të jetë një kohë e re për historinë njerëzore. Dijetari i astronautikës, Xhejms Xhines, thotë:

“Studimi i vendqëndrimit të yjeve do ta japë çelësin e një panorame më të bukur që ka parë syri i njeriut, do të na mundësojë shikimin e një qielli të çuditshëm e të gjerë dhe do të kuptojmë nga ajo çfarë nuk kishim kuptuar. Sikur të kemi mundësi t’i skicojmë vendqëndrimet e yjeve përgjithësisht, një gjë e tillë do të na ofronte sqarimin e realitetit të Gjithësisë.”

Nuk ka dyshim se muslimani e ka parasysht realitetin e krijimit të Gjithësisë, kurse ky dijetar pret derisa ta zbulojë atë, por ka harruar se vdekja e pret në çdo çast dhe, atëherë, njeriu do ta kuptojë sqarimin e vërtetë të realitetit të Gjithësisë.

DRITA E HËNËS ËSHTË E HUAZUAR, NDËRSA E DIELLIT ËSHTË NGA VETË AI

“Ai (All-llahu) është që bëri Diellin shndritës, e Hënën e bëri dritë...” (Junus: 5)

“I madhërishtëm është Ai që krijoi yjet në qiell dhe vendosi në të një shndritës (Diellin) dhe një Hënë ndriçuese.” (El-Furkan: 61)

Pra, vëllai im i dashur, këto dy ajete sinjalizojnë se Dielli është shndritës - në gj. arabe dije, që nënkupton se ai ndrit vetvetiu, kurse Hëna është dritë - në gj. arabe nûr, që nënkupton se ajo huazon dritën.

Kjo, pra, është ajo që zbuloi shkencë bashkëkohore, e cila thotë se Dielli është i zjarrtë, kruse Hëna dritën e saj e merr nga Dielli.

PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE NË FILLIM GJITHËSIA ISHTE TYM

“Mandej Ai (All-llahu) mësyu qiellin (krijimin e tij) e ai ishte tym (mjegullirë që ishte si materie e parë) dhe atij dhe tokës u tha: ‘Qasuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!’ Ato thanë: ‘Erdhëm me dëshirë!’” (Fussilet: 11)

Ky ajet kur’anor sinjalizon se qielli në fillim të krijimit ishte një lloj tymi dhe dijetarët, pothuajse të gjithë, pajtohen me këtë. Xhejms Xhins, dijetari astronomik, thotë:

“Si duket, materia e Gjithësisë filloi si një gaz i përhapur nëpër Gjithësi dhe galaktika u krijua nga dendësia e këtij gazi.”

Pra, Kur’ani e përcaktoi këtë materie diç si tym, sepse ai ishte nga gjërat ndijuese të arabëve në atë kohë.

PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE DIELLI LËVIZ DREJT NJË CAKU TË TIJ

“Edhe Dielli udhëton për në cakun e vet. Ky është përcaktim i Ngadhënyjesit, Të Dijshmit.” (Jasin: 38)

Ky ajet, vëllai im, sinjalizon në atë që thotë shkencë bashkëkohore se: Dielli ka dy lëvizje, njëra rreth boshtit të tij dhe tjetra lëvizje kaluese kah lindja rreth një ylli shumë të madh. është

interesant se po ky ajet i Kur'anit lexohet me dy kiraete (mënyra të leximit): i pari siç e përshekruam deri më tani, kurse në të dytin thuhet “la mustekarre leha”, që d.m.th., udhëton pa cak, pa kufi, pandërprerë, kurse leximi i parë ishte “li mustekarrin leha”, që d.m.th., ai udhëton deri në cakun e tij. Pra, leximi i parë nënkupton rrotullimin e tij rreth atij ylli të madh, kurse leximi i dytë nënkupton rrotullimin e tij rreth boshtit të vet pandërprerë.

Fjala “udhëton” në arabisht “texhri” ka kuptimin e vrapimit, thuhet Dielli është duke vrapuar për ta arritur cakun e tij. All-llahu a’lem.

PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE ÇDO GJË KRIJOI NË ÇIFT (DY LLOJE)

“I lartësuar është Ai që i krijoi çifte të gjitha (dy lloje) nga çka mbinë nga Toka, nga vetë ata (njerëzit) dhe nga çka ata nuk dijnë.” (Jasin: 36)

Ky ajet dhe të ngjashmit me të në Kur'an, sinjalizon se çdo gjë në këtë botë është dy llojesh (sikurse është njeriu mashkull e femër). Se njeriu, shtazët dhe disa bimë janë mashkull e femër (çifte), ishte gjë e njohur qysh herët. Por, njeriut të shekullit të shtatë nuk i shkoi asnjëherë ndër mend se gjithashtu edhe materia dhe bimët në përgjithësi janë çifte. Rryma elektrike, e cila u zbulua në kohën e re, nuk është asgjë tjetër përveç se rezultat i dy poleve. Thërrmia e atomit, që deri vonë mendohej se është pjesa më e vogël e materies, përbëhet nga bërthama të cilën e rrethojnë elektronet, kurse vetë bërthama e atomit përbëhet nga protonet dhe neutronet. Pra, çdo

gjë në këtë gjithësi, përveç All-llahut - të Vetmit, është çift. Andaj, vëllau im, a mund të jetë Muhammedi alejhis-selam ai që shpiku apo që zbuloi këtë realitet?

PARALAJMËRIMI I ALL-LLAHUT SE EKZISTON TËRËSI MË E VOGËL SE ATOMI

“Zotit tënd nuk mund t’i fshihet, as në Tokë e as në qiell, as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, e çdo gjë është e shkruar në Librin e qartë.” (Junus: 61)

Më parë përmendëm se deri vonë mendohej se ajo grimcë, që është atomi, është thërrmia më e vogël, por Kur’ani thotë se All-llahut nuk i fshihet asgjë, qoftë edhe më e vogël se ajo thërrmi, pastaj arriti shkenca ta ndajë atomin në protone dhe neutrone që janë pjesë më të vogla se atomi.

është interesant se Kur’ani tha se nuk i fshihet All-llahut asgjë as në Tokë e as në qiell, që do të thotë se po të njëjtat thërrmi janë edhe në qiell. Disa dijetarë thonë se Gjithësia në përgjithësi është nga ato thërrmia të atomit. All-llahu a’lem.

Vallë, mos Muhammedi alejhis-selam ishte ndonjë shkencëtar që të bëjë zbulime të tilla, apo ishte vetëm një i Dërguar që nuk dinte shkrim e lexim.

MES DY DETEVE KA NJË MUR QË NUK LEJON TË PËRZIHEN

“Ai (All-llahu) lëshoi dy dete të puqen ndërmjet vete. Në mes tyre ka një mburojë që nuk i lejon të trazohen.” (Err-Rrahman: 19-20)

Domethënë, se mes dy deteve ekziston një pengesë që nuk i lejon ujërat e një deti të hyjnë në detin tjetër. Kjo pengesë nuk është e palëvizshme, sepse fjala “merexhe” e përdorur në ajet ka kuptimin e shkuarjes, kthimit dhe të lëvizshmërisë. Shkenca zbuloi se ujërat e deteve nuk përzihen ndërmjet vete dhe çdonjëri nga ato ruan veçoritë e veta.

Disa dijetarë nga Gjermania, më 1962 zbuluan se në vendin ku bashkohen Deti i Kuq dhe Oqeani Indian nuk përzihen ujërat në mes dy deteve. Ata vërejtën se ndërmjet tyre ekziston një vijë e qartë ndarëse, por ajo nuk ishte e palëvizshme, sepse ndonjëherë shkonte nga Lindja e ndonjëherë nga Perëndimi, sipas lëvizjes së erërave. Gjithashtu, ujërat e kripur nuk bashkohen me ata të ëmbël, siç është rasti me lumenjtë dhe detet. Pra, kush është ai që ia mësoi Muhammedit alejhis-selam, kurse ai u rrit në shkretëtirë?

KODRAT JANË SHTYLLAT E TOKËS

“A nuk e bëmë Ne Tokën të përshtatshme (për jetë)? Ndërsa kodrat i bëmë shtylla të saj.” (En-Nebe’ë: 6-7)

Malet e larta në tokë luajnë rolin e shtyllave të tendës në përforcimin e saj. Kjo gjë u zbulua në vitin 1956, kur dijetarët zbuluan se malet e larta kanë rrënjë të thella në Tokë, të cilat luajnë rolin e shtyllave. Gjatë hulumtimeve u zbulua se trashësia e sipërfaqes së Tokës nën male arrinë rreth 35 km., derisa në sipërfaqet tjera rreth 5 km. E sikur mos të ekzistonte një gjë e tillë nuk do të na mbante Toka.

Nëse shikojmë ngjashmërinë e shtyllave dhe të kodrave do të vërejmë se ato janë identike. Sepse, që të gjitha ato janë të ngulitura në Tokë dhe pjesa e tyre mbi tokë është më e lartë. Shtyllat dallohen ndërmjet veti sipas paraqitjes së tyre të jashtme dhe sipas lakimit, e po ashtu edhe kodrat. Ngulitja e shtyllave dallohet sipas ngurtësisë, formës dhe masës së ngulitur në Tokë, e po ashtu edhe kodrat. Më interesante nga e gjithë kjo është se shtyllat duhet të jenë përgatitur para ngulitjes së tyre në Tokë, e po ashtu edhe kodrat, sepse ato u formuan nga veprimet zhveshëse, pastaj i paraqiti ato shtypja anësore e kontinenteve të vjetra. Shtyllat nuk mund të nguliten vetvetiu në Tokë, por duhet një fuqi e jashtme që t'i ngulitë ato, kështu që edhe kodrat u ngulitën me ndihmën e fuqisë shtypëse vertikale etj.

BRENDIA E DETIT DHE E TOKËS ËSHTË E ZJARRTË DHE DETET DO TË NDIZEN

“Beto hem në detin e ndezur.” (Et-Tur: 6)

“Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar.” (Et-Tekvir: 6)

“Dhe kur detet të eksplozojnë.” (El-Infitar: 3)

Dhe shumë ajetet të tjera të tilla, të cilat i paraprijnë shkatërrimit të fundit. Zbulimet bashkëkohore vërtetuan se nëntoka është zjarr i flakur, e posaçërisht nëndetet. Ndoshta shumëkush nuk beson se mund të ndizet uji, i cili shuan zjarrin, por një gjë e tillë u vërtetua kur u hodhën bombat atomike në ishujt e Japonisë në fund të Luftës së Dytë Botërore. Ato bomba e ndanë ujin në hidrogjen dhe oksigjen me ç'rast u dogjën një numër i madh i japonezëve. Pastaj, shiko vëllai im, se si njëri nga këto ajete potencon shpërthimin, i cili ndodh nga zjarri shumë i fortë. All-llahu na ndihmoftë.

QIELLI DO TË ÇAHET DHE YJET DO TË SHUHEN

Kaptinat et-Tekvir, el-Infitar, el-Inshikak dhe shumë kaptina të tjera e ajete i potencojnë këto shkatërrime të fundit, të cilat edhe me zbulimet bashkëkohore u vërtetuan dhe ku hulumtimet vazhdojnë ende.

“E kur qielli të çahet. Dhe kur yjet të shkatërrohen.”

“Kur qielli të pëlçasë.”

“Dhe kur qielli të është rrjepur.”

“E kur qielli të çahet e të bëhet kuq si vaji i shkrirë.”, etj...

Këto ajete vërtetojnë atë që tha D. Valter nga Universiteti Kanzas, i cili kishte qëndruar duke vështruar planetët dhe yjet 15 vjet. Ai ishte i bindur se yjet së bashku me Diellin, Hënën dhe Tokën do të çahen e do të shkapërderdhen dhe galaktika jonë do të tretet në Gjithësinë e gjerë. Çdo gjë që ka fillimin ka edhe mbarimin. Dijetari amerikan Edvard Ksil thotë: “Zbulimet shkencore, pa qëllim, vërtetuan se Gjithësia ka fillimin dhe nuk mund të fillojë vetvetiu”. Kurse dijetari Xhejms Xhins thotë: “Gjithësia nuk është pa fillim!”

Vëllai im i dashur, këto ishin vetëm disa nga paralajmërimet dhe mrekullitë kur’anore, të cilat i morëm vetëm si shembuj nga një numër shumë i madh i paralajmërimeve të tilla në të, por, ç’është edhe më interesante, ai, Kur’ani, përmban në vete edhe shumë paralajmërime e sekrete që njeriut i mbeten t’i zbulojë në të ardhmen. Njeriu i parë, i cili duhet të zbulojë dhe të përfitojë nga ky Kur’an, duhet të jetë muslimani. Muhammedi alejhis-selam thotë: “... çudirat e tij kurrë nuk marrin fund... dijetarët kurrë nuk ngopen me të... atë nuk e turbullojnë kohët asnjëherë...”

“Thuaj (Muhammed: ‘Sikur të ishte deti ngjyrë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, ai, deti, do të shterej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, po edhe sikur të sillnim ndihmë edhe një det si ai.” (El-Kehf: 109)

Para se ta përfundoj këtë kapitull, kam dëshirë të them edhe një gjë: disa mendojnë se Kur’ani është vetë shkenca, por ne refuzojmë një gjë të tillë sepse Kur’ani pikësëpari është Fjalë e Zotit, kurse shkenca është mundim (përpjekje) për zbulimin e fjalëve të Zotit. Shkenca ndonjëherë mund të dështojë, kurse Fjalët e Zotit kurrë nuk dështojnë. Kur’ani është nxitës i madh për zbulime, por ai nuk është vetë shkenca sepse është mbi shkencën. Ai është burimi, kurse shkenca

gjurmuesi. Ai na zbuloi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, me një fjalë Fillimin e Mbarimin, kurse shkenca nuk e bën këtë.

Kur’ani, para së gjithash është Udhëzuesi i Rrugës së Drejtë, i rrugës së shpëtimit, është shkëndi ndriçuese, është Ligj i cili duhet praktikuar në jetën tonë të përditshme dhe është rrëfim që duhet të marrim mësim nga ai. Të gjitha mrekullitë dhe paralajmërimet e tij, pothuajse i gjithë Kur’ani, ka një qëllim final: se vetëm All-llahu është Zot i Gjithësisë dhe vetëm Ai, pra, meriton dhe duhet të adhurohet.

All-llahu na udhëzofte në Rrugën e Drejtë.

PARALAJMËRIMET E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM

Muhammedi alejhis-selam, i dashuri ynë, fryti i zemrave tona, nuri ndriçues, i dashuri i All-llahut të Lartësuar, ai që e duam më shumë se vetveten, pasurinë dhe familjen tonë, ai që nxori njerëzimin nga errësira në dritë me urdhrin e All-llahut, thirrësi i Rrugës së Zotit, luftëtari në Rrugën e Tij, zhdukësi i të keqes, i lavdëruari në qiell dhe në Tokë, pejgamberi që nuk dinte as shkrim e as lexim, paralajmërimi i gjithë të dërguarve, e posaçërisht i Isaut alejhis-selam, i dërguari te mbarë njerëzimi, vula e të dërguarve paralajmëroi me urdhrin e All-llahut, e mjerë ai që i dëgjon e nuk i beson, sepse ato janë të qarta sikurse Dielli në ditët e bukura të pranverës.

Në këtë kapitull nuk kam për qëllim t'i paraqes mrekullitë ndijore të Muhammedit alejhis-selam, e të cilat janë më tepër se 1.000 mrekulli, por vetëm fjalët paralajmëruese të tij. Në fillim do t'i paraqes ato që u realizuan, e pastaj edhe ato që akoma nuk janë realizuar.

Paralajmërimet e Muhammedit alejhis-selam janë të shumta, sepse Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se ç'do të ndodhë deri në Ditën e Kijametit, siç transmeton Hudhejfitu Ibnul-Jeman, i cili thotë: “U ngrit Muhammedi alejhis-selam dhe nuk la në atë vend pa përmendur asgjë që do të ndodhë deri në Ditën e Kijametit, e mbajti mend ai që mbajti mend dhe harroi ai që harroi...”

Meqë pas këtij kapitulli vjen kapitulli “Shenjat e Kijametit”, paralajmërimet që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me të do t'i paraqesim në atë kapitull.

Këto paralajmërimet të Muhammedit alejhis-selam, të cilat u realizuan dhe ato të cilat akoma nuk janë realizuar, janë argument i gjallë dhe solid se ai ishte i Dërguar i All-llahut të Lartësuar. Disa nga ato paralajmërimet u realizuan në kohën e Muhammedit alejhis-selam, disa menjëherë pas vdekjes së tij, disa të tjera më vonë, disa janë duke u realizuar tani e disa do të realizohen në të ardhmen.

Kur jemi te paralajmërimet, duhet cekur edhe atë se të gjithë të dërguarit paralajmëruan, prandaj nuk është çudi se disa tekste të Biblës, që nuk janë devijuar, përmbajnë paralajmërimet të vërteta, e disa nga ato janë plotësisht të njëjta me paralajmërimet islame. Por, shumë edhe nga ato janë të devijuara. Megjithatë, kjo është një temë tjetër dhe unë lus All-llahun të dalë nga shtypi së shpejti një libër i cili sqaron të gjitha këto gjëra.

All-llahu na ndihmoftë.

PARALAJMËRIMET E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM TË CILAT U REALIZUAN ASHTU SIÇ I PARALAJMËROI AI PARALAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR ÇDO GJË QË DO TË NDODHË DERI NË DITËN E KIJAMETIT

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi në dy librat e tyre autentikë (Es-Sahihajn) nga Hudhejfitu Ibnul-Jeman-radijall-llahu anhu (shok i ngushtë i Muhammedit alejhis-selam, i cili ruante fshehtësitë e tij), se ai tha: “U ngrit i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam në një vend dhe në atë vend nuk la asgjë pa përmendur se çdo të ndodhë deri në Ditën e Kijametit. E mbajti mend ai që e mbajti mend dhe e harroi ai që e harroi, e kuptuan këta shokët e mi atë. Tani kur diç realizohet (nga ato fjalë) dhe unë e kisha harruar, më kujtohet siç e kujton njeriu fytyrën e njeriut tjetër kur ai është larg nga ai, e pastaj kur ta shohë atë i kujtohet.”

Në një hadith tjetër, Muhammedi alejhis-selam permendi emrat e udhëheqësve të trazirave më të mëdha deri në Ditën e Kijametit. Ai permendi emrat e tyre dhe emrat e baballarëve të tyre, të cilët ishin rreth 30 veta.

PËRCAKTIMI I VENDVRASJEVE TË POLITEISTËVE NË BEDR PARA VRASJES SË TYRE

Transmetojnë Muslimi dhe Ahmed Ibni Hanbeli (imami i medhhebit hanbelit) nga Enes Ibn Maliku, radiall-llahu anhu (shok i njohur i Muhammedit alejhis-selam), se tha: Ishim me Umerin ndërmjet Mekkes dhe Medines dhe vëzhgonim hënën e re. Unë kisha shikim të fortë dhe e pashë atë, e fillova t'i them Umerit: A nuk e sheh (hënën)? Tha: Do ta shoh atë dhe unë jam i shtrirë në shtratin tim. Pastaj filloi të na tregojë për pjesëmarrësit e Bedrit (Betejës së Bedrit) dhe tha: i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, na tregonte dje vendvrasjet e tyre (mushrikëve) e thoshte: “Ky është vendi ku do të vritet filani nesër, in sha All-llah, dhe ky është vendi ku do të vritet filani nesër, in sha All-llah. Tha (Umeri): (Të nesërmen) filluan të vriten në ato vende. Umeri tha: Beto hem në Atë që e dërgoi atë (Muhammedin alejhis-selam) me të vërtetën, nuk i kaluan ata (politeistët) kufijtë që i përcaktoi i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam.”

Në mesin e të vrarëve ishte edhe prijatari i mushrikëve, Firauni i këtij ummeti, Ebu Xhehli, të cilin e plagosën dy fëmijë nga Ensarët, kurse e vrau Abdull-llah Ibn Mes'udi.

PARALAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR VRASJEN E UDHËHEQËSVE TË BETEJËS SË MU'TES PARA ARDHJES SË LAJMIT

Transmetoi Buhariu në Sahihun e tij nga Enes Ibn Maliku, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam i njoftoi për vdekjen e Zejdit, Xhaferit dhe Ibn Ruvahes para se të vijë lajmi i tyre, e tha: “E mori flamurin Zejdi dhe u vra, pastaj e mori atë Xhaferi dhe u vra, pastaj e mori Ibn Ruvaha dhe u vra, dhe i lotonin sytë, derisa e mori atë (flamurin) një shpatë nga shpatat e Zotit (Kishte për qëllim Halid Ibn Velidin, radiall-llahu anhu), dhe i çliroi All-llahu ata.”

Kjo betejë u zhvillua pak para vdekjes së Muhammedit alejhis-selam, derisa ky ishte në Medine, kurse ajo ushtri gjendej në tokat e Shamit, që asokohe ishin nën pushtetin e romakëve. Kur ushtria e muslimanëve u kthye nga tokat e Shamit, kishte ndodhur ashtu siç i kishte paralajmëruar Muhammedi alejhis-selam. Pra, Zejdi, Xhaferi dhe Ibn Ruvaha kishin rënë dëshmorë, kurse Halid Ibn Velidi kishte triumfuar mbi romakët, të cilët ishin me numër shumë më të madh se muslimanët.

LAJMËRIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM PËR LETRËN E HATIBIT QË UA DËRGOI MEKKASVE

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ali Ibn Ebi Talibi, radiall-llahu anhu dhe kerremalla-hu vexh'heh, se tha: Na dërgoi i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, mua, Zubejrin dhe

Mikdadin e na tha: “Shkoni te kopshti Hah (kopsht mes Mekkes dhe Medines) se atje është një robereshë dhe me vete ka një letër, merrjani ate.”

Shkuam ne duke vrapuar kuajt tanë dhe atje e gjetëm atë grua, e i thamë: Nxirre letrën. Ajo na ktheu: Nuk kam asnjë letër. I thamë: Do ta nxjerrish letrën ose do të zhveshesh! Ajo e nxori atë nga gërshetat e flokëve dhe ne erdhëm me të (letrën) te i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, e në të shkruante: Nga Hatib Ibn Ebi Belta njerëzve politeistë në Mekke, i lajmëron për disa çështje të Muhammedit alejhis-selam. Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “O Hatib! Ç’është kjo?” Tha: Mos u ngut me mua o i Dërguar i All-llahut, unë isha një njeri që iu bashkangjita Kurejshëve (ky ishte i ardhur aty), kurse muhaxhirët që janë me ty (emigruesit nga Mekka) kanë të afërm atje (në Mekke) që ua mbrojnë familjet, e meqë nuk kam farefisni me ta, dëshirova të kem dorë nga ata që të m’i mbrojnë të afërmit, dhe këtë nuk e bëra nga kufri apo nga largimi nga feja ime, e as s’jam i kënaqur me kufirin pas Islamit. Atëherë, Muhammedi alejhis-selam tha: “Të vërtetën e tha ky”. Umeri tha: Më lejo o i Dërguar i All-llahut t’i bie kokës së këtij munafiku. I tha (Muhammedi, Umerit): “Ai prezentoj Bedrin (dëshmoi betejën e parë të Bedrit mes muslimanëve dhe idhujtarëve), e nga e di ti (Umer), ndoshta All-llahu shikoi bedrasit (pjesëmarrësit e Bedrit) dhe u tha (All-llahu): “Bëni çka të doni se ju jeni të falur (nuk ka për ju dënim).”

Kjo ngjarje ndodhi kur muslimanët përgatiteshin për çlirimin e Mekkes, e Muhammedi alejhis-selam nuk dëshironte që mekkasit të dinë për këtë përgatitje asgjë. Hatibi e shkroi këtë letër fshehurazi nga shkaqet e permendura në hadith, por All-llahu i Lartësuar e lajmëroi Muhammedin alejhis-selam për këtë letër dhe ajo nuk arriti në Mekke

ÇLIRIMI I HAJBERIT TË NESËRMEN DHE SHËRIMI I SYVE TË ALIUT NGA LUTJA E TIJ

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Sehl Ibn Sa'd, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha Ditën e Hajberit (vend afër Medines ku qëndronin disa çifutë tradhtarë): “Do t’ia jap këtë flamur (nesër) një njeriu që me dorën e tij All-llahu do ta çlirojë (Hajberin), ai e do All-llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe All-llahu e i Dërguari i Tij e duan atë” Tha (transmetuesi): Mbetën atë natë njerëzit duke biseduar se cili do ta marrë atë (flamurin). Ai tha: Kur gdhiu ata shkuan të gjithë te i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, dhe të gjithë shpresonin se do ta marrin atë (flamurin). i Dërguari tha: “Ku është Ali Ibn Ebi Talibi?” Thanë ata: Ja ku është o i Dërguar i All-llahut, është i sëmurë nga sytë. Muhammedi alejhis-selam tha: “Ma thirrni atë”. Kur erdhi Aliu, Muhammedi alejhis-selam fryu në sytë e tij dhe u lut për të, e ai u shërua saçë më nuk ndinte dhembje dhe atëherë i Dërguari ia dha flamurin atij. Aliu tha: O i Dërguar i All-llahut! A t’i luftoj ata derisa të bëhen sikurse ne (muslimanë)? Tha: “Shko ngadalë derisa të zbresish në fushën e tyre e pastaj thirri në Islam, dhe lajmëroi se çfarë obligimi kanë ndaj hakut të All-llahut. Beto hem në All-llahun se që ta udhëzojë All-llahu (në Islam) një njeri nga dora jote, është më mirë për ty sesa t’i fitosh begatitë e kuqe (kope të mëdha të deveve).”

Dhe kështu edhe ndodhi. Aliu, radiall-llahu anhu, e çliroi Hajberin bashkë me muslimanët, edhe pse qyteti ishte i rrethuar me një kala të fortë dhe portë të lartë, të cilën e hapi luani i All-llahut, Aliu, kerremall-llahu vexh’heh. Hajberi është qytet afër Medines, në të cilin asokohe jetonin disa fise hebreje, të cilat disa herë kishin shkëlur marrëveshjet e tyre me muslimanët. Andaj,

Muhammedi alejhis-selam u detyrua t'i luftojë ata dhe t'i largojë nga Gadishulli Arabik përgjithmonë.

NJË LUFTËTAR QË LUFTONTE ME MUSLIMANËT ËSHTË PREJ BANORËVE TË ZJARRIT

Transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga Sehl ibn Sa'di, radiall-llahu anhu, se ai tha: U takuan i Dërguari, Muhammedi alejhis-selam dhe mushrikët në disa beteja dhe luftuan, dhe të dy ushtritë shkuan në kampet e tyre. Në mesin e muslimanëve ishte një njeri i cili nuk linte asnjë të posaçëm apo të veçantë nga mushrikët përveçse i ndiqte dhe u binte me shpatën e tij. Dikush tha: “O i Dërguar i All-llahut, nuk ka bërë askush çka bëri filani (njeriu i përmendur). i Dërguari tha: “Ai (luftëtari) është prej banorëve të zjarrit”. Thanë (shokët e tij): Kush nga ne është prej banorëve të xhennetit nëse ky është prej banorëve të zjarrit?” Njëri nga ata tha: Do ta përcjell atë, do të jem me të kur ai nxiton dhe kur ngadalësohet, derisa kështu ai (luftëtari) u plagos dhe e shpejtoi vdekjen (vrau veten) me shpatën e tij. Atëherë shpejtoi njeriu (i cili e përcillte) te i Dërguari (Muhammedi alejhis-selam): “Ç’është kjo?!” Ai e lajmëroi atë (për atë person). Atëherë, Muhammedi alejhis-selam tha: “Njëmend, njeriu punon me vepra të xhennetit, në shikim të njerëzve, kurse ai është nga banorët e zjarrit, dhe njëmend, njeriu punon me vepra të banorëve të zjarrit, në shikim të njerëzve, kurse ai është nga banorët e xhennetit.”

Ky pra, vëllai im, është argument shumë i rëndësishëm i pejgamberisë së Muhammedit alejhis-selam, sepse ai njeri luftëtar, sipas pamjes së jashtme, ishte muxhahid i madh, por Muhammedi alejhis-selam tha se është nga banorët e zjarrit, dhe në fund u realizua parashikimi i tij. Beteja në të cilën ndodhi kjo ngjarje është beteja me fisin çifut Beni Kurejdha, i cili kishte shkelur marrëveshjen me muslimanët në Luftën e Hendekut dhe iu kishte bashkangjitur idhujtarëve të Mekkes.

NËNA E EBU HUREJRES (TRANSMETUESI I MADH I HADITHEVE) PRANON ISLAMIN NGA LUTJA E MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM

Transmetoi Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Hurejre, radiall-llahu anhu, se ai tha: E thirrja nënën time në Islam derisa ajo ishte politeiste. Një ditë e ftova e ajo më tha për të Dërguarin e All-llahut, Muhammedin alejhis-selam, diç që e urrejta. Atëherë, erdha te i Dërguari i All-llahut duke qarë, e i thashë: O i Dërguar i All-llahut, unë ftoja nënën time në Islam e ajo më refuzonte. Sot e ftova e më tha për ty diç që e urreva, prandaj lute All-llahun që ta udhëzojë nënën e Ebu Hurejres. i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, tha: “Të lutem o Zot, udhëzoje nënën e Ebu Hurejres”. Unë dola i gëzuar nga lutja e të Dërguarit të All-llahut dhe kur u ktheva e iu afrova derës dhe e gjeta të mbyllur. Dëgjova nënën duke shpejtuar e më tha: Qëndro në vendin tënd o Ebu Hurejre. Pastaj dëgjova shushurimën e ujit. Tha (Ebu Hurejre): U pastrua, e veshi këmishën e saj dhe shpejtoi te shamia, e pastaj e hapi derën dhe tha: O Ebu Hurejre, dëshmoj se

nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i Dërguar i Tij. Tha (Ebu Hurejre): U ktheva te i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-salam, duke qarë nga gëzimi, e i thashë: o i Dërguar i All-llahut gëzohu se All-llahu iu përgjigj lutjes sate dhe e udhëzoi nënën e Ebu Hurejres. E falënderoi All-llahun dhe e lartësoi Atë e tha hajr. Tha (Ebu Hurejre): Thashë: O i Dërguar i All-llahut, lute All-llahun të na bëjë të dashur, mua dhe nënën time, tek robtë e All-llahut dhe të na i bëjë të dashur neve ata. Tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-salam: “Të lutem o Zot bëre të dashur këtë rob Tëndin dhe nënën e tij tek robërit Tu besimtarë dhe bëri të dashur besimtarët për ata.” E çdo besimtar që dëgjonte për mua apo më shihte më donte.

Ky sahabij, Ebu Hurejre, është transmetuesi më i madh i haditheve. Dhe ne dëshmojmë se të duam o Ebu Hurejre, e pse jo, kur ti i përcolle deri te ne fjalët e vulës së të dërguarve.

Shiko pra, vëllai im, se sa shpejtë All-llahu ia ndryshoi zemrën nënës së Ebu Hurejres dhe ajo e pranoi Islamin.

“Të lutem o Zot, o rrotullues i zemrave, përforcoi zemrat tona në Islam derisa te takohemi me Ty”.

UMERI DHE UTHMANI, RADIAL-LLAHU ANHUMA, DO TË VDESIN SHEHIDË

Transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga Enes Ibn Maliku, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam, Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani, radiall-llahu anhum, u ngjitën në kodrën e Uhudit (kodër përballë Medines, dhe kjo në Betejën e Uhudit) e kodra u trondit. Atëherë tha (Muhammedi alejhis-selam): “Qetësohu o Uhud, se mbi ty qëndrojnë i Dërguari, Siddiku (shumë i sinqerti, Ebu Bekri) dhe dy shehidë (Umeri e Uthmani).”

Dhe kështu në të vërtetë edhe ndodhi. Ebu Bekri ishte Siddiku (shumë i sinqerti dhe besimtari i madh), i cili vdiq pasi që ishte halif i muslimanëve dy vjet dhe nuk u vra. Kurse dy shehidët (dëshmorët e Islamit) ishin Umeri dhe Uthmani. Që të dy këta u vranë derisa ishin zëvendës të Muhammedit alejhis-selam në halifatin islam, disa vjet pas vdekjes së Muhammedit alejhis-selam.

Umerin, radiall-llahu anhu, e vrau Ebu Lu’lu-i, i cili ishte rob persian, derisa ishte duke falur sabahun me muslimanët në Xhaminë e Muhammedit alejhis-selam. Kurse Uthmani, radiall-llahu anhu, po ashtu u vra në Medine nga disa duar të fëlliqura të cilat ishin ngritur kundër këtij personaliteti të famshëm, dhun-nurejni (burri i dy dritave, dy bijave të Muhammedit alehis-selam).

ALIU, RADIALL-LLAHU ANHU, GJITHASHTU DO TË BIE SHEHID

Transmeton Ammar Ibn Jasiri, radiall-llahu anhu, se i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, tha: “A t’ju tregoj për dy njerëz me të palumtur?! Ata janë Uhajmiri i Theudit (fis i hershëm), i cili preu devenë (e cila ishte mrekulli e Zotit), dhe ai që të mëshon o Ali mbi këtë (i bëri me shenjë kokën), derisa të laget kjo (i bëri me shenjë mjekrën).”

Aliu, radiall-llahu anhu, u vra derisa kishte dalur në mëngjes herët për ta falur sabahun. Atëherë i doli përpara zjarrputisti Mulxhemi, i ra mbi kokë me një thikë të madhe derisa dukej gjaku në mjekrën e tij, dhe kështu u realizua fjala e Muhammedit alejhis-selam.

Pra, edhe Aliu, radiall-llahu anhu, u vra në kohën kur ishte halif i muslimanëve.

ÇLIRIMI I PERSISË DHE SHTIMI I PASURISË

Transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga Adij Ibn Hatimi, radiall-llahu anhu, se ai tha: Derisa isha te i Dërguari, Muhammedi alejhis-selam, iu afrua një njeri dhe iu ankua për varfërinë e tij, pastaj erdhi një njeri tjetër dhe iu ankua për prerësit e rrugës (vrasësit). i Dërguari tha: “O Adij! E ke parë Hirën (vend në Irak)?” I thashë: Nuk e kam parë, por kam dëgjuar për të, e ai tha: “Nëse ke jetë të gjatë, do ta shohish gruan e cila niset nga Hira e derisa të bëjë Tavafin rreth Qabes, nuk do t’i frikohet me atë rast askujt përveç All-llahut”. Thashë në vetvete: E ku janë shkatërruesit e Tajjit (fis) që bëjnë sherr nëpër qytete?! Vazhdoi Muhammedi alejhis-selam duke thënë: “Nëse

keni jetë të gjatë, do t'i hapni thesaret e Kisrasë”. I thashë: Kisraja, i biri i Hormuzit?! Tha: “Kisraja i biri i Hormuzit, dhe nëse t'i ke jetë të gjatë do ta shohish njeriun duke dalur duart plot me arë e argjend, hulumton dike që t'ia merr e nuk gjenë askënd që t'i marrë ato, dhe do ta takojë All-llahun ndonjëri nga ju, ditën që do ta takojë Atë, dhe ndërmjet atyre dyve nuk ka përkthyes që t'i përkthejë Atij, e i thotë (All-llahu): A nuk ta dërgova Të dërguarin që të të komunikojë? Thotë ai(njeriu): Gjithsesi. Atëherë i thotë: A nuk të dhash pasuri dhe gjëra më të mira se ajo? Thotë ai: Gjithsesi (o Zot). Atëherë ai (njeriu) shikon nga ana e djathtë e nuk sheh tjetër përveç xhehennemit, dhe shikon nga ana e majtë e nuk sheh tjetër përveç xhehennemit”. Tha Adiji: E dëgjova të Dërguarin e All-llahut, Muhammedin alejhis-selam, duke thënë (në atë moment): “Ruajuni zjarrit qoftë edhe me ndarjen e një hurme (përgjysmë), e ai që nuk ka mundësi të ndajë një hurme, le të thotë një fjalë të bukur.” Tha Adiji: Unë pashë gruan duke udhëtuar prej Hirës (në Irak) derisa bënte Tavafin rreth Qabes (në Mekke) dhe nuk i frikohej askujt përveç All-llahut, dhe unë mora pjesë në hapjen e thesareve të Kisrasë, të birit të Hormuzit, e nëse keni jetë të gjatë do ta shihni atë që tha i Dërguari, Ebul-Kasimi (ofiqi i Muhammedit alejhis-selam) alejhis-selam: Do të dalë njeriu duart e tij plot me arë dhe argjend...

Gjatë emigrimit të Muhammedit alejhis-selam nga Mekka në Medine, atë e ndiqte Suraka Ibn Maliku, që t'i fitojë nga Kurejshët politeistë devet e premtuara, dhe kur i mbërriu Muhammedin alejhis-selam dhe Ebu Bekrin, radiallyllahu anhu, kalit të tij iu ngulitën këmbët në tokë dhe nuk mund të lëvizte. Atëherë, Muhammedi alejhis-selam iu kthye atij, e i tha “Çka mendon ti (Suraka) nëse i vë bylyzykët e Kisrasë.”

Në kohën e Umerit, radiall-llahu anhu, kur Sa'd Ibnul-Vekkasi e çliroi Persinë, Suraka Ibn Maliku i vuri bylyzykët e Kirasë., të cilat Muhammedi alejhis-selam ia premtoi derisa e ndjeknin për ta vrrarë. Por, nuk vritet ai që mbrohet nga All-llahu i Lartësuar.

Koha kur pasuria u shtua pa masë, është koha e halifit të devotshëm Umer Ibn Abdul-Azizit, i cili ishte pasardhës i Umerit, radiall-llahu anhu. Në kohën e tij nuk gjendej askush që t'i jepej zeqati.

ÇLIRIMI I SHAMIT DHE I EGJIPTIT

Buhariu dhe Muslimi në Sahihët e tyre nga Ebu Hurejre, radiall-llahu anhu, transmetojnë se ai tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “Kur të shkatërrohet Kisraja, nuk ka Kisra më pas tij, dhe kur të shkatërrohet Kajseri, nuk ka Kajser më pas tij. Betohem në Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhammedit, ju do t'i shpenzoni thesaret e tyre në rrugën e Zotit.”

Imam Shafiu dhe disa dijetarë thonë: Domethënë, nuk do të ketë Kisra në Irak dhe Kajser në Sham siç ishte në kohën e tij, dhe kështu edhe ndodhi. Kirasë i'u ndërpre mbretëria përgjithmonë nga e gjithë toka, ndërsa Kajseri pësoi disfatë në Sham dhe iku në vendet më të thella të tij, kurse, muslimanët i çliruan ato vende dhe pasuritë e tyre i shpenzuan në rrugën e Zotit, siç paralajmëroi hadithi. Lexoni historinë nëse dëshironi ta vërtetoni këtë.

“Vërtet, në këtë ka argumente për ata që kanë mendje të shëndoshë dhe ia vënë veshin.”

ARDHJA E UVEJS EL-KARNIT DHE PËRSHKRIMI I TIJ

Transmetoi Muslimi në Sahihun e tij nga Esir Ibn Xhabiri, se ai tha: Umer Ibnul-Hatabi, radiall-llahu anhu, kur i vinin çetat nga Jemeni e kishte zakon t'i pyes: A është me ju Uvejs El-Karni? Erdhi Uvejsi (në një nga ato çeta) e i tha: Ti je Uvejs El-Karni?! Tha ai: Po. I tha: Nga Muradi dhe pastaj nga Karni (dy vende)?! Tha ai: Po. I tha: Ishe i sëmurë nga lepra dhe je shëruar përveç një vendi sa një dirhem?! Tha ai: Po. I tha: A ke ti nënë?! Tha ai: Po. I tha: Dëgjova Të dërguarin e All-llahut, Muhammedin alejhis-selam, duke thënë: “Do t’ju vijë Uvejs El-Karni me çetat e Jemenit, ai është nga Muradi e pastaj nga Karni. Ishte i sëmurë nga lepra dhe është shëruar përveç një vendi sa një dirhem, ai ka nënën ndaj së cilës është bamirës i madh, sikur të betohet në All-llahun, Ai do ta pranonte atë (lutjen e tij), nëse ke mundësi të kërkojë falje ai për ty, bëne atë”. Ti pra kërko falje për mua, e ai u lut për te.

Kjo u realizua pas vdekjes së Muhammedit alejhis-selam. Qoftë i Lartë Ai që ia mësoi të gjitha këto të Dërguarit të Tij.

HASANI, RADIALL-LLAHU ANHU, DO TË PAJTOJË DY GRUPE TË MËDHA TË MUSLIMANËVE

Transmetoi Buhariu nga Ebu Bekrete, radiall-llahu anhu, se ai tha: Një ditë Muhammedi alejhis-selam e mori Hasanin (djalin e Fatimesë dhe të Aliut, radiall-llahu anhum) dhe hipi me te në

minber, e tha: “Biri im, ky është zotëri, All-llahu me të do të pajtojë dy grupe të mëdha të muslimanëve”.

Dhe ndodhi ashtu siç paralajmëroi ai, sepse kur Hasani, radiall-llahu anhu, u zgjodh për halife pas babait të tij, ai u nis me ushtrinë e tij kah Shami e u takuan me Muavijen dhe ushtrinë e tij në vendin e quajtur Siffin, ku të dy ushtritë u radhitën që të luftojnë. Atëherë, Hasani, radiall-llahu anhu, ia dorëzoi halifatin Muavijes dhe mbajti një hutbe të gjatë para ushtrisë, kurse Muavijes iu betuan të dy palët ushtarake. Kjo ndodhi në vitin 40 h. i cili u quajt Vit i xhematit (bashkimit).

Hasani, radiall-llahu anhu, është biri i Fatimesë alejhis-selam, vajzës më të dashur të Muhammedit alejhis-selam. Ajo gjithashtu është gruaja e luanit të All-llahut, Aliut, kerramall-llahu vexh’hehu.

HUSEJNI, RADIALL-LLAHU ANHU, DO TË BIE SHEHID

Transmetoi Ahmedi nga Aisheja dhe Ummi Seleme, radiall-llahu anhumë, se Muhammedi alejhis-selam i tha njëherë nga ato: “Ka hyrë një melaqe në shtëpi që më parë kurrë nuk kishte hyrë tek unë, e më tha: Biri yt, Husejni do të vritet, e nëse dëshiron mund ta shohish dheun e tokës në të cilin do të vritet”. Tha (Muhammedi alejhis-selam): “Më nxori mua një dhë të kuq”.

Dhe kështu ndodhi. Zotëria i rinisë së xhennetit u vra në tokën e kuqe të Irakut në Kerbela. Vetë fjala Kerbela do të thotë: bela, tragjedi. I mallkuar është ai që zgjati dorën ta vrasë atë. Husejni,

radiall-llahu anhu, dhe shumë shehidë të tjerë janë simbol i luftës dhe vullnetit të madh në rrugën e Zotit. Husejni ishte biri i vajzës së Muhammedit alejhis-selam.

MUSLIMANËT DO TA ÇLIROJNË KONSTANTINOPOJËN (STAMBOLLIN) DHE ROMËN

Transmeton imam Ahmedi nga Ebi Kubejli, se ai tha: Ishim te Abdull-llah Ibn Amr Ibnul-Asi dhe dikush e pyeti: Cili nga dy qytetet çlirohet i pari, Konstantinopoja apo Roma? Atëherë Abdull-llahu kërkoi një arkë e cila kishte një hallkë, e tha (Ebi Kubejli): Nxori nga ajo një letër, e tha Abdull-llahu: Ishim të ulur rreth Muhammedit alejhis-selam dhe shkruanim, kur dikush e pyeti të Dërguarin e All-llahut: Cili nga dy qytetet do të çlirohet i pari, Konstantinopoja apo Roma? Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam,: “Qyteti i Heraklit do të çlirohet i pari”, d.m.th. Konstantinopoja.

Ashtu siç paralajmëroi Muhammedi alejhis-selam ashtu edhe ndodhi, sepse Konstantinopoja u çlirua e para nga sulltani Muhammed El-Fatihu, më se 800 vjet pas paralajmërimit të Muhammedit alejhis-selam.

Në një hadith tjetër përmendet edhe një çlirim i tij pak para zbritjes së Isaut alejhis-selam, e nuk është çudi kur shohim se sa është shkatërruar dhe sa shkatërrohet Stambolli në ditët tona. Hadithi ka për qëllim se Stambollit do t’i rikthehet fama islame siç e kishte në ditët e para të çlirimit të tij.

MUHAMMEDI ALEJHIS-SELAM DO TË VDESË NGA SËMUNDJA E TIJ E FUNDIT DHE FATIMEJA (VAJZA E TIJ) ËSHTË E PARA NGA FAMILJA E TIJ QË DO T'I BASHKANGJITET

Transmetoi Buhariu nga Aisheja, radiall-llahu anha, se ajo tha: E thirri i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam bijën e tij Fatimenë në sëmundjen e tij nga e cila vdiq, e i tha diç fshehurazi. Atëherë ajo qau, pastaj i tha përsëri diç e ajo qeshi. Tha (Aisheja): E pyeta për këtë (pas vdekjes së tij), e më tha: Më foli fshehurazi Muhammedi alejhis-selam e më lajmëroi se do të vdesë nga kjo sëmundje e tij nga e cila vdiq e unë qava, pastaj më foli (fshehurazi) e më tha se unë jam e para nga familja e tij që do t'i bashkangjitem atij (në botën tjetër), e unë qesha.

Pra, Muhammedi alejhis-selam pas disa ditëve vdiq nga ajo sëmundje, kurse Fatimeja, radiall-llahu anha, vdiq gjashtë muaj pas vdekjes së Muhammedit alejhis-selam dhe kështu ishte e para nga familja e tij që iu bashkangjiti atij në praninë e Mbretit të fuqishëm, All-llahut të Lartësuar. E lusim Atë të na bashkojë bashkë me ata në praninë e Tij.

NË NJËRIN KRAH TË MIZËS ËSHTË SËMUNDJA KURSE NË TJETRIN ËSHTË SHËRIMI

Transmetoi Buhariu nga Ebu Hurejre, radiall-llahu anhu, se i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam tha: “Kur të bie miza në enën e ndonjërit prej jush, le ta zhytë atë krejtësisht pastaj le ta hedhë, sepse në njërin krah të saj është sëmundja kurse në krahun tjetër është shërimi”.

Këtë, hulumtimet shkencore e vërtetuan para disa viteve.

Kur miza bie në vende të ndotura ajo me disa nga ato ushqehet e disa papastërti i bart me trupin e saj (i ngjiten në trup), kështu që në trupin e saj formohet një lloj mburoje kundër atyre mikrobeve që i bartë, e asaj nuk i bëjnë dëm. Kjo mburojë është e ngjashme me ilaçet që përdoren kundër sëmundjeve, e kur miza bie në enë ajo i len aty ato mikrobe të cilat janë të dëmshme, e ne e zhytim atë krejtësisht në enë me ç’rast ajo i liron elementet shëruese kundër atyre mikrobeve, dhe me këtë rast ne kemi fituar edhe sëmundjen por edhe shërimin e saj.

A nuk është ky argument jashtëzakonisht bindës se Muhammedi alejhis-selam ishte i Dërguar?!

Gjithashtu, Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se enën që e lëpinë qeni duhet larë shtatë herë, e të shtatën herë me dhë, përndryshe nuk pastrohet. Edhe këtë hulumtimet bashkëkohore e vërtetuan në ditët tona.

PERSIANËT DO TË MARRIN FUND SË SHPEJTI, PËRGJITHMONË, KURSE ROMAKËT (SHTETET E PERËNDIMIT) DO TË MBIJETOJNË NDËR SHEKUJ

Transmetohet nga Muhajrizi, se ai tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “Persia do të përjetojë një zhdukje apo dy dhe nuk do të ketë Persi më, kurse romakët, TË ZOTËT E SHEKUJVE, kurdo që shkatërrohet një shekull atë e zëvendëson një shekull tjetër, ata janë të zotët e gurëve dhe deteve. Ehu, deri në fund të kohës ata janë shokët tuaj (o muslimanë) derisa ka jeta hajr...”

All-llahu Ekber! Kuptimi i këtij hadithi është se Persia do të luftohet një herë apo dy herë dhe ajo do të marrë fund përgjithmonë. Kështu edhe ndodhi. Këtë e cekëm më parë se persianët morën fund përgjithmonë, e sot është në fuqi Shteti islam i Iranit (edhe pse me bindje shiite). Kurse romakët “TË ZOTËT E SHEKUJVE” d.m.th. me ta do të luftoni me shekuj, kurdo që i luftoni në një shekull dhe triumfoni, ata rikthehen prap gjatë shekujve të tjerë. Dhe mu kjo ndodhi me shtetet romake. Kryqëzatat janë argumenti më i madh i vërtetësisë së këtyre fjalëve. Kurse fjalët “të zotët e gurëve dhe të deteve” d.m.th. se ata janë të qëndrueshem, apo ndoshta sinjalizojnë përparimin ushtarak të madh si në dete ashtu edhe në tokë. Fjalët “ehu, deri në fund të kohës...” d.t.th. se muslimanët do të kenë përlëshje me ta deri në fund të botës. Këtë e vërteton gjendja e pikërishtme e luftërave perëndimore kundër Islamit dhe do ta vërtetojë edhe e ardhmja deri në zbritjen e Isaut alejhis-selam.

POPUJT DO TË BASHKOHEN KUNDËR MUSLIMANËVE ASHTU SIÇ BASHKOHEN NGRËNËSIT RRETH PJATËS

Transmeton Hudhejfetu Ibnul-Jemani, i cili thotë: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “Gati janë popujt t’ju rrethojnë ashtu siç rrethohen ngrënësit rreth pjatës.” Tha njëri: A pse jemi pak atë ditë? Tha: “Ju atë ditë jeni shumë, por jeni sikur shkuma e detit. Do ta nxjerrë All-llahu nga zemrat e armiqve tuaj frikën nga ju, dhe do fusë në zemrat tuaja dobësinë.” Tha njëri: E ç’është dobësia? Tha: “DASHURIA PËR JETË DHE URREJTJA E VDEKJES”. Në një hadith tjetër thuhet: “...dhe urrejtja e luftës në rrugën e Zotit”.

Ja pra, vëllai im, Bosnja, Palestina, Kashmiri, Kosova dhe pothuajse të gjitha vendet islame janë dëshmi e gjallë e këtyre sulmeve armiqësore që ta zhdukin të vërtetën. Gjendja e shumicës muslimane, dashuria e tyre e flaktë për jetën dhe urrejtja e luftës dhe e dëshmisë në rrugën e Zotit, i vërtetojnë fjalët e Muhammedit alejhis-selam. Pra, a ka dikush që merr mësim nga kjo?!

UMMETI ISLAM DO T’I IMITJË POPUJT E TJERË, EDHE NËSE ATA HYJNË NË BIRËN E HARDHUCËS, DO TË SHKOJË PAS TYRE

Transmetohet nga Ebi Seid El-Huderijju, radiall-llahu anhu, se tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Vërtet, do të ndiqni rrugën e atyre që ishin para jush pëllëmbë për pëllëmbë dhe krah për

krahu, edhe nëse ata hynë në birën e hardhucës do të hyni pas tyre”. I thamë: O i Dërguar i All-llahut, a ke për qëllim (se do t’i pasojmë) çifutët dhe të krishterët? Tha: “E kë, pra!”

A nuk është gjendja momentale ajo e cila më së miri i dëshmon këtë fjalë peygamberike. Edhe pse muslimanët e kanë të qartë se çifutët dhe të krishterët nuk ndjekin rrugën e pastër e të vërtetë, prapëseprapë muslimanët i imitojnë ata porsì papagajtë, kurse Islamin e hedhin pas shpine, sepse Perëndimi e urren atë. Pra, Perëndimi u fut në birën e hardhucës por edhe muslimanët pas tij, edhe pse është e qartë se Perëndimi shkon drejt një humnere që s’ka fund.

GJENDJA POLITIKE E UMMETIT ISLAM DERI NË FUND TË KOHËS

Transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij nga Hudhejketu Ibnul-Jemani, se ai tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “ËSHTË ME JU SHPALLJA SA TË DËSHIROJË ALL-LLAHU TË JETË ME JU, PASTAJ E NGRITË ATË (Përgjithmonë) KUR TË DËSHIROJË, PASTAJ DO TË VIJË HALIFATI SIPAS RRUGËS SË SHPALLJES DHE DO TË MBETET SA TË DËSHIROJË ALL-LLAHU, E PASTAJ DO TA NGRITË ATË KUR TË DËSHIROJË. MË VONË DO TË VIJË MBRETËRI TRASHËGUESE DHE DO TË MBETET SA TË DËSHIROJË ALL-LLAHU, E PASTAJ DO TA NGRIT KUR TË DËSHIROJË. DO TË VIJË MBRETËRI SHITYPËSE DHE DO TË MBETET SA ALL-LLAHU DO TË DËSHIROJË TË MBETET AJO, PASTAJ DO TA NGRITË KUR TË

DËSHIROJË AI. PASTAJ DO TË VIJË HALIFATI (Edhe një herë) SIPAS RRUGËS SË SHPALLJES.”, Pastaj Muhammedi alejhis-selam heshti.

Disa dijetarë e komentuan këtë hadith kështu: Koha e shpalljes është koha e Muhammedit alejhis-selam; koha e halifatit është koha e katër halifeve të parë: Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut, radiall-llahu anhum, të cilën kohë në një hadith tjetër Muhammedi alejhis-selam e përcaktoi VETËM 30 VJET, aq sa mori fund koha e tyre. Koha e mbretërisë përçarëse ishte periudha prej përfundimit të kohës së katër halifeve e deri në kohën e sulltanit të fundit, sepse kjo periudhë u karakterizua me përçarje dhe konflikte të ndryshme. Koha e mbretërisë shtypëse është koha e revolucioneve bashkëkohore dhe e shtypjes së njerëzimit, e posaçërisht e Islamit, sepse ai është adhurim dhe ligj, fe dhe sistem i cili duhet të udhëheqë qeverinë, por një gjë e tillë nuk i lejohet askund dhe luftohet me të gjitha mundësitë nga ummetet e kufrit.

Nëse ky mendim i disa dijetarëve është i drejtë, atëherë ne sot gjendemi në kohën para kohës së kthimit të halifatit, sipas rrugës së shpalljes, kur Toka do të mbushet me drejtësi pasi që ishte e mbushur me mizori.

Lus All-llahun e Lartësuar që ne ta përjetojmë atë kohë. Me një fjalë, ajo është koha kur muslimanët do ta kuptojnë Islamin me kuptimin e tij të vërtetë, e kurdo që muslimanët e kuptojnë Islamin ashtu siç është në të vërtetë, pa dyshim se do të triumfojnë.

Dhe shumë e shumë paralajmërime të tjera të cilat do t'i përmendim, in sha All-llah, në kapitullin e ardhshëm nën temën “SHENJAT E KIJAMETIT”, sepse ato i përshtaten plotësisht asaj teme.

Lutja jonë e fundit është: I gjithë falënderimi qoftë për All-llahun, Krijuesin e të gjitha botëve.

LAJMET E KOHËS SË FUNDIT DHE SHENJAT E KIJAMETIT

Transmetohet nga Aliu, radiall-llahu anhu ve kerremall-llahu vexheh, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Shenjat e afrimit të Kijametit janë: kur njerëzit i braktisin namazet (nuk i falin); humbin amanetin (besnikërinë); zhyten në mëkate të mëdha dhe hanë kamatën; marrin rryshfetin; ngritin lart ndërtesat; ndjekin epshet e tyre; shesin fenë për këtë botë; Kur’anin e shndërrojnë në muzikë; lëkurat e egërsirave i bëjnë kolltuqë; xhamitë i bëjnë rrugë (nuk hyjnë por t’u falur në to); veshin mendafshin; shtohet mizoria, përhapet kurvëria, shkurorëzimi bëhet shumë i lehtë; i besohet tradhtarit e nuk i besohet besnikut; shiu pakësohet; femija bëhet dëmsjellës; udhëheqësit degjenerohen; ministrat bëhen genjeshtarë; besnikët bëhen tradhtarë, të diturit bëhen mizorë, pakësohen dijetarët; shtohen lexuesit (kurrât), pakësohen fukahâtë (njohësit e fortë të fesë); zbukurohen mus’hafat dhe xhamitë, lartësohen minberet, prishen zemrat; ftohen këngëtarët (që të këndojnë); lejohet muzika dhe instrumentet, konsumohet alkooli; nuk praktikohen ligjet e shariatit; pakësohen muajt (siç duket, ka për qëllim udhëtimin e shpejtë në një vend të largët); prishen marrëveshjet; gruaja e shoqëron burrin në tregti; gratë shalojnë kuajt (ndoshta ka për qëllim mjetin transportues çfarëdo qoftë ai); gratë bëhen si burrat e burrat si gratë, nuk betohet më në Zotin, dëshmon njeriu pa qenë dëshmitar fare; zeqati bëhet gjobë (tatim) e amaneti bëhet fitim, burri i nënshtrohet gruas së tij; nuk respektohet nëna, internohet babai, udhëheqjet shndërrohen në trashëgimi; të fundit e këtij ummeti shajnë të parët e tij; njeriu e mirëpret tjetrin duke iu ruajtur sherrit të tij, shtohen forcat e rendit (policët); injorantët hipin në minberë (për të ligjëruar); burrat veshin kurora, rrugët ngushtohen (siç është rasti në ditët tona), ndërtesat lartësohen, burrat u afrohen burrave (homoseksualët) dhe gratë grave; shtohen këshilluesit e

minberëve tuaj, dijetarët tuaj u mbështeten udhëheqësve tuaj, ua lejojnë haramin e ua ndalojnë hallallin dhe gjykojnë sipas dëshirës së tyre; dijetarët tuaj mësojnë diturinë që t'ua marrin dinarin e derhemin; Kur'anin do ta bëni tregti, nuk do ta jepni hakun e All-llahut nga pasuria juaj; pasuritë tuaja do t'i marrin më të këqijtë në mesin tuaj; do t'i ndërpreni marrëdhëniet fafesisnore; alkoolin do ta përdorni në klubet tuaja; do të luani bixhoz; do të bëheni mendjemëdhenj, do të merreni me këngë e muzikë; atyre që kanë nevojë për zeqatin tuaj do t'ua ndaloni atë dhe do ta merrni atë (zeqatin) si gjobë; do të vritet i pafajshmi që të hidhërohet shumica me vrasjen e tij; dëshirat tuaja do të ndryshojnë; dhënia do t'u mbetet robërve dhe njerëzve të thjeshtë; do të bëhen mashtrime në kandar dhe çështjet tuaja (pushtetin) do t'i marrin përsipër mendjelehtët.”

Transmetohet nga Hudhejfitu Ibnul-Jeman, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Shtatëdhjetë e dy cilësi janë shenja të afrimit të Kijametit: Kur t'i shihni njerëzit se u kanë vdekur namazet (nuk i falin); e kanë humbur besnikërinë; e shfrytëzojnë kamatën; e lejojnë rrenën; gjakun e bëjnë të lirë (vrasin lehtë); i përdorin ndërtesat (i ndërtojnë ato); e shesin fenë për këtë botë; i ndërprejnë lidhjet fafesisnore; gjykimi bëhet i dobët (nuk gjykohet drejt); rrena besohet; mëndafshi vishet; përhapet mizoria; shtohen rastet e shkurorëzimit dhe vdekja e papritur; tradhtarit i besohet e besnikut nuk i besohet; i besohet gënjeshtarit dhe përgënjeshtrohet besniku; shtohen shpifjet; shiu pakësohet; fëmija bëhet dëmsjellës; koprracët përhapen shumë dhe fisnikët zhduken; udhëheqësit bëhen të korruptuar; ministrat gënjeshtarë e sekretarët tradhtarë; dijetarët mizorë dhe kurrât (lexuesit e Kur'anit) të prishur... zemrat e tyre janë më të kalbura se qelbësira; sabri humbet. Atëherë Zoti i përfshinë ata me një trazirë që të përpëliten në të sikurse çifutët mizorë, paraqitet e verdha (ka për qëllim shtimin e dinarit) dhe kërkohet e bardha (ka për qëllim dirhemin); ligjëruesit shtohen ndërsa numri i atyre që urdhërojnë në të mira dhe ndalojnë nga të

këqijat pakësohet; mus'hafët zbukurohen dhe xhamitë vizatohen (me lloj-lloj shkrime); minberët lartësohen (vendet e ligjërimit); zemrat prishen; alkooli pihet, ndëshkimet (ligjet islame) nuk praktikohen; robëresha lind zonjën e saj, i sheh të zbathurit e të zhveshurit u bënë mbretër; gruaja e shoqëron burrin në tregtinë e tij; burrat bëhen si gratë e gratë si burrat; betimi nuk bëhet në Zotin (betohet në diç tjetër); njeriu dëshmon pa qenë dëshmitar i ngjarjes; i dorëzohet njohurisë (ndoshta ka për qëllim shkencën, e cila konsiderohet si zot), qëllimi i kërkimit të diturisë nuk do të jetë feja; kjo botë do të kërkohet me vepra të ahiretit... kur të ndodhë e gjithë kjo, le të presin një erë të kuqe, shafime (të Tokës), gjuajtje (nga qielli) dhe shenja (të mëdha)...”

DITA E KIJAMETIT PA DYSHIM DO TË VIJË

Besimi në Ditën e Kijametit është prej bazave themelore të fesë së All-llahut dhe refuzimi i saj do të thotë refuzim i fesë në përgjithësi. Pothuajse nuk ekziston asnjë faqe e Kur'anit e cila nuk e sinjalizon apo nuk e përmend këtë Ditë të madhe. Ky përkujtim i shpeshtë i kësaj dite në Kur'an, rrjedh nga ajo se njerëzit e harrojnë atë Ditë si shkak i problemeve të tyre ditore të shumta. Gjithashtu, All-llahu i Lartësuar dëshiroi të na përqëndrojë vemendjen në këtë Ditë shumë të madhe dhe definitive për njerëzimin, andaj edhe i frikëson robërit e Tij me atë Ditë.

“O ju njerëz! Ruajuni Zotit tuaj, se njëmend, dridhja e Kijametit është një gjë shumë e madhe. Atë ditë, kur ta shihni ju atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjini, dhe secila shtatzënë e

hedhë barrën e vet, dhe t'i i sheh njerëzit të dehur, mirëpo ata nuk janë të dehur por dënimi i Allahut është i ashpër.” (El-Haxh: 1-2)

“Nëse ju mohoni, atëherë si do t'i mbroheni Ditës kur fëmijët do t'i bëjë (trishtimi i asaj dite) pleq! Atë ditë qielli do të çahet dhe premtimi i Tij veçmë është realizuar.” (El-Muzzemmil: 17-18), etj.

Se kjo ditë është shumë me rëndësi, argumenton fakti se All-llahu i Lartësuar shumëherë e bashkangjiti besimin e saj me besimin e All-llahut, sepse nuk mund të mendohet besimi në All-llahun e të mos besohet Dita e Tij e Gjykimit.

Shpeshherë Kur'ani për këtë ditë flet sikurse ajo tashmë ka ndodhur, dhe dëshiron t'i tregojë njerëzimit se sado që ju bini në konflikt dhe dyshim rreth saj, ajo për Mua tashmë ka marrë fund, por ju nuk besoni.

Gjithashtu, All-llahu i Lartësuar paraqiti një numër të madh argumentesh logjike, konkrete e shkencore se kjo ditë do të realizohet. Ne këtu nuk kemi për qëllim prezentimin e atyre argumenteve, sepse kjo i përket një teme tjetër. Mjafton që njeriu të njihet me mendimet e hulumtuesve shkencorë e të bindet se ajo katastrofë do të ndodhë dhe ne që më parë cekëm disa nga ato mendime. Ne këtu kemi për qëllim paraqitjen e thënieve dhe të paralajmërimeve të Muhammedit alejhis-selam dhe të ndodhive e shenjave që paraqiten para asaj dite. Realizimi i atyre paralajmërimeve dje, sot dhe nesër, argumenton dy gjëra: **SE AI QË PARALAJMËROI ËSHTË I DËRGUAR DHE SE AJO QË PARALAJMËROHET, GJITHSESI DO TË VIJË.**

Paralajmërimet të cilat i theksoi Muhammedi alejhis-selam, dijetarët islamë i ndanë në dy grupe kryesore:

SHENJAT E VOGLA DHE SHENJAT E MËDHA

SHENJAT E VOGLA, gjithashtu ndahen në dy pjesë: ATO QË KANË NDODHUR DHE ATO QË DO TË NDODHIN. Disa shenja të vogla që kanë ndodhur njëherë, ndërkohë mund të përsëriten, e disa nga ato nuk përsëriten por ndodhin vetëm një herë.

SHENJAT E MËDHA ndodhin vetëm një herë, dhe atë vetëm para Kijametit.

A ËSHTË AFËR KIJAMETI?!

All-llahu i Lartësuar i shpalli Muhammedit alejhis-selam, para më se 1415 vjetëve, se u afrua Kijameti:

“U afrua momenti (i Kijametit), e Hëna u ça.” (El-Kamer: 1)

Çarja e Hënës ishte një nga mrekullitë më të mëdha të Muhammedit alejhis-selam, të cilën e panë pothuajse të gjithë idhujtarët. All-llahu këtë ngjarje e cilësoi si afrim i Kijametit (në krahasim me kohën që kaloi bota para Muhammedit alejhis-selam).

Prej haditheve kuptohet se që nga ardhja e Muhammedit alejhis-selam e deri në fund të botës, ka mbetur shumë pak, në krahasim me kohën që ka kaluar para tij. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Abdull-llah Ibn Umeri, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Njëmend, jeta juaj (deri në fund të botës), në krahasim me popujt që kanë kaluar, është sa koha mes namazit të ikindisë dhe perëndimit të diellit.” Në një hadith tjetër ai thotë: “U dërguam unë dhe Kijameti sikurse këta dy (bëri shenjë me dy gishtat e parë).”

Pra, ka kaluar nga jeta e kësaj bote, aq sa ka kaluar mes sabahit dhe ikindisë, e ka mbetur deri të realizimi i Kijametit aq sa ka mbetur mes ikindisë dhe akshamit.

ASKUSH POS ALL-LLAHUT NUK DI KOHËN E NDODHJES SË TIJ

Kur Xhibrili alejhis-selam e pyeti Muhammedin alejhis-selam, në praninë e shokëve të tij, e i tha: “Më trego kur është Kijameti?”, ai iu përgjigj: “I pyeturi nuk di më tepër për këtë se pyetësi”. Pra, Xhibrili, engjëlli më i lartë dhe Muhammedi alejhis-selam, i Dërguari më i lartë, nuk dijnë për kohën e ndodhjes së tij. Kur’ani disa herë ceku se ajo ditë vjen papritmas dhe kur do të realizohet e di vetëm All-llahu:

“Të pyesin ty (Muhammed) për Kijametin se kur do të ndodhë ai. Thuaj: “Atë e di vetëm Zoti im, kohën e tij nuk e zbulon askush përveç Tij (e sjell Kijametin pa e hetuar asnjë nga krijesat). Ai (Kijameti) është shumë i rëndë për qiejt e për tokën! Ai nuk vjen ndryshe, vetëm befas. Ata të

pyesin ty sikur ti di për të (kohën e tij)”. Thuaj: “Njëmend, dituria e tij është tek All-llahu, por shumica e njerëzve nuk dinë.” (El-A’raf: 187)

Pra, Kijameti është një fshehtësi absolute e All-llahut që askush kohën e realizimit të tij nuk e di. Prandaj, nuk duhet të na mashtrojnë fjalët e disa fallxhorëve, të cilët kënse lajmërojnë kohën e tij. Ai që u beson atyre e ka refuzuar Kur’anin. Sikur njerëzit ta dinin kohën e Kijametit, atëherë nuk do të ekzistonte liria e zgjedhjes së rrugës, zgjedhja e rrugës së Xhennetit apo të Xhehennemit.

SHENJAT E KIJAMETIT QË KANË NDODHUR

Shenjat e Kijametit që ndodhën një herë dhe nuk do të përsëriten më janë të shumta. Ne do të cekim vetëm disa nga ato.

DËRGIMI I MUHAMMEDIT ALEJHIS-SELAM DHE ÇARJA E HËNËS

Më parë përmendëm se Muhammedi alejhis-selam tha:

“U dërgova unë dhe Kijameti sikurse këta dy (bëri shenjë me dy gishtërinjtë e parë).” Prandaj edhe quhet Muhammedi alejhis-selam nebijjus-saati, që d.m.th. i Dërguar i Kijametit, sepse ai

është i Dërguari i fundit, vula e pejgamberëve dhe shpallja e tij është e vlefshme deri në Ditën e Kijametit.

Me këtë emër Muhammedi alejhis-selam ishte i paralajmëruar në librat e shpallur më parë, dhe sot e kësaj dite në Bibël kanë mbetur tekste që e vertetojnë këtë.

Kurse çarja e Hënës, është mrekullia e cekur në suren El-Kamer: “U afrua momenti (Kijameti), dhe Hëna u ça.” (El-Kamer: 1)

Këtë ngjarje e transmetuan disa shokë të Muhammedit alejhis-selam. Ibn Kethiri në tefsirin e tij përmendi hadithet e transmetuara rreth kësaj mrekullie, dhe të gjitha ato janë të vërteta. Transmetoi Muslimi nga Enesi se politeistët e Mekkes kërkuan nga Muhammedi alejhis-selam t’u paraqesë një mrekulli, e ai ua paraqiti çarjen e Hënës.

Gjithashtu, transmeton Abdull-llah Ibn Mes’udi, i cili thotë: “U ça Hëna në kohën e Muhammedit alejhis-selam në dy pjesë, e Muhammedi alejhis-selam tha: “Dëshmoni, dëshmoni.”

Pra, All-llahu i Lartësuar këtë ndodhi e quajti afrim i Kijametit.

ZJARRI I HIXHAZIT QË SHNDRITI BASRËN NË IRAK

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të bëhet Kijameti para se të shkaktohet një zjarr në tokën e Hixhazit, e i cili do t’i shndritë qafët e deveve në Basra (të Irakut).”

Kjo është një shenjë e madhe, që i dashuri ynë, Muhammedi alejhis-salam e paralajmëroi, dhe ajo ndodhi ashtu siç e paralajmëroi Besniku dhe i Sinqerti, në vitin 654h.

Ibn Kethiri në librin e tij të historisë “Fillimi dhe mbarimi” flet për këtë zjarr në ngjarjet e vitit 654h. Po ashtu dijetari El-Hafidh Shihabud-Din Ebu Shamel-Makdesi, për këtë zjarr thotë: “Në fillim të muajit Shaban të vitit 654h. erdhën në Damask letra nga qyteti i të Dërguarit, të cilat sqaronin një çështje të madhe e cila vërtetoi fjalën e Muhammedit alejhis-salam të transmetuar nga Ebu Hurejre (për çështjen e atij zjarri), e më tha ai që i besoj unë dhe që e pa atë (zjarrin) se ka shkruar letra nën dritën e tij duke qenë ai në Tejmae, dhe atë ditë ishim nëpër shtëpitë tona dhe pothuajse çdo shtëpi kishte nga një llambë, e ai zjarr nuk kishte nxehtësi e as djegie përkundër madhësisë së tij. Ai ishte një shenjë nga shenjat e Zotit..”

Një numër i madh i dijetarëve muslimanë, që jetuan në atë kohë, e përshkruan këtë ngjarje të madhe nëpër librat e tyre e në mesin e tyre edhe dijetari i famshëm, imam En-Neveviu, i cili thotë: “Në kohën tonë, doli një zjarr nga Medina në vitin 654, ai ishte një zjarr shumë i madh nga ana lindore e Medines...”

Nga përshkrimet e këtyre dijetarëve kuptohet se ai zjarr ishte një vullkan shumë i madh, të cilin e shoqëruan dridhje të mëdha.

Kush është ai që e lajmëroi Muhammedin alejhis-salam për paraqitjen e këtij zjarri 654 vjet pas emigrimit të tij në Medinë?!

NDËRPRERJA E XHIZJES DHE HARAÇIT

Xhizja dhe Haraçi janë tatime që jomuslimanët i paguajnë kur gjenden nën Pushtetin Islam, e nuk e pranojnë Islamin. Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se ato do të ndërpriten dhe kështu Shteti Islam do të humbë një burim të rëndësishëm financiar.

Transmeton Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Hurejre, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “E ndaloi Iraku dirhemën dhe kufejzin e tij, e ndaloi Shami muddin dhe dinarin e tij dhe e ndaloi Egjipti irdibin dhe dinarin e tij, e u rikthyet prej nga filluat dhe u rikthyet prej nga filluat.”, e dëshmoi këtë mishi dhe gjaku i Ebu Hurejres.

Kufejzi, muddi dhe irdibi ishin njësi matëse të asaj kohe në ato vende, e disa nga ato ende vazhdojnë të jenë të tilla.

Ky paralajmërim i Muhammedit alejhis-selam përmban në vete dy paralajmërime. I pari: se ato vende të përmendura do të hyjnë nën Pushtetin islam dhe do ta paguajnë xhizjen, kurse i dyti: se ato vende pas një kohe do ta ndërprejnë pagimin e xhizjes. Të gjitha ato vende të përmendura në hadith, ndërprejnë pagimin e xhizjes si shkak i pushtimit të tyre nga pabesimtarët në kohë të ndryshme. Ato i sulmuan romakët pastaj tatarët (mongolët), e në kohën tonë i pushtuan pabesimtarët dhe e abroguan halifatin islam.

Thotë imam En-Neveviu, duke e komentuar këtë hadith: Kuptimi më i njohur i këtij hadithi, është se: të huajt (axhemet) dhe romakët do t'i pushtojnë vendet islame në fund të kohës.

SHENJAT E KIJAMETIT QË KANË NDODHUR NJË HERË DHE MUND TË PËRSËRITEN PRAPË ÇLIRIMET DHE LUFTËRAT

Nga paralajmërimet e para të Muhammedit alejhis-selam, përmendëm se ai u premtoi shokëve të tij dhe ua përcaktoi vendet që ata do t'i çlirojnë, dhe i paralajmëroi se çfarë do të ndodhë me ummetin islam deri në fund të kohës.

Transmeton Buhariu nga Habab Ibnul-Eret, se ky tha: “Tu ankuam të Dërguarit të All-llahut, Muhammedit alejhis-selam, derisa ai kishte shtruar një xhybe të tij nën hijen e Qabesë e i thamë atij: A nuk kërkon ndihmë për ne, a nuk lutesh për ne? Tha: “Ishte një njeri (besimtar) para jush që e kishin futur në një gropë në tokë, pastaj i është prerë koka me sharrë në dy pjesë (nga pabesimtarët), e kjo gjë nuk e ndalonte atë nga besimi i tij. Pastaj i gërryhej koka me krehër të hekurt në mishin dhe muskujt e tij, e kjo nuk e ndalonte nga feja e tij. Betohem në All-llahun se Ai do ta plotësojë këtë çështje (fe) saqë udhëtari do të ecë që nga Sana (Jemeni) e deri në Hadramevt e nuk do të frikohet përveç All-llahut apo ujkut për shkak të deleve të tij, por ju nxitoni.”

Pra, Muhammedi alejhis-selam ua premtonte shokëve të tij të gjitha ato çlirime, derisa ata ishin pakicë, të frikësuar dhe të ndjekur nga politeistët. Ai ua premtoi atyre çlirimin e Gadishullit Arabik, të Jemenit, Shamit, Persisë, Egjiptit dhe të shumë vendeve të tjera.

Transmeton Muslimi nga Thevbani, se ky tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “All-llahu ma tuboi mua Tokën dhe pashë Lindjen e Perëndimin e saj, e ummeti im do të arrijë mbretërinë e asaj që më është paraqitur mua, dhe m'u dhanë dy thesarë: i kuqi dhe i bardhi.”

Kështu edhe ndodhi, sepse çlirimet e muslimanëve arritën në Lindje deri në Kinë e në Perëndim deri në Marok e Spanjë. është interesant që hadithi ceku Lindjen dhe Perëndimin e Tokës, e jo Veriun e Jugun, dhe njëmend Pushteti islam ishte zgjeruar shumë më tepër në Lindje e Perëndim, derisa në Veri e Jug u zgjerua shumë më pak. Disa nga ato çlirime dhe luftëra do t'i cekim, in sha All-llah, në vazhdim.

PARAQITJA E GËNJESHTARËVE DHE E PROFETËVE TË RREJSHËM

Transmeton Muslimi nga Thevbani, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Do të ketë në ummetin tim tridhjetë gënjeshtarë (dexhallë). Secili nga ata do të pretendojë se është i dërguar, ndërsa unë jam Vula e të dërguarve, dhe nuk do të ketë të dërguar pas meje.”

Ky hadith ka për qëllim profetët gënjeshtarë të cilët shkaktojnë trazira të mëdha dhe shumë njerëz i ndjekin ata. Ata që kanë pretenduar se janë profetë, por që njerëzit nuk ua varën veshin, janë të shumtë.

Nga ata profetë gënjeshtarë përmenden: Musejlemetul-Kedhabi, El-Esved El-Anesi, Sexhah El-Kahine, Muhtar Eth-Thekafijju (këta u paraqitën qysh në kohën e sahabëve dhe të tabiineve),

kurse para një shekulli e shpalli veten profet Husejn Ibn Ali Ibn El-Mirza Abbas në Iran, i njohur me emrin BEHAULL-LLAH kurse pasuesit e tij njihen me emrin Behai apo Bahajët, të cilët i financojnë armiqtë më të mëdhenj të Islamit. I fundit nga këta profetë të rrejshëm do të jetë Dexhalli i mallkuar.

FRIKËSIMI NGA TRAZIRAT E SHPESHTA

Transmeton Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Shpejtoni me veprat tuaja (të mira), sepse do të ndodhin trazira sikurse pjesët e netëve të errëta, gdhinë njeriu besimtar e ngryset pabesimtar, dhe ngryse besimtar e gdhinë pabesimtar, e shet ndonjëri nga ju fenë e tij për një plaçkë të kësaj bote.”

Po ashtu, Ebu Hurejre transmeton se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të ndodhë Kijametit derisa njeriu të kalojë pranë varrit të ndonjë njeriu tjetër e të thotë: Ah, sikur të isha në vend të tij.” Në një hadith tjetër thotë Muhammedi alejhis-selam: “Para dyerve të Kijametit do të ndodhë El-Herexhu”, thanë: E ç’është El-Herexhu? Tha: “Vrasja, nuk them se ju do t’i vritni politeistët, por do të vritni njëri-tjetrin”. Thanë (shokët e tij); Dhe atë ditë ne i kemi mendtë me vete? Tha: “Do të mirren mendtë e njerëzve të asaj kohe dhe do të jenë ata sikurse pluhuri. Shumica e tyre mendojnë se janë në diç, por, ata nuk janë në asgjë.”

Në një hadith tjetër, që po ashtu e transmeton Ebu Hurejre, thotë Muhammedi alejhis-selam: “Betohem në Atë që shpirti im është në dorën e Tij, do t’u vijë një kohë njerëzve, kur luftëtari nuk do të dijë pse lufton dhe i vrari nuk do të dijë pse është vrarë.”

Shkaqet më të mëdha të rënies në ato sprovime dhe në ato fatkeqësi janë mosdituria, injoranca e madhe, mosinteresimi për Islamin, veprimi i mëkateve të shumta, moskryerja e farzeve (obligimeve) ndaj All-llahut dhe veprimi i harameve...

Transmeton Enesi, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Prej shenjave të Kijametit janë: ngritja e diturisë (së pastër fetare), shtimi i injorancës, i kurvërisë, konsumimi i tepërt i alkoolit, pakësimi i meshkujve, shtimi i grave saqë pesëdhjetë gra do të jenë për një mashkull.”

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjera, të ngjashme me këtë. Në vazhdim do të prezentojmë disa nga ato fitnete-trazira.

1) VRASJA E HALIFIT TË FAMSHËM, UTHMANIT, RADIALLLAHU ANHU, DHE PËRÇARJA E UMMETIT:

Transmeton Hudhejferu Ibnul-Jemani se ai ishte ulur pranë Umerit, radiall-llahu anhu, kur ky tha: “Kush nga ju ka mbajtur mend fjalët e Muhammedit alejhis-selam për trazirën (fitnetin)? Tha Hudhejfe: Sprovimin e njeriut në familjen, pasurinë dhe fëmijët e tij e mbulon namazi dhe sadaka,

si dhe urdhërimi në të mirë dhe pengimi nga e keqja. Tha Umeri: Nuk të pyes për këtë, por për atë që valon si valët e detit. Atëherë tha (Hudhejfeu): Mos ki frikë ti nga ajo, o udhëheqësi i muslimanëve, sepse mes teje dhe mes asaj është një derë e mbyllur. Tha Umeri: A thyhet apo hapet? Tha (Hudhejfe): Thyhet. Umeri iu përgjigj: Atëherë, nuk mbyllet më kurrë. Tha (Hudhejfe): Ashtu është. E pyetëm Hudhejfen (më vonë): A e dinte Umeri se cila ishte ajo derë? Tha: Po, ashtu siç e dinte se nesër do të vijë nata, sepse unë i kisha thënë një fjalë që nuk ishte e kotë. Ne dëshiroam ta pyesim për atë derë (Hudhejfen), e urdhëruam Mesrukukin ta pyesë, e ai i tha: Kush ishte ajo derë? Tha: Umeri.”

Pra, kjo ishte koha pas Umerit, koha e Uthmanit, radiall-llahu anhumama, të cilin e vranë derisa ishte duke lexuar Kur'anin, dhe njëmend, prej asaj kohe e deri në ditët tona vazhdojnë trazirat në ummetin islam njëra pas tjetrës.

Në hahithin e transmetuar nga Abdull-llah Ibn Mes'udi, thotë Muhammedi alejhis-selam: “Do të silltet mokra (guri i mullirit) e Islamit pas tridhjetë e pesë vjetëve, e nëse ata shkatërrohen, kanë marrë rrugën e atyre që janë shkatërruar, e nëse u vazhdon atyre feja u vazhdon vetëm 70 vjet (pa trazira të mëdha)”. Tha Umeri: Nga ajo që kaloi apo nga ajo që ka mbetur? Tha: “Nga ajo që kaloi.”

Muhammedi alejhis-selam i quajti ato trazira “mokra e mullirit”, duke marrë si shembull atë për vrasjet që do të ndodhnin asokohe. Kurse 70 vjetët ndoshta simbolizojnë kohën e Halifatit Emevit, sepse ai zgjati vetëm 70 vjet.

2) TË GJITHA TRAZIRAT DHE LUFTËRAT QË NDODHËN MES MUSLIMANËVE QË NGA VRASJA E UTHMANIT E DERI NË DITË TONA TË SOTME

Ato janë: Lufta e Siffinit, lufta rreth deves, paraqitja e sekteve të ndryshme në Islam: si havarixhët, shiitët, grupet devijuese të sufizmit, përleshjet ndërmjet disa vendeve muslimane, kryqëzatat etj.

CILA ËSHTË RRUGA E SHPËTIMIT NGA KËTO TRAZIRA?

Shumë nga shokët e Muhammedit alejhis-selam u munduan t'i mësojnë ato trazira dhe ato sprovime që do t'i ndodhnin ummetit islam pas Muhammedit alejhis-selam, si dhe mënyrën e shpëtimit dhe daljes nga ato trazira. Në mesin e tyre më i dalluari ishte Hudhejfetu Ibnul-Jemani, të cilin Muhammedi alejhis-selam e veçoi me disa fshehtësi të tij, prandaj edhe e quanin atë “shoku i fshehtësisë së Muhammedit alejhis-selam”. Transmetohet se ai tha: “Njëmend, unë jam njohësi më i mirë i njerëzve për çdo trazirë që do të ndodhë në mes meje dhe Kijametit.”

Ky sahabij i madh, e pyeste Muhammedin alejhis-selam shumë për ato trazira nga frika që të mos bie në to dhe ta dijë mënyrën e shpëtimit.

Transmeton Buhariu nga Hudhejfitu, se ky tha: E pyetnin njerëzit të Dërguarin e All-llahut për hajrin (të mirën), kurse e pyetja unë për sherrin (të keqen që do të ndodhë) nga frika se do të më zë ai. I thashë (me një rast të Dërguarit): O i Dërguar i All-llahut, ne ishim më parë në injorancë dhe sherr, e All-llahu na afroi këtë hajr (Islamin), a do të ketë pas këtij hajri sherr më? Tha: “Po.” I thashë: E pas atij sherrit a do të ketë hajr? Tha: “Po, dhe ai është i përzier me tym.” I thashë: E ç’është tymi i tij? Tha: “Njerëzit (populli) që nuk udhëzojnë sipas udhëzimit tûm, e dallon ti atë dhe e urren.” I thashë: E pas atij hajri a do të ketë sherr? Tha: “Po, thirrës në dyer të xhehennemit. Ai që u përgjigjet do ta hedhin në te.” I thashë: O i Dërguar i All-llahut, na i përshkruaj neve ata. Tha: “Ata janë nga lëkura jonë dhe flasin gjuhën tonë.” I thashë: Atëherë, ç’ka më urdhëron nëse e gjithë kjo më mbërrinë mua? Tha: “PËRMBAJU XHEMATIT TË MUSLIMANËVE DHE IMAMIT (emirit, udhëheqësit) TË TYRE.” I thashë: E nëse ata nuk kanë as xhemat e as imam? Tha: “LARGOHU NGA TË GJITHA ATO GRUPE, edhe nëse kapesh për rrënjën e një peme derisa të të arrijë vdekja, e ti je në atë gjendje.”

Ky hadith i urtë i Muhammedit alejhis-selam ka nevojë të sqarohet. Hadithi është udhëzim se si duhet të veprojnë muslimani në rastin e atyre trazirave, por hadithi në të njëjtën kohë është edhe paralajmërim që u realizua dhe po realizohet në ditët tona. Njerëzit që s’udhëzojnë me udhëzimin e Muhammedit alejhis-selam, janë ata që e quajnë veten muslimanë, e ndoshta kanë marrë mbi vete komunikimin e Islamit, por ata, në të vërtetë, nuk e kanë kuptuar atë dhe janë më të largët nga ai. Disa nga ata e kanë kuptuar atë, por veprat e tyre i përgënjeshtrojnë fjalët e tyre.

Kurse thirrës në dyert e xhehennemit, janë të gjitha ata që ftojnë në fe, ligj, rregullim, jetë tjetër përveç Islamit.

Tha të vërtetën Muhammedi alejhis-salam kur tha se ata janë nga lëkura jonë, përkatësisht, janë të ummetit islam dhe flasin gjuhën tonë. Sa të shumtë janë ata nga lëkura jonë që ftojnë në rrugë të tjera përveç rrugës islame. Njëri nga ata fton në socializëm e komunizëm, tjetri në kapitalizëm, tjetri në lirinë e pakufishme etj., por, të paktë janë ata që ftojnë në Rrugën dhe Sistemin e Krijuesit të njeriut.

Fundi i hadithit është shumë me rëndësi, sepse aty i dashuri i All-llahut na tregon se çfarë qëndrimi ne muslimanët duhet të mbajmë në të gjitha ato trazira. Pra, duhet t'i përmbahemi XHEMATIT (grupit, partisë, shoqërisë etj.) Të MUSLIMANËVE DHE IMAMIT TË TYRE. Domethënë, ne jemi të obliguar që të njohim se cila shoqëri apo cila parti i përmbahet më së miri rrugës së Kur'anit dhe të Muhammedit alejhis-salam në çdo vend dhe në çdo kohë, dhe t'i bashkangjitemi atij grupi e të mundohemi t'i japim të gjitha fuqitë tona për lartësimin e asaj rruge.

Në një hadith që e transmeton Ebu Davudi nga Ebu Hurejre, thuhet se Muhammedi alejhis-salam tha: “ALL-LLAHU I DËRGON KËTIJ UMMETI NË KRYE TË ÇDO NJËQIND VITEVE DIKË QË IA PËRMIRËSON ATIJ GJENDJEN FETARE.”

Pra, në çdo shekull do të vijë nga një reformues i cili do t'i kthejë muslimanët në rrugën burimore dhe të vërtetë islame. Dijetarët thanë se ai reformator mund të jetë një person, një grup apo edhe shumë persona. Në shekullin e parë të Islamit konsiderohet të jetë Umer Ibn Abdul-Azizi, më vonë Ibn Tejmije, kurse në shekullin tonë konsiderohet se ky person është imami Hasan El-Benna, themeluesi i Lëvizjes Islame “Vëllezërit Muslimanë”.

Muhammedi alejhis-salam urdhëroi që të kapemi për Islam, t'i nënshtrohemi imamit (të drejtë), t'i përmbahemi Sunnetit (rrugës) të tij dhe rrugës së halifeve të udhëzuar pas tij.

Transmetoi Irbad Ibn Sarije, i cili thotë: “Na mbajti i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam, një fjalim tronditës, lotonin sytë dhe u rrëqethën zemrat, atëherë ne i thamë: O i Dërguar i All-llahut, ky është fjalimi i një lamtumirësi, e ç’farë na këshillon neve? Tha: “Ju kam lënë mbi një tokë të bardhë, nata e saj është si dita e saj, nuk do të largohet nga ajo pas meje veç një që është i shkatërruar, dhe ai që jeton pas meje do të përjetojë konflikte të shumta, e ju përmbajuni Sunnetit tim dhe Sunnetit (rrugës) të halifëve udhëzues e të udhëzuar, kapuni për ata me nofullat tuaja, dhe përmbajuni nënshtrimit (ndaj udhëheqësit të drejtë), qoftë ai edhe rob etiopian (por që është i drejtë)..”

MARRJA E POZITAVE TË NDRYSHME NGA ATA QË NUK JANË TË ZOTËT

Kur pozitat dhe punët e ndryshme i marrin përsipër ata që i meritojnë, edhe njerëzimi jeton në lumturi, por ç’ndodh kur ato i marrin përsipër ata që nuk i meritojnë. Kjo është ajo që paralajmëroi Muhammedi alejhis-selam, se është njëra nga shenjat e Kijametit.

Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre, i cili tha: Derisa Muhammedi alejhis-selam ishte në një mexhlis duke iu folur njerëzve, iu afrua një beduin e i tha: Kur do të ndodhë Kijameti?! i Dërguari i All-llahut vazhdoi me fjalimin e tij. Disa nga ata që ishin të pranishëm thanë: E dëgjoi çka tha, dhe e urren thënien (pyetjen) e tij, kurse disa të tjerë thanë: Jo, por nuk e dëgjoi, derisa ai (Muhammedi alejhis-selam) përfundoi fjalimin e tij, e pastaj tha: “Ku është pyetësi për

Kijametin?” Tha ai: Ja ku jam o i Dërguar i All-llahut. I tha: “Kur të humbet amaneti (besnikëria), prite Kijametin.” Tha ai: Si humbet ai? Tha: “Kur t’u besohen çështjet (punët) atyre që nuk janë të zotë për to, prite Kijametin.”

Ai që përcjell historinë e ummetit islam, do ta vërejë këtë sëmundje që e paralajmëroi Muhammedi alejhis-selam. Shumë herë i morën përsipër çështjet më kryesore të muslimanëve ata që asnjëherë nuk ishin të zotët e tyre, ata që nuk mund të dëgjonin mendimin e tjetrit.

Transmetohet nga Muavija se Muhammedi alejhis-selam tha: “Do të vijnë udhëheqës pas meje që do të flasin (diç) e nuk u kthehet fjala atyre (nga frika), do të grumbullohen në zjarr (xhehennem) siç tubohen majmunët.” etj.

Sot, në ditët tona, shohim se çështjet e muslimanëve i kanë marrë përsipër ata që janë më të degjeneruarit në mesin e tyre, përveç atyre që All-llahu i mbron. Hedhe një shikim në botën islame dhe atë joislame, do të vëresh se çfarë mizorë, njerëz të padrejtë dhe injorantë i udhëheqin vendet e tyre.

PRISHJA, SHKATËRRIMI DHE FESADI I MUSLIMANËVE

All-llahu i Lartësuar zgjodhi ummetin islam në mesin e të gjitha ummeteve që ta bartin fenë e Tij, sikurse kishte zgjedhur më parë Beni Israilët. Ummeti islam një kohë të gjatë edhe e barti këtë

amanet, ndonjëherë më shumë e ndonjëherë më pak, por Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se edhe ky ummet do ta hedhë, në disa periudha, fenë prapa shpine.

Transmetoi Muslimi nga Hudhejfe, se ky tha: Na tha Muhammedi alejhis-selam dy gjëra. Njëren nga ato unë e pashë dhe jam duke e pritur tjetrën. Na tha se amaneti zbriti në rrënjët e zemrave të burrave, tha ai: “Bën njeriu një fjetje, e i merret amaneti nga zemra e tij dhe i mbeten gjurmët e tij (amanetit në zemër) sikurse ngjyra (jooriginale), pastaj bën një fjetje tjetër, e i merret amaneti nga zemra e tij dhe i mbeten gjurmët e tij sikurse fluskat (e zjarrit) që kanë mbetur mbi këmbën tënde dhe e përvëlojnë atë, e ti i sheh të fryra, kurse në to nuk ka asgjë. Atëherë gdhijnë njerëzit duke i dhënë betimin njëri-tjetrit, e pothuajse asnjë prej tyre nuk e kryen amanetin derisa të thuhet: Tek bijtë e filanit ka një njeri besnik, madje i thuhet njeriut: sa i mençur është ai, sa i thukët është, sa i famshëm është, kurse në zemrën e tij nuk ka iman as sa kokrra e melit.”

Do të vijmë më vonë shumë hadithe të tjera që paralajmërojnë degjenerimin e njerëzve në përgjithësi, duke përfshirë edhe muslimanët.

ROBËRESHA LIND ZONJËN E SAJ DHE NGRITJA E TË ZBATHURVE, TË ZHVESHURVE DHE E BARINJVE TË DELEVE NË PALLATE

Transmeton Muslimi nga Umer Ibnul-Hatabi, në hadithin e gjatë ku Xhibrili alejhis-selam erdhi te Muhammedi alejhis-selam, në formë të një njeriu, derisa ai ishte me shokët e tij dhe në fund e pyeti: “...Më lajmëro për Kijametitn (kur është ai)?” Tha (Muhammedi alejhis-selam): “I pyeturi

për të nuk di më shumë se pyetësi.” Atëherë Xhibrili i tha: “Më lajmëro, pra, cilat janë shenjat e tij?” Tha: “Kur lind robëresha zonjën e saj, dhe i sheh të zbathurit, të zhveshurit dhe barinj të e deleve duke u ngritur në pallate”.

Kuptimi i hadithit: “robëreshat që lindin zonjat e tyre”, disa dijetarë thonë se ka për qëllim çlirimet e muslimanëve dhe marrjen e robëreshave të cilat pastaj do të lindin fëmijë në mesin e muslimanëve; sepse ato janë të lejuara për ta, ndërsa fëmijët e tyre marrin pozitën e zotëriut të saj, sepse ai trashëgon babain në pasurinë e tij, të cilën të drejtë nuk e gëzon robëresha.

Kurse “të zbathurit, të zhveshurit dhe barinj të e deleve”, në një hadith tjetër është pyetur Muhammedi alejhis-selam se kush janë ata? E ai tha: “Ata janë beduinët (fshatarët)”.

Kurse “ngritja në pallate” paralajmëron se njerëzit do t’i ngrisin shtëpitë e tyre, siç është rasti sot me ndërtimin e pallateve e ndërtesave të larta.

Dhe njëmend, sot të gjithë ata që ishin barinj të deleve janë shpërngulur në qytete dhe ndërtojnë pallate çfarë nuk ka parë njerëzimi ndonjëherë.

BASHKIMI I POPUJVE KUNDËR MUSLIMANËVE

Këtë paralajmërim e cekëm edhe më parë tek paralajmërimet e Muhammedit alejhis-selam (shiko atje).

SHTIMI I PASURISË, PËRHAPJA E MUZIKËS, E VEGLAVE MUZIKORE DHE KONSUMIMI I ALKOOLIT

I tha Muhammedi alejhis-selam Avf Ibn Malikut, derisa ata ishin në Betejën e Hajberit: “Numëro gjashtë gjëra para dyerve të Kijametit..”, në mesin e tyre “Shtimi i pasurisë”.

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të bëhet Kijameti para se të shtohet pasuria juaj, do të përhapet aq shumë ajo, saqë do të mendojë i zoti i pasurisë se kush do ta pranojë sadakanë e tij, e thërritet njeriu tek ai, e ky i thotë: Nuk kam nevojë për të.”

Kjo, siç duket, ndodh në kohë të ndryshme. Në kohën e halifit Umer Ibn Abdul-Azizit nuk gjendej askush që t'i jepej sadaka. Gjithashtu hadithet që flasin për paraqitjen e Mehdiut përmendin edhe shtimin e pasurisë.

Kurse hadithet që përmendin përhapjen e muzikës, të veglave muzikore dhe konsumimin e alkoolit janë të shumta. Ne do ta përmendim hadithin e transmetuar nga Sa'di, i cili thotë: “Tha Muhammedi alejhis-selam: “Në kohën e fundit do të ndodhin shafitje (të Tokës), hedhje (nga qielli) dhe deformime (ndryshime të pamjes njerëzore), kur të paraqiten muzika dhe veglat muzikore e të lejohet alkooli.” Në një hadith tjetër: “.. dhe të pihet alkooli.”

S'kaloi asnjë kohë në të cilën ishin të përhapura veglat muzikore dhe muzika e të jetë konsumuar alkooli sikurse në ditët tona. All-llahu na ruajtë nga çdo e keqe.

DHËNIA SELAM VETËM ATYRE QË I NJOHIM, PËRHAPJA E TREGTISË DHE NDËRPRERJA E MARRËDHËNIEVE ME TË AFËRMIT

Transmeton imam Ahmedi nga Abdull-llah Ibn Mes'udi, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Para dyerve të Kijametit do të paraqitet: selami vetëm për të veçantët, përhapja e tregtisë saqë gruaja i ndihmon burrit të saj në tregti, ndërprerja e lidhjeve farefisnore, dëshmimi i rrejshëm, fshehja e dëshmisë së vërtetë dhe përhapja e lapsit.”

Selami për të veçantët: ka për qëllim se nuk i thuhet “selamu-alejkum” askujt, përveç të njohurit, derisa shokët e Muhammedit alejhis-selam përshëndetnin atë që e njihnin dhe atë që nuk e njihnin. Tregtia sot në botë është baza elementare e jetës dhe ajo për çdo ditë e më shumë vjen e zhvillohet, e me të merren burra e gra, ashtu siç tha Muhammedi alejhis-selam, të gjithë janë dhënë pas pasurisë, ndërsa pasuria e tregtia janë bërë zot i njerëzve.

Me fjalën “përhapja e lapsit” ka për qëllim botimin e shkrimeve dhe librave të shumtë që do të bëhet, derisa në të kaluarën kjo veprimtari ishte e paktë.

ZHVLERËSIMI I VLERAVE DHE KRITEREVE

Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se kriteret vlerësuese të njerëzimit para Kijametit do të zhvlerësohen, do të besohet rrena e do të përgënjeshtrohet e vërteta, do t'i besohet tradhtarit e

nuk do t'i besohet besnikut, njerëzit e thjeshtë do të flasin për çështjet e mëdha të njerëzimit dhe nuk do të thonë përveçse mendime të devijuara..

Transmeton imami Ahmed nga Ebu Hurejre, se ky tha: Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “Do t’u vijnë njerëzve vite mashtruese, besohet se atëherë gënjeshtari do ta përgënjeshtrojë të sinqertin, do t’i besohet tradhtarit e nuk do t’i besohet besnikut dhe do të flasë, asokohe, err-rruvejbidë.” I është thënë: E ç’është err-rruvejbidë? Tha: “Njeriu mendjehetë i cili flet për çështjet e shumicës.”

Ai që vështron gjendjen aktuale të botës, do të vërejë se ne jetojmë në kohën që e paralajmëroi Muhammedi alejhis-selam, sepse pabesimtarët gënjeshtarë zotërojnë përfaqësitë më të mëdha radio-televizive dhe mjetet tjera të informacionit, kurse të sinqertët dhe të drejtët përgënjeshtrohen, ndërsa shumë vende islame ua dorëzojnë pasurinë e tyre tradhtarëve pabesimtarë dhe për çështjet e mëdha njerëzore flasin njerëzit me të dobët dhe më injorantë, prandaj edhe bota ka arritur në këtë shkallë të shkatërrimit, rrezikut dhe luftërave.

POLICIA E KOHËS SË FUNDIT E CILA RRAH DHE KEQTRAJTON QYTETARËT

Mizoria do të arrijë kulmin e saj në kohën e fundit, derisa edhe ata që janë përcaktuar për ndaljen e mizorëve, vetë do të bëhen mizorët më të mëdhenj, të cilën gjë e shohim sot me sytë tanë.

Transmeton imami Ahmed nga Ebi Umame, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Do të ketë në kohën e fundit njerëz që me vete mbajnë kamxhikë (kërbaçë) të ngjashëm me bishtin e lopës, dalin ata në hidhërimin e All-llahut (ndaj tyre).”

PARAQITJA E TELEVISIONIT DHE AFRIMI I KOHËS

Disa ajete të Kur’anit dhe shumë hadithe të Muhammedit alejhis-selam, paralajmëruan se njerëzimi para kohës së fundit do të përparojë shumë në aspektin material dhe zhvillimin shkencor.

Transmetohet në një hadith se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të vijë Dita e Kijametit para se të hyjë në çdo shtëpi një trazirë (fitne).”

Shumë dijetarë e identifikuan këtë hadith me televizionin, sepse është, pothuajse, e vetmja gjë që ka hyrë në çdo shtëpi dhe rreziku i tij kundër çdo vlere njerëzore është i qartë, edhe pse nga ai ka dobi por shërr i tij është shumë më i madh se sa hajri. Kjo fyerje nuk ka të bëjë më vetë televizionin, sepse ai është vetëm një send i ngurtë, por fyerja ka të bëjë me programet që emetohen në te.

Afrimi i kohës: Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të ndodhë Kijameti para se të afrohet koha, një vit në të do të jetë sa një muaj, një muaj sa një javë, një javë sa një orë dhe një orë sa një ndezje e zjarrit...”

Afrimi i kohës, sipas komentimit të shumë dijetarëve, ka për qëllim kalimin e një largësie të madhe për një kohë të shkurtë, siç ndodh në kohën tonë me shpikjen e automjeteve, aeroplanëve etj., prandaj në këtë mënyrë edhe e përshkroi atë Muhammedi alejhis-selam, se një vit do të bëhet sa një muaj, përkatësisht se atë largësi që njerëzit e kalonin më parë për një vit, sot e kalojnë për një muaj, e kështu me radhë.

Këto ishin disa nga paralajmërimet që u realizuan dhe mund të realizohen apo ndodhin kohë pas kohe. Ekzistojnë edhe shumë paralajmërimet të Muhammedit alejhis-selam që u realizuan dhe janë duke u realizuar në kohën tonë, siç janë p.sh.: degjenerimi i femrave dhe shtimi i tyre, veshja e mendafshit, e arit dhe e argjendit, përhapja e kurvërisë, këndimi i Kur'anit për para dhe mospraktikimi i tij, zbukurimi i xhamive etj, etj.. të cilat do t'i përmbledhim, in sha All-llah, në një përmbledhje të përgjithshme në fund të këtij libri.

SHENJAT E KIJAMETIT QË ENDE NUK KANË NDODHUR SHAFITJET (E TOKËS), DEFORMIMI (SHNDËRRIMI NË QENIE TË TJERA) DHE HEDHJA (NGA QIELLI) QË DO TË NDODHIN NË KËTË UMMET

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Beto hem në Atë që më dërgoi mua me të vërtetën, nuk do të marrë fund kjo botë para se t’ju ndodhin atyre (njerëzimit) shafitje

(të tokës), deformime (transformim të njeriut nga një qenie në qenie tjetër) dhe hedhje (gjuajtje nga qielli).” I është thënë: Kur do të ndodhë kjo? Tha: “Kur t’i shohish gratë që u kanë hipur shalëve, kur të shtohet muzika, kur të dëshmohet rrejtshëm, kur të pijnë muslimanët në enët e banorëve të Lindjes, të arit dhe të argjendit, dhe kur të mjaftojnë burrat me burra dhe gratë me gra..”

Në disa hadithe të Muhammedit alejhis-salam thuhet se ata do të shndërrohen në derra dhe majmunë. Kurse për shafitjet e tokës në një hadith tjetër Muhammedi alejhis-salam tha:

“O ju (që jeni të pranishëm), kur të dëgjoni për një ushtri që është shafitur afër (qytetit të Medines), atëherë veçmë u afrua Kijameti.”

Fjalën e Muhammedit alejhis-salam “Kur t’i shohish gratë se u kanë hipur shalëve”, disa komentues e komentuan me ngasjen e tyre të veturave.

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-salam tha: “Nuk do të ndodhë Kijameti para se të shtohet pasuria dhe të teprohet, saqë njeriu do të nxjerrë zekatin e pasurisë së tij e nuk do të gjejë askënd që t’ia pranojë ate dhe (nuk do të ndodhë Kijameti) derisa të shndërrohet toka e Arabisë në kopshte e lumenj.”

Ky shndërrim i Gadishullit Arabik në kopshte dhe lumenj bëhet për shkak të hapjes së kanaleve të shumta dhe shndërrimit të tokës në tokë pjellore në mënyrë artificiale, siç po ndodh sot në Gadishullin Arabik, si p.sh. Arabia Saudite, ku pothuajse e gjithë toka e saj ishte shkretëtirë, sot ka arritur që një pjesë të madhe të asaj toke ta shndërrojë në tokë pjellore dhe sot Arabia Saudite eksporton grurë në vende të ndryshme. Po ashtu me atë sipërfaqe aq të madhe ka arritur që të

gjitha qytetet e saj t'i furnizojë me ujë të detit të përpunuar në ujë të pijshëm. Kështu vepruan edhe vendet tjera të Gadishullit Arabik. Ndoshta hadithi ka për qëllim ndryshimin e klimës në këtë pjesë të botës, e i cili ndryshim klimatik do të ndryshojë edhe tokën shkretinore në tokë pjellore me kopshte dhe lumenj. All-llahu a'ëlem.

FRYRJA E HËNËS SË RE

Transmetohet nga Ibni Mes'udi se Muhammedi alejhis-selam tha: “Shenjë e afrimit të Kijametit është fryerja e hilalit (Hënës së re).”

Muajt islamë llogariten sipas Hënës. Pra, Hëna e re, në formë të drapërit të hollë, simbolizon fillimin e muajit, rumbullakësimi i saj (Hëna e plotë) simbolizon mesin e muajit, derisa të rikthehet nga ka filluar. Pra, Muhammedi alejhis-selam, paralajmëroi se Hëna e re para Kijametit do të duket se ka kaluar dy apo tri netë. Ndoshta për shkak të ndonjë çrregullimi që do të ndodhë në sistemin e saj.

TË FOLURIT E EGËRSIRAVE DHE E GJËRAVE TË NGURTA

Transmetoi imami Ahmed nga Ebi Seid El-Huderij, se ky tha: Një ujk sulmoi një dele dhe e rrëmbeu ate. Bariu (i deleve) i shkoi mbrapa dhe ia mori, e ai (ujku) u ul mbi këmbët e mbrapme të tij, e tha: A nuk i frikësohesh Zotit, ma rrëmbeve rrizkun që Zoti ma afroi mua. Tha (bariu i habitur): Çudi me mua! Ujku i ulur mbi bishtin e tij flet fjalë të njeriut. Tha ujku: A të të lajmëroj diç më të çuditshme se kjo?! Muhammedi alejhis-selam në Jethrib (emri i Medines para emigrimit) u flet njerëzve për lajmet që kanë kaluar. Tha (transmetuesi): Erdh bariu duke shpejtuar me delet e tij derisa hyri në Medine, i la ato në një skaj të qytetit, pastaj shkoi te i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam dhe e lajmëroi për ndodhinë e tij. Atëherë, Muhammedi alejhis-selam urdhëroi të tubohen për namaz, pastaj doli e i tha bariut: “Tregoju atyre (ngjarjen tënde).” E ai ua tregoi. Atëherë tha Muhammedi alejhis-selam: “Të vërtetën e tha (bariu). Beto hem në Atë që shpirti im është në dorën e Tij, nuk do të vijë Kijameti përderisa egërsirat mos t’ju flasin njerëzve, e skaji i kamxhikut t’i flet njeriut dhe lidhëset e këpucëve të tij, dhe derisa të mos lajmërojë kafsha e tij se çka bëri gruaja e tij pas tij.”

Kjo që e paralajmëroi Muhammedi alejhis-selam mund të jetë diç jashtë rregullit natyror, ashtu siç dëshmojnë pjesët e trupit Ditën e ringjalljes, por edhe mund të ketë hadithi për qëllim zhvillimin dhe dituritë që do të arrijë njeriu në të ardhmen sa që do të kuptojë fjalët e kafshëve dhe të gjërave të ngurta siç është: televizioni, radioja etj...

PARAQITJA E NJË KODRE TË ARIT NËN LUMIN EUFRAT

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, radiall-llahu anhu, se ky tha: Tha Muhammedi alejhis-selam: “Gati është Eufrati të zbulojë një thesar me ar, ai që prezenton aty mos të marrë nga ai asgjë.” Në një transmetim tjetër “të zbulojë një kodër me ar”.

Në një transmetim tjetër të Muslimit thuhet: “Nuk do të ndodhë Kijameti derisa të mos zbulojë Eufrati një kodër me ar, për të cilin do të luftojnë njerëzit dhe në njëqind njerëz do të vriten 99-të veta, çdonjëri prej tyre do të thotë: Ndoshta unë do të shpëtoj.”

Siç kuptohet nga hadithi, ajo kodër me ar do të zbulohet pasi të shteret lumi ose zbuluesit e mineraleve do ta zbulojnë atë thesar, ose pasi t’i ndryshohet drejtimi i rrjedhës së lumit për shkaqe të ndryshme e pastaj ai ta zhveshë kodrën nga dheu nën të cilin fshehet ari. Lumi Eufrat buron në Turqi dhe kalon nëpër Irak afër Bagdadit.

RRETHIMI I MUSLIMANËVE NË MEDINE

Transmetohet nga Umeri, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Gati janë muslimanët të rrethohen në Medine..”

Siç kuptohet nga ky hadith, do të vijë dita kur armiqtë e Islamit do t’i rrethojnë muslimanët në Medine. All-llahu a’elem.

PARAQITJA E MBRETIT EL-XHEHXHAH

Transmetoi Muslimi nga Ebu Hurejre, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-salam tha: “Nuk do të ndodhë Kijameti para se të dalë një person nga fisi Kahtan, i cili do t’i ngasë njerëzit me shkopin e tij.”

Në një transmetim tjetër të Muslimit thuhet: “Nuk do të kalojnë ditët dhe netët pa e marrë pushtetin një person që quhet El-Xhehxhah.”

Fisi Kahtan është fis arab, nga i cili kanë prejardhjen arabët. Personi i përmendur në hadithin e dytë, mund të mos jetë personi i përmendur në hadithin e parë, sepse në një transmetim të Termidhiut thuhet se ai është nga joarabët (nga mevalitë).

Në Sahihun e Termidhiut transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-salam tha: “Nuk do të kalojnë dita dhe nata pa e marrë pushtetin një njeri nga mevalitë (muslimanët joarabë) i quajtur Xhehxhah.”

Qoftë një person apo dy persona, hadithi në fjalë sinjalizon se ai do të jetë i fuqishëm, saqë do t’i ngasë njerëzit me shkopin e tij, përkatësisht me fuqinë e tij. Vetë fjala Xhehxhah ka kuptimin: Bërtitës i madh, e kjo cilësi i përshtatet shkopit, por a do t’i ngasë njerëzit ai në hajr apo në sherr, ne nuk kemi për këtë ndonjë sqarim nga Muhammedi alejhis-salam.

TRAZIRA (FITNETI) E AHLASIT, E SERRASË DHE E DUHEJMASË

Transmetohet nga Abdull-llah Ibn Umeri, radiall-llahu anhu, se ky tha: Ishim ulur afër Muhammedit alejhis-selam dhe po përkujtanim trazirat. Ai përmendi shumë nga ato derisa përmendi trazirën e Ahlasit, e njëri tha: Ç'është trazira e Ahlasit? Tha ai: “Ajo është trazira e ikjes dhe e rrëmbimit (të pasurisë e të familjes). Pastaj do të vijë trazira e Serrasë, ardhja e saj apo e liga e saj është nën këmbët e mia, një njeri nga familja ime mendon se është i imi, por ai nuk është i imi, sepse të dashurit e mi janë të devotshmit, pastaj tubohen njerëzit rreth një njeriu sikurse kërdhokulla e brinjëve (është shprehje për një gjë që është jostabile), pastaj do të vijë trazira e Duhejmasë, e cila nuk do të lejë asnjë nga ky ummet që nuk do të goditet, e kur thuhet se u ndërpre, ajo do të zgjatet (do të vazhdojë më tutje), gdhinë, atëherë njeriu besimtar ngrys pabesimtar, derisa të ndahen njerëzit në dy tabore: njëri tabor i imanit pa nifak (dyftyresi), dhe tabori tjetër i nifakut pa fije imani. Kur e gjithë kjo të ndodhë, pritne Dexhxhallin atë ditë apo të nesërmen.”

AHLAS është shumësi i fjalës arabe Hils, që d.m.th. një lloj mbuloje apo pajisje që i vihet deveve prapa shpine deri në fund të barkut. Muhammedi alejhis-selam atë trazirë e përshkruajti me këtë shembull, sepse ajo i shoqëron njerëzit vazhdimisht sikurse e shoqëron ajo pajisje deven kudo që të shkojë. Ajo pajisje, zakonisht, është e zezë, e cila gjë simbolizon errësirën e asaj trazire.

SERRA, në gjuhën arabe, është çdo begati që i gëzon njerëzit, e kjo trazirë u quajt me këtë emër, sepse ajo është shkak i asaj trazire. Kur njeriu ka pasuri dhe begati të mjaftueshme, zakonisht zhytet në mëkate dhe veprime jo të mira.

Kurse DUHEJMA është fatkeqësia që i kaplon njerëzit me sherrin e saj.

ARDHJA E IMAM MEHDIUT

Ekzistojnë një numër i madh i haditheve të vërteta, të cilat paralajmërojnë paraqitjen e një halifi në fund të kohës i cili do të jetë nga familja e Muhammedit alejhis-selam (Ehlul-Bejti). Emri i tij dhe i babait të tij do të jenë të ngjashëm me emrin e Muhammedit alejhis-selam dhe të babait të tij, përkatësisht Muhammed Ibn Abdull-llah. Ai do ta mbulojë tokën me drejtësi meqë ajo është mbushur me mizori, madje Muhammedi alejhis-selam përshkruajti edhe cilësitë e tij trupore e shpirtërore.

Transmetoi Abdull-llah Ibni Mes'udi se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të përfundojë kjo botë para se t'i zotërojë arabët një njeri nga familja ime, emri i tij është i ngjashëm me emrin tim.” Kurse Ebu Davudi e transmeton këtë hadith kështu: “Sikur të mbetet nga kjo dunja vetëm edhe një ditë, do ta zgjaste Zoti atë ditë, që të dërgojë një njeri nga familja ime. Emri i tij dhe emri i babait të tij janë të ngjashëm me emrin tim dhe emrin e babait tim. Ai do ta mbushë tokën me drejtësi sikurse është mbushur ajo me mizori.”

Transmeton Ummi Seleme (njëra nga bashkëshortet e Të dërguarit) se Muhammedi alejhis-selam tha: “Mehdiu është nga familja ime, nga bijtë e Fatimes.”

Ekzistojnë edhe shumë hadithe të tjera të ngjashme me këto.

Ky imam dhe ky halif, do të lindet në mesin e muslimanëve, nga familja e Muhammedit alejhis-selam, dhe do të marrë përsipër çështjen e muslimanëve që t'i udhëheqë ata në rrugën e hajrit.

KOHA E PARAQITJES SË TIJ

Thotë Ibn Kethiri në librin e tij Trazirat dhe luftërat: “...Mendoj se ai do të paraqitet në kohën e zbritjes së Isaut alejhis-selam..”

Hadithet të cilat flasin për zbritjen e Isaut alejhis-selam, bëjnë të kuptojmë, edhe pse jo në mënyrë definitive, se ai do të paraqitet në kohën e zbritjes së Isaut alejhis-selam apo pak para zbritjes së tij, sepse kur Isau alejhis-selam do të zbresë, muslimanët do të jenë të rreshtuar për faljen e namazit të sabahut dhe ai imam (që paramendohet të jetë Mehdiu) dëshiron t’ia lirojë vendin e imamit, por ai e urdhëron të mos lëvizë nga vendi i tij që për të është përgatitur. Zoti e di më së miri.

Në kohën e tij, All-llahu do t’i pasurojë muslimanët shumë. Muhammedi alejhis-selam thotë: “Në fund të ummetit tim do të vijë një halif, i cili do të shpërndajë pasuri pa masë.”

Këto ishin disa nga paralajmërimet të cilat mendojmë se ende nuk janë realizuar, edhe pse kuptimi i vërtetë i disave nga ato është mjaft i vështirë. Kjo është kështu, për arsye se Muhammedi alejhis-selam u foli shokëve të tij me shembuj e fjalë që ata mund t’i kuptonin, sepse

sikur t'u fliste atyre drejtpërdrejt, ata nuk do ta kuptonin. Prandaj, ai u detyrua t'i përshkruajë ato ngjarje të ardhme në mënyrë alegorike apo simbolike dhe me shembuj të ndryshëm.

SHENJAT E MËDHA TË KIJAMETIT KRONOLOGJIA E SHENJAVE TË MËDHA SIPAS REALIZIMIT TË TYRE

Më parë i paraqitëm shenjat e vogla të Kijametit, kurse tani do t'i paraqesim shenjat e mëdha të tij, pas të cilave Kijameti do të ndodhë shumë shpejt. Këto shenja janë shumë më të ndërlikuara dhe më të çuditshme sesa ato që i përmendëm më parë.

Transmeton Muslimi nga Hudhejfe, se ky tha: Erdhi Muhammedi alejhis-salam te ne, derisa ne po përkujtonim njëri-tjetrin (këshillonim), e na tha: “Ç’jeni duke përkujtuar?” Thamë: Po përkujtojmë Kijametin. Tha ai: “Ai nuk do të ndodhë para se të shihni dhjetë shenja”. E i përmendi ato: TYMI, DEXHXHALLI, SHTAZA, LINDJA E DIELLIT NGA PERËNDIMI, ZBRITJA E ISAUT alejhis-salam, JE’XHUXHËT DHE ME’XHUXHËT, TRI SHAFITJET (e tokës): NJË NË LINDJE, NJË NË PERËNDIM DHE NJË NË GADISHULLIN ARABIK NDËRSA E FUNDIT NGA ATO: ZJARRI QË DEL NGA JEMENI, I CILI I DËBON NJERËZIT NË VENDTUBIMIN E TYRE.

Shenjat e mëdha paraqiten njëra pas tjetrës. Ato i ngjajnë varësës, kur këputet fija e saj dhe rruzat bien njëra pas tjetrës.

Muhammedi alejhis-selam paralajmëroi se lufta e madhe ndërmjet muslimanëve dhe romakëve do të ndodhë në fillim, të cilën luftë e quajti kasaphane apo thertore, pastaj muslimanët do ta çlirojnë Konstantinopojën (ky është çlirimi i dytë i Stambollit), ndërsa më vonë paraqitet Dexhxhalli.

Transmetoi Muadh Ibn Xhebeli se Muhammedi alejhis-selam tha: “Ndërtimi i Kudsit (Jerusalem) është shkatërrimi i Jethribit (Medines), shkatërrimi i Jethribit është ndodhja e thertoresh (luftës së madhe), ndodhja e thertoresh është çlirimi i Konstantinopojës dhe çlirimi i Konstantinopojës është dalja e Dexhxhallit.”

Pra, Muhammedi alejhis-selam ka për qëllim se këto ndodhi zhvillohen njëra pas tjetrës.

Pas lajmërimit të Dexhxhallit zbret Isau alejhis-selam dhe në kohën e tij vijnë Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët dhe shkatërrohen po në atë kohë. Deri këtu radhitja është e qartë, kurse radhitja e mëtejshme nuk është e qartë sa duhet, por është e qartë se ato paraqiten pas shkatërrimit të Je’xhuxhëve dhe Me’xhuxhëve. Gjithashtu, është e qartë se zjarri që del nga Jemeni, është shenja e fundit.

Pra, mbetet të dihet radhitja e gjashtë shenjave: lindja e Diellit nga Perëndimi, dalja e shtazës, tymi dhe tri shafitjet e Tokës. Lindja e Diellit nga Perëndimi dhe dalja e shtazës është e qartë se ndodhin pas shkatërrimit të Je’xhuxhëve dhe Me’xhuxhëve, por cila është e para, ne nuk posedojmë njohuri. Kurse sa i përket tymit dhe shafitjeve të Tokës, ne nuk dimë fare se si është radhitja e tyre, sepse hadithet nuk cekin diç të prerë për radhitjen e tyre.

Megjithëatë ne po paraqesim një rënditje të shenjave të mëdha të Kijametit sipas mendimit tonë personal, e All-llahu e di më së miri, e ajo rënditje është kështu: shafitja e parë në Lindje (ajo që

ndodhi në Izmit të Turqisë mund të jetë kjo, All-llahu e di më së miri), shafitja e dytë në Perëndim, shafitja e tretë në Gadishullin Arabik, dalja e Dexhxhallit, zbritja e Isaut alejhis-selam, dalja e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve, tymi i cili përfshinë Tokën, dalja e shtazës, lindja e diellit nga Perëndimi dhe e fundit zjarri i cili shpërthen nga Jemeni.

Është me rëndësi të përmendet këtu, se paraqitja e këtyre shenjave të mëdha nuk është çudi, meqë ato paraqiten para shkatërrimit total të Gjithësisë, si argumente të All-llahut të Gjithëfuqishëm.

1-2-3) TRI SHAFITJET E TOKËS

Më parë përmendëm hadithin e Muhammedit alejhis-selam se: “Nuk do të ndodhë Kijameti para se të shihni dhjetë shenja, e në mesin e tyre 'tri shafitje (të Tokës)': një në Lindje, një në Perëndim dhe një në Gadishullin Arabik..”.

Transmeton Bukajretu se e dëgjoi Muhammedin alejhis-selam duke thënë: “O ju (që jeni të pranishëm), kur të dëgjoni se një ushtri u shafit këtu afër (Medines), Kijameti, veç u afrua, atëherë.”

Ndoshta kjo është shafitja që do të ndodhë në Gadishullin Arabik. Edhe shafitjet tjera të Tokës, siç kuptohet nga ky hadith, do të ndodhin në vende të banuara dhe kjo si shkak i mëkateve njerëzore.

Këto pra janë tri shafitje të mëdha të Tokës, për të cilat njerëzit do të flasin.

4) DALJA E DEXHXHALLIT

Dexhxhalli është trazira dhe sprovimi më i madh në historinë njerëzore.

Dexhxhalli është një person çifut, shenjë e Kijametit, i verbër në njërin sy, trazira më e madhe gjatë tërë historisë njerëzore. Të gjithë të dërguarit i këshilluan popujt e tyre për Dexhxhallin. Ai është Antikrishti i përmendur në gjuhën e Isaut alejhis-selam. Në një ndodhi e cila ndodhi në kohën e Pejgamberit (sal-lAll-llahu alejhi ve sel-lem) me një shokë të tij kuptohet se ai është njeri me jetë të gjatë sepse ky shoku i tij e kishte parë atë në një ishull të largët pasi që e kishin bartur valët e detit një muaj nëpër detë dhe ishte takuar me të në një ishull të vetmuar. Ai kishte biseduar me të dhe nga biseda kuptohet se ai e njeh vetvetën, por pret momentin e caktuar që të dalë, etj.

Transmetoi Buhariu nga Abdull-llah Ibn Umeri, radiall-llahu anhu, se ky tha: “U ngrit Muhammedi alejhis-selam me një rast para njerëzve, e falënderoi All-llahun ashtu si i takon, pastaj përmendi Dexhxhallin e tha: “Unë njëmend, ju këshilloj për të, dhe nuk ka të dërguar që nuk këshilloi popullin e tij për të, por unë do t’ju rrëfej diç për të, që të dërguarit e tjerë nuk ua thanë popujve të tyre: Ai (Dexhxhalli) është i verbër në njërin sy, kurse Zoti nuk është i verbër.”

Në hadithin që e transmetoi Hisham Ibn Amiri, thotë Muhammedi alejhis-selam: “Nuk ka çështje më të madhe, prej krijimit të Ademit e deri në Ditën e Kijametit, sesa çështja e Dexhxhallit.”

Kurse në hadithin që e transmetoi Ebi Uame, thotë Muhammedi alejhis-selam: “O ju njerëz! Njëmend, nuk ka ndodhur ndonjëherë trazirë më e madhe mbi sipërfaqen e tokës, prej se i krijoi All-llahu pasardhësit e Ademit, sesa Dexhxhalli. Nuk ka asnjë të dërguar që e dërgoi All-llahu e të mos e këshilloi popullin e tij për të, dhe unë jam i Dërguari i fundit kurse ju jeni populli i fundit, e ai (Dexhxhalli) do të dalë në kohën tuaj patjetër.”

ÇDO TË THOTË EMRI DEXHALL

Termi Dexhxhall është emër i ndërtuar prej foljes “dexhele”, që don të thotë, ai që gënjen apo mbulon diç, kurse emri në formën Dexhxhall, ka kuptimin: gënjeshtar shumë i madh. U quajt kështu sepse ai do të mashtrojë shumë njerëz, sa që disa nga ata do ta pranojnë si zot të tyre.

GJENDJA E MUSLIMANËVE NË KOHËN E PARAQITJES SË TIJ

Pak para paraqitjes së Dexhxhallit muslimanët do të forcohen dhe do t'i rikthehen Islamit, ndërsa paraqitja e tij, siç duket, realizohet që ta shkatërrojë atë fuqi. Në këtë kohë, muslimanët dhe romakët (të krishterët apo disa vende perëndimore) do të bien në ujdj dhe do të luftojnë bashkë një armik të përbashkët. Në këtë luftë do të fitojnë muslimanët edhe romakët, por pastaj do të nxitet lufta mes muslimanëve dhe të krishterëve.

Transmeton Ebu Davudi nga Dhu Mihberi se Muhammedi alejhis-selam tha: “Do të bëni një marrëveshje paqësore me romakët dhe ju e ata do të luftoni një armik tuajin, do të triumfoni, do të fitoni pasuri dhe do të jeni të sigurt, e pastaj do të ktheheni derisa të zbritni në një mal me kodra të vogla. Atëherë një nga të krishterët ngrit kryqin dhe thotë: Fitoi kryqi. Atëherë hidhërohet një pjesëtar nga muslimanët dhe ia thyen atë. Në këtë moment romakët e shkelin marrëveshjen dhe tubohen për thertoren (luftën, ndërsa muslimanët vrapojnë te armët e tyre dhe luftojnë ndërmjet veti. All-llahu këtë grup (të muslimanëve) e fisnikëron me shehade (shëhidë në rrugën e Zotit).”

Pra, nga ky hadith kuptohet se sa të fuqishëm do të jenë muslimanët në atë kohë.

THERTORJA (LUFTA EL-MELHAMETUL-KUBRA) DHE ÇLIRIMI I KONSTANTINOPOJËS (STAMBOLLIT)

Kjo luftë e madhe do të zhvillohet ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve. Shkak i saj është rasti i përmendur në hadithin e cituar më parë. Ekzistojnë disa hadithe të cilat e përshkruajnë këtë betejë dhe karakteristikat e saj, durimin e muslimanëve dhe triumfin e tyre, si dhe pjesëmarrjen e një numri të madh të të krishterëve me muslimanët, pasi që ata e pranojnë Islamin.

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të vijë Kijameti para se të zbresin romakët në A’emak apo Dabik (dy vende në Siri afër qytetit Haleb). Atëherë, u del atyre përpara një ushtri nga Medina, njerëzit më të mirë mbi tokë atë ditë, e kur të rreshtohen

ata (për luftë), thonë romakët: Lirona rrugën t'i luftojmë ata që na kanë sharë. Thonë muslimanët: Jo, për Zotin, nuk largohemi nga ju e nga vëllezërit tanë, e atëherë, ata luftojnë, një e treta e tyre pëson disfatë, nuk ua falë All-llahu atyre kurrë; pastaj një e treta tjetër vriten, ata janë dëshmorët më të mirë të All-llahu, e një e treta e fundit nuk bien në sprovë asnjëherë dhe ata e çlirojnë Konstantinopojën. Derisa ata ndajnë pasurinë (e luftës) dhe derisa shpatat e tyre i kanë varur në ullinj, bërtet shejtani: Dexhxxhalli ka ardhur te familjet tuaja, e kthehen ata por ajo ishte gënjeshtër. Kur ata arrinë në Sham (Siri), del ai (Dexhxxhalli), e derisa ata janë duke u përgatitur për luftë, i rreshtojnë radhët dhe thirren për faljen e namazit. Zbret Isau, i biri i Merjemes, alejhis-selam dhe u bëhet udhëheqës. Kur armiku i All-llahut (Dexhxxhalli) e sheh atë, tretet si kripa në ujë, e sikur ta linte All-llahu do të tretej krejtësisht, por All-llahu e vret atë nga dora e tij (Isaut alejhis-selam), e ua tregon (muslimanëve) gjakun e tij në bajonetën (armën) e tij”.

Ky është çlirimi i dytë i Stambollit, ndoshta si shkak i fesadit të tij apo sepse ai në atë kohë është nën pushtimin e pabesimtarëve.

Në një hadith tjetër të gjatë kjo luftë përshkruhet si një betejë shumë e madhe, saqë shpezët që fluturojnë në atë nënqiell bien të ngordhura. Ndoshta kjo sinjalizon shpikjen e armëve moderne asokohe, të cilat zhdukin çdo gjë.

është çudi se edhe të krishterët edhe çifutët besojnë në një betejë të tillë. Madje disa kryetarë amerikanë siç është p.sh. Regani, besojnë në këtë ndodhi, duke u mbështetur në librin e Apokalipsës në Dhjatën e Re, ku thuhet: “Atëherë engjëlli e lëshoi drapërin e tij mbi tokë dhe vjeli vreshtën e dheut dhe hodhi rrushin në vozën e madhe të zemërimit të Perëndisë. Dhe voza u

shtrydh jashtë qytetit (të Jerusalemit) dhe nga ajo doli gjak deri te frerët e kuajve, për një mijë e gjashtëqind stade.” (Apokalipsa 14:19-20)

Disa të krishterë thanë se ajo është fusha Mexhdo, apo në arabisht: Sehl (fusha) Mexhidu që gjendet në Palestinë afër Jerusalemit.

THATËSIA DHE URIA QË MBRETËROJNË PARA LAJMËRIMIT TË DEXHXHALLIT

Transmetoi Ibn Maxhe nga Ebi Umame se Muhammedi alejhis-selam tha: “Para daljes së Dexhxhallit janë tri vite të vështira: njerëzit do t’i kaplojë uri e madhe, në vitin e parë All-llahu e urdhëron qiellin ta ndërprejë të tretën e shiut dhe tokën e urdhëron ta ndërprejë të tretën e bimëve të saj; në vitin e dytë urdhëron qiellin të ndalë dy të tretat e shiut dhe urdhëron tokën të ndalë dy të tretat e bimëve të saj; kurse në vitin e tretë urdhëron qiellin ta ndalë shiun në përgjithësi e nuk bie asnjë pikë dhe e urdhëron tokën t’i ndalë të gjitha bimët e saj, e nuk mbinë ajo diç të gjelbër dhe nuk mbetet asnjë vend me barishta dhe çdo gjë do të zhduket, përveç asaj që Zoti dëshiron të mbetet”. Dikush tha: Çka i mbanë njerëzit në jetë ato ditë? Tha: “Tehlili (La ilahe il-l-all-llahu), Tekbiri (All-llahu Ekber) dhe Tahmidi (El-Hamdu lil-lahu), kjo u mjafton atyre nga ushqimi.”

Pra, vëllai im, nga ky hadith kuptojmë se tri vitet para paraqitjes së Dexhxhallit do të jenë vite të urisë dhe të thatësisë së madhe. Andaj, Dexhxhalli do të vijë me mrekulli mashtruese, që do t'i cekim më vonë, kështu që shumë njerëz do ta pasojnë atë.

CILËSITË E DEXHXHALLIT DHE SHENJAT E TIJ

Ai do të pretendojë se është zot dhe do të bëjë gjëra të çuditshme.

Transmeton Ebu Davudi nga Omran Ibn Husajni se Muhammedi alejhis-selam tha: “Ai që dëgjon për Dexhxhallin (se ka dalur) le të largohet, se betohem në All-llahun, do të vijë njeriu tek ai e mendon se është besimtar dhe e pason atë, nga dyshimet që ai ia largon...”

CILËSITË E PËRGJITHSHME

Transmeton Buhariu nga Abdull-llah Ibni Umeri se Muhammedi alejhis-selam e pa Dexhxhallin në ëndërr dhe e përshkruajti kështu: “Njeri i madh (trupmadh), i kuq, me flokë të ngatërruara, me një sy të verbër, syri i tij i ngjashëm me kokrrën e zezë të rrushit, njeriu që më së shumti i përngjan është Ibn Kutn ibni Huza’a.”

VERBËSIA E DEXHXHALLIT

Të gjitha hadithet që e përshkruajtën Dexhxhallin, e përshkruan se është i verbër në njërin sy, sepse kjo është një cilësi që mund ta njohë çdonjëri dhe nuk mund të fshihet. Në disa hadithe thuhet se syri i tij i djathtë është i verbër, kurse syrin e majtë e ka të gjelbër.

Tha Muhammedi alejhis-selam: “Syri (jo i verbër) i Dexhxhallit është i gjelbër si xhami.”

MES DY SYVE TË TIJ SHKRUAN KAFIR

Kjo është një shenjë e veçantë të cilën e vërejnë vetëm besimtarët.

Transmetoi Buhariu nga Enesi, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk është dërguar asnjë i dërguar që të mos ketë këshilluar popullin e tij kundër të verbërit dhe gënjeshtarit. Vëreni, ai është i verbër (në njërin sy), kurse Zoti juaj nuk është i verbër (sepse Dexhxhalli i thotë vetes zot) dhe në mes dy syve të tij është shkruar kafir (pabesimtar).” Kurse në transmetimin e Ebu Umames, thuhet në fund “e lexon atë çdo besimtar, qoftë ai që shkruan apo edhe ai që nuk di të shkruajë”.

Thotë imam En-Neveviu se ky shkrim mes syve të tij, është në të vërtetë, ashtu siç thonë shumica e dijetarëve. Ajo është shenjë e qartë se ai është pabesimtar.

AI NUK LIND FËMIJË

Na lajmëroi Muhammedi alejhis-selam se Dexhxhalli nuk lind fëmijë: “Ai është akim, nuk lind”. Transmetoi Muslimi.

MUNDËSITË E DEXHXHALLIT QË SHKAKTOJNË TRAZIRA

Dexhxhalli posedon disa cilësi të jashtëzakonshme të cilat i bëjnë njerëzit të mashtrohen.

SHPEJTËSIA E LËVIZJES NËPËR TOKË

Transmetohet në Sahihun e Muslimit se Muhammedi alejhis-selam u pyet për shpejtësinë e Dexhxhallit në tokë, e tha: “Sikurse shiun që e ndjekin erërat..”. Gjithashtu ai tregoi se Dexhxhalli do t’i vizitojë të gjitha vendet përveç Mekkes dhe Medines.

Transmeton Ebu Umame se Muhammedi alejhis-selam tha: “.. dhe nuk mbetet asnjë vend në tokë që nuk do ta shkelë, përveç Mekkes e Medines. Kurdo që ai dëshiron të depërtojë nga ndonjë anë e tyre, e ndalin atë melaqet me shpata të ndritura.”

XHENNETI DHE ZJARRI I TIJ

Transmeton Muslimi nga Hudhejfe se Muhammedi alejhis-selam tha: “... Me të (Dexhxhallin) ka xhennet (kopsht) dhe zjarr. Zjarri i tij është xhennet e xhenneti i tij është zjarr.” Në një transmetim tjetër thuhet: “... Me të ka ujë dhe zjarr. Zjarri i tij është ujë i ftohtë kurse uji i tij është zjarr, e mos u shkatërroni.”

Pra, Dexhxhalli është mashtrues tepër i madh, dhe në çdo gjë ai e ndryshon realitetin.

BASHKËPUNIMI I TIJ ME SHEJTANËT

Transmetoi Ebu Umame se Muhammedi alejhis-selam tha: “.. dhe nga sprovimet e tij (Dexhxhallit) është se kur i thotë ndonjë fshatari: Çka thua nëse unë i ringjallë babain dhe nënën tënde, a do të dëshmosh se jam zoti yt?! I thotë ai: Po. Atëherë i paraqitet një shejtan në formën e babait e nënës së tij, e thotë: O biri im! Pasoje ate se ai është zoti yt.”

Pra, nga ky hadith është e qartë se ai i realizon qëllimet e tij të kufrit, në bashkëpunim me djajtë e mallkuar.

MATERIET E NGURTA DHE SHTAZËT I PËRGJIGJEN URDHRI TË TIJ

Transmetoi Muslimi nga En-Nuvas Ibn Seman se Muhammedi alejhis-selam tha: “... Vjen ai te një popull e i thërret ata dhe i besojnë, atëherë, urdhëron qiellin që të lëshojë shiun dhe tokën që të mbijë dhe shtohen shtazët e tyre pa masë, u shtohet qumështi dhe zgjerohen anët e tyre; pastaj vjen te një popull (tjetër) e i thërret ata dhe ia kthejnë fjalën. Largohet nga ata dhe toka e tyre shndërrohet në shkretëtirë, nuk u mbetet asgjë nga pasuritë e tyre, dhe ai (Dexhxhalli) kalon pranë ndonjë vendi të shkatërruar e i thotë (atij vendi): Nxirri thesarët tuaj. E dalin ata sikur grumbulli i bletëve.”

Pra, ai urdhëron qiellin ta lëshojë shiun dhe ai bie (me lejen e All-llahut), e urdhëron tokën të mbijë e ajo mbinë, dhe urdhëron që të dalin thesarët e fshehur nën tokë dhe ata dalin, i thërret shtazët, e ato i përgjigjen urdhrit të tij.

Të gjitha këto All-llahu ia mundësoi atij që ta sprovtojë njerëzimin, se kush prej tyre është dashuruar në këtë botë e kush nuk e ndërron botën e ardhme me asgjë.

VRASJA E NJË TË RIU MUSLIMAN DHE RINGJALLJA E TIJ

Në një hadith të gjatë të cilin e transmetoi Buhariu nga Ebi Seid El-Huderij, Muhammedi alejhis-selam thotë: “...Vjen Dexhxhalli në disa hyrje të Medines, por aty nuk mund të hyjë, kështu që zbret në disa vende jashtë Medines. Atë ditë i del përpara atij një njeri që është më i miri i

njerëzve, e i thotë atij: Unë dëshmoj se ti je Dexhxhalli për të cilin na informoi i Dërguari i Allahut, Muhammedi alejhis-selam. Thotë Dexhxhalli: A do të dyshoni në çështjen time nëse unë e vras këtë tani, dhe e ringjallë përsëri? Thonë ata (ushtria e tij): Jo nuk dyshojmë, e ai e vret atë dhe e ringjall, e i thotë ai (i ringjalluri): Beto hem në Zotin, unë çështjen tënde nuk e kam pasur ndonjëherë më të qartë se sa që e kam sot. Atëherë dëshiron që ta vrasë Dexhxhalli atë përsëri, por nuk mundet.” Në një hadith tjetër tha Muhammedi alejhis-selam: “...Ky (musliman) është dëshmuesi më i madh te Zoti i botëve.”

VENDI I DALJES SË DEXHXHALLIT

Transmetoi Termidhiu nga Ebu Bekri, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Dexhxhalli do të dalë nga një tokë në Lindje, i thuhet asaj Horasan (është në lindje të Iranit në kufi me Afganistanin).”

Por, ai muslimanëve do t’ju paraqitet kur të arrijë në një vend mes Irakut dhe Sirisë, siç transmeton Muslimi nga En-Nuvas Ibn Seman se Muhammedi alejhis-selam tha:

“Ai do të dalë (në ballafaqim me muslimanët) në një vend mes Shamit dhe Irakut dhe do të bëjë fesad djathtas e majtas, o robër të All-llahut përqëndrohuni.”

Pra, fesadi i tij kundër muslimanëve fillon nga vendi mes Irakut dhe Sirisë.

KOHA E QËNDRIMIT TË TIJ NË TOKË

Shokët e Muhammedit alejhis-selam e pyetën ate se sa do të qëndrojë ai në tokë, e tha:

“Dyzet ditë, një ditë si një vit, një ditë tjetër si një muaj, një ditë tjetër si një javë dhe ditët tjera të tij sikurse ditët tuaja.”

Vazhdon të mbetet fshehtësi se çka kishte për qëllim Muhammedi alejhis-selam kur tha “...një ditë si një vit...”, por disa dijetarë u munduan ta sqarojnë atë. Disa nga ata thanë: Fesadin që do ta bëjë Dexhxhalli në tokë për një ditë është sa të tjerët që e bëjnë për një vit, e kështu me radhë. Kurse disa të tjerë thanë: Se paraqitja e tij është nga Lindja dhe ai do të fillojë lëvizjen e tij nëpër tokë, që nga vendet ku nuk ndryshojnë nata dhe dita, dhe vazhdon duke zbritur nëpër vendet islame. Zoti më së miri e di qëllimin.

PASUESIT E DEXHXHALLIT

Dexhxhalli është mbreti, daljen e të cilit e presin çifutët që ta sundojnë botën në kohën e tij.

Transmetoi Imam Ahmedi nga Uthman Ibnul-Asi se Muhammedi alejhis-selam tha: “Shumica e pasuesve të Dexhxhallit janë çifutë dhe gra.”

Emri i Dexhxhallit te hebrenjtë është Mesih Ibn Davud. Ata e presin atë që të vijë në kohën e fundit për ta sunduar tokën e detin, dhe ata mendojnë se ai është argument i Zotit i cili do ta kthejë mbretërinë e humbur të tyre.

DEXHXHALLI NUK MUND TË HYJË NË MEKKE DHE MEDINE

Më parë i cekëm hadithet të cilat sqaruan se Dexhxhalli nuk mund të hyjë në Mekke dhe Medine, sepse ato i mbrojnë melaqet në hyrjet e tyre me shpata të ndritura.

LUTJA ALL-LLAHUT QË TË NA MBROJË NGA DEXHXHALLI

Transmetohet se Muhammedi alejhis-selam e kishte shprehi shumëherë të kërkojë ndihmë prej All-llahut nga fitneti i Dexhxhallit. Gjithashtu, ai na urdhëroi që ta lexojmë fillimin e sures El-Kehf, e posaçërisht nëse e arrijmë kohën e tij, sepse kjo e mbron muslimanin nga ai i mallkuar.

VRASJA E DEXHXHALLIT DHE E PASUESVE TË TIJ

Do ta sqarojmë këtë në shenjën e ardhme të Kijametit: “Zbritja e Isaut alejhis-selam”.

DISA FJALË RRETH DEXHXHALLIT

Disa mendojnë se Dexhxhalli, si dhe disa shenja të tjera, janë vetëm alegori e nuk janë realitet. Pra, vëllai im, ti pate mundësi të vëresh se sa të qarta janë hadithet të cilat flasin për cilësitë e Dexhxhallit, e nuk mund të thuhet se televizioni apo zhvillimet shkencore janë vetë Dexhxhalli, sepse ato kanë paralajmërimet e veta që disa nga ato ne i përmendëm më parë. Pastaj, meqë këto janë shenjat e fundit para një shkatërrimi të përgjithshëm të Gjithësisë, nuk është çudi që All-llahu i Lartësuar i dha ato shenja të asaj katastrofe të madhe. Pastaj, vërejtët se edhe çifutët edhe të krishterët presin ardhjen e këtij Dexhxhalli, por secili me veçori e cilësi të veçanta.

5) ZBRITJA DHE ARDHJA E ISAUT ALEJHIS-SELAM

Thotë All-llahu i Lartësuar në Kur’an se çifutët nuk e vranë Isaun alejhis-selam, por atë All-llahu e ngriti tek Ai:

“Ata (çifutët) as nuk e mbytën e as nuk e gozhduan atë (Isaun alejhis-selam), por atyre u përngjau ashtu (sikurse e vranë). Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së tij), janë në dyshim për këtë (vrasje). Prandaj ata nuk kanë kurrfarë dije përveç supozimit. Dhe ai nuk u vra duke qenë ata të sigurt (se u vra ai apo dikush tjetër). Jo, por All-llahu atë e ngriti tek Ai. All-llahu, njëmend, është i plotfuqishëm dhe i dijsëm.” (En-Nisa: 157:158)

“...dhe ai (Isau) është shenjë e Kijametit..” (Ez-Zuhruf: 61)

“Nuk ka asnjë nga ithtarët e Librit (hebrenjtë dhe të krishterët) që nuk do t'i besojë atij (Isaut) para vdekjes së tij (në kohën para Kijametit), e në Ditën e gjykimit ai do të dëshmojë kundër tyre.” (En-Nisa: 159)

Hebrenjtë nuk i besuan Isaut alejhis-selam se është i Dërguar dhe e përgënjeshtroan atë, kështu që në fund vendosën që ta likuidojnë atë, dhe menduan se njëmend e vranë. Por, ata ranë në dyshim sepse viktimat refuzonte të jetë ai, Isau alejhis-selam, dhe u thoshte se ai i udhëzoi deri te vendi ku është fshehur Isau me apostujtë e tij, kështu që ata ranë në dyshim për vrasjen e tij. Të krishterët u besuan çifutëve se Isau alejhis-selam u vra, por këta u detyruan ta sqarojnë shkakun e vrasjes së tij, kështu që u paraqit Pali idhujtar, armiku më i madh i Isaut, që t'ua shpjegojë qëllimin e vrasjes së tij duke u thënë se ai u vra për mëkatet e njerëzve, etj, etj...

SI ËSHTË REALITETI?!

Kur hebrenjtë vendosën që ta likuidojnë Isaun alejhis-selam, ngaqë ky i shpallte dhe i zbulonte devijimet e tyre, u detyruan të gjejnë një njeri i cili do t'i udhëzonte deri në vendin ku ishte fshehur ai. Në këtë rast, Jehudha (Juda nga Karioti), për të cilin Isau alejhis-selam kishte sinjalizuar se do ta tradhtojë, ishte njeriu më i përshtatshëm që do t'i udhëzonte deri te ai. Hebrenjtë i prematuan atij pasuri. Kur arritën në vendin ku ndodhej Isau alejhis-selam me shokët e tij, All-llahu i Lartësuar e dërgoi Xhibrilin alejhis-selam, që ta ngritë Isaun alejhis-selam nga kjo botë dhe ta vendosë tek Ai, deri në momentin e caktuar kur ai përsëri do të zbresë. Në atë moment, All-llahu i Lartësuar ia ndryshoi pamjen Jehudhës (Judës) dhe e bëri në formën e Isaut alejhis-selam, kështu që ushria e arrestoi atë, por ai filloi të bërtasë dhe t'u thotë atyre se ç'bënin me të? Ai tha: “Unë ju drejtova deri këtu që ta kapni armikun tuaj, kurse ju më arrestoni mua?” Madje edhe ajo ushtri filloi të dyshojë dhe thanë: “Nëse ky është Isau, ku mbeti udhëzuesi ynë, e nëse ky është udhëzuesi ynë, ku mbeti Isau?! Ky, pra ishte dyshimi që lindi në mesin e tyre. Për sqarim më të hollësishëm lexo Dhjatën e Re dhe dyshimet që lindën për vrasjen e Isaut alejhis-selam.

Barnaba në Ungjillin e tij përshkruan shumë bukur se si ndodhi ky rast e si u ngrit Isau alejhis-selam dhe si u tha apostujve të tij se do të kthehet para Kijametit. Aty, thotë Barnaba, edhe ne apostujtë, në fillim kishim besuar se ai u vra, derisa zbriti Isau alejhis-selam te ata dhe u tregoi se si kishte ndodhur, pastaj u ngrit në qiell dhe pret momentin kur do të urdhërohet të zbresë në tokë para Kijametit.

Thotë Barnaba (ky është njëri nga 70 nxënësit e Isaut, shiko Dhjatën e Re) në Ungjillin e tij:

“24) Jezusi (Isau), po ashtu tha: Të vërtetën po ua them, njëri nga ju do të më dorëzojë e do të shitem si dashi. 25) Por, mjer për atë, sepse do të realizohet krejt ajo që tha babai ynë Davidi për të (në Psalme): “DO TË BIE NË GROPËN QË UA PËRGATITI TË TJERËVE”. 26) Në këtë moment shikuan nxënësit (apostujtë) njëri-tjetrin duke thënë me pikëllim: Kush do të jetë tradhtari? 27) Tha, atëherë, Jehudha (Juda): A unë jam ai o mësues?! 28) U përgjigj Jezusi: Ti më the vetë se kush do të më dorëzojë. 29) Njëmbëdhjetë të dërguarit (nxënësit e tjerë) nuk e dëgjuan këtë. 30) Pasi që ai hëngri mishin, i hipi shejtani shpinës së tij dhe doli nga shtëpia duke i thënë Jezusi atij: Shpejto me veprën që ti do ta bësh.

1) Doli pastaj Jezusi nga shtëpia dhe hyri në një kopsht që të falet, ra në gjunj njëqind herë duke vënë kokën në tokë (në sexhde), siç e kishte shprehur gjatë faljes së tij. 2) Meqë Jehudha (Juda) e dinte vendin se ku është Jezusi me nxënësit e tij, shkoi te kryetari i priftërinjve (hebrenj). 3) E i tha atij: Nëse ma jep atë që ma premtove do ta dorëzoj sonte armikun tënd Jezusin, që ju e kërkoni. 4) Sepse ai është i vetmuar me njëmbëdhjetë shokë. 5) Kryetari i priftërinjve iu përgjigj: Sa kërkoni? 6) Tha Jehudha (Juda): Tridhjetë copë të arit. 7) Atëherë ia numëroi kryetari i priftërinjve të hollat menjëherë. 8) Dhe dërgoi një farisej te valiu (qeveritari) Hejrodosi që t'i sillte ushtrinë. 9) Ai ia dha një aradhë të tij, sepse kishte frikë popullin. 10) I morën ata armët e tyre dhe dolën nga Jerusalemi me llamba dhe drita në shkopinjtë e tyre.

1) Kur u afruan ushtarët bashkë me Jehudhën (Judën) te vendi ku ishte Jezusi, u dëgjua ardhja e një grupi të madh. 2) Për këtë shkak, ai (Isau) u kthye në shtëpi i frikësuar. 3) Njëmbëdhjetë nxënësit kishin fjetur. 4) Kur Zoti pa se robi i Tij është në rrezik, i urdhëroi Xhibrilin (Gabrielin), Mikailin, Rufailin dhe Urilin (katër melekët e Tij) që ta ngritnin Jezusin nga kjo botë. 5) Erdhën

melaqet e pastra dhe e morën Jezusin nga dritarja që ishte në anën jugore. 6) E bartën atë dhe e vendosën në qiellin e tretë në shoqërim të melekëve që lavdërojnë Zotin përgjithmonë.

1) Atëherë hyri Jehudha (Juda) me fuqi në dhomën nga e cila ishte ngritur Jezusi. 2) Të gjithë nxënësit kishin fjetur. 3) Atëherë Zoti bëri çudi. 4) Jehudha (Juda) ndryshoi në të folur, në fytyrë dhe u bë i ngjashëm me Jezusin, madje edhe ne menduam se ai është Jezusi vetë. 5) Kurse ai, pasi që na zgjoi, filloi të hulumtojë që të shohë se ku ishte Jezusi. 6) Për këtë arsye, ne u habitëm, e i thamë: Ti je, o zotëri, mësuesi ynë. 7) A na harrove tani? 8) Kurse ai tha duke qeshur: A jeni ju aq të marrë saqë nuk e njihni Jehudhën (Judën) nga Karioti. 9) Derisa ai e thoshte këtë, hyri ushtria dhe e kapën atë, Jehudhën (Judën), sepse ai në çdo aspekt ishte bërë i ngjashëm me Jezusin. 10) Kurse ne, kur dëgjua fjalët e Jehudhës (Judës) dhe pamë grupin e ushtarëve ikëm si të tërbuar. 11) Gjoni që ishte i mbështjellur me një mbështjellëse të pambukut, u zgjua dhe iku, 12) Kur atë e kapë një ushtarë për mbështjellësen e pambuktë, e la mbështjellësen e pambuktë dhe iku i zhveshur. 13) Sepse Zoti kishte dëgjuar lutjen e Jezusit dhe i shpëtoi të njëmbëdhjetët (nxënësit) prej sherrit.

1) Atëherë, e mori ushtria Jehudhën (Judën) dhe e lidhi duke u përqeshur me të. 2) Sepse ai refuzoi të jetë Jezusi - dhe thoshte të vërtetën - 3) Ushtarët i thanë atij duke u përqeshur. Zotëriu ynë, mos ke frikë, se ne kemi ardhur të të bëjmë mbret të Izraelit. 4) Ne të kemi lidhur se e dimë që ti e refuzon mbretërinë. 5) Jehudha (Juda) u përgjigj: A jeni ju të çmendur. 6) Ju erdhët me armë dhe llamba që ta merrni Jezusin e Nazaretit, sikur të ishte vjedhës, e më lidhni mua, që ju drejtova juve, të më bëni mbret! 7) Atëherë ushtarët nuk duruan më dhe filluan ta godasin Jehudhën (Judën) me grushta e shqelma dhe e dërguan me hidhërim në Jerusalem... /Ungjilli i Barnabas: kapitulli 113,114,115,116 dhe 117/

Më poshtë thotë Barnaba: “Betohem në Zotin! Edhe ky që është duke shkruar (unë Barnaba) kishte harruar çdo gjë që kishte thënë Jezusi: se ai do të ngrihet nga kjo botë dhe një njeri tjetër do të dënohet në emër të tij, se ai nuk do të vdesë përveç se afër fundit të botës.” /Kapitulli 117/

Ky Ungjill ishte i fshehur në një bibliotekë të Vatikanit, ndërsa u zbulua në fillim të këtij shekulli. Ai në disa vende paralajmëron ardhjen e Muhammedit alejhis-selam duke e përmendur atë me emër.

Rastin e ngritjes së Isaut alejhis-selam në qiell e përshkruajti po në këtë mënyrë Ibni Kethiri në librin e tij “Rrëfimi i të dërguarve”, por në mënyrë më koncize.

KOHA E ZBRITJES SË TIJ

Do të zbresë Isau alejhis-selam kur muslimanët do t'i kaplojë një bela e madhe dhe kur Dexhxhalli do të bëjë gjithë atë fesad nëpër tokë dhe mundohet t'i shkatërrojë besimtarët në përgjithësi. Atëherë zbret Isau alejhis-selam te Minareja e bardhë në lindje të Damaskut, derisa muslimanët janë të rreshtuar për faljen e namazit.

Transmeton Evs Ibni Evs se Muhammedi alejhis-selam tha: “Zbret Isau alejhis-selam te Minarja e bardhë në lindje të Damaskut.”

Edhe në ditët tona ekziston kjo minare e bardhë në lindje të Damaskut

Në një hadith tjetër që e transmeton Ebu Hurejre, thotë Muhammedi alejhis-selam: “Nuk ka mes meje dhe Isaut të dërguar dhe ai do të zbresë, e kur ta shihni ju atë, njihne: njeri mesatar (me gjatësi), anon nga ngjyra e kuqe dhe e bardhë, zbret mes dy qyteteve, duket koka e tij sikur pikon, por ajo nuk është e lagur.”

Pra, Isau alejhis-selam zbret te Minarja e bardhë në lindje të Damaskut derisa muslimanët përgatiten për luftë në kohën e faljes së sabahut, e ai zbret dhe falet me ta kurse imami është nga ai grup.

Transmetohet nga Xhabiri, radiall-llahu anhu, se Muhammedi alejhis-selam tha: “Një grup nga ummeti im do të vazhdojë të luftojë për të vërtetën, ashtu të qartë, deri në Ditën e Kijametit.” Po ashtu tha: “Zbret Isau, i biri i Merjemes, e i thotë emiri i tyre (muslimanëve): na e fal namazin, por ai i thotë: Jo, ju jeni udhëheqës të njëri-tjetrit, ky është fisnikërim i All-llahut për këtë ummet.” etj.

ME ÇKA DO TË GJYKOJË ISAU ALEJHIS-SELAM PAS ZBRITJES SË TIJ?

Transmetoi Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Si do të jeni ju kur të zbret i biri i Merjemes dhe ju udhëheq me tuajat?” Një nga transmetuesit e hadithit tha: E dini ç'do të thotë “...dhe ju udhëheq me tuajat?” Tha: “I udhëheq me Librin e Zotit tuaj (Kur'anin) dhe me Sunnetin e të Dërguarit tuaj alejhis-selam.”

Pra, Isau alejhis-selam do të jetë një pasues i ummetit tonë dhe do të gjykojë me Kur'anin dhe me Sunnetin e Muhammedit alejhis-selam. është nder për këtë ummet që ta udhëheqë një i dërguar si Isau alejhis-selam, në atë kohë vetëm si një pjesëtar nga ky ummet.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Seidi, Muhammedi alejhis-selam thotë: “I yni është ai, që Isau, i biri i Merjemes falet prapa tij.”

ISAU ALEJHIS-SELAM VRET DEXHXHALLIN

Kjo është puna e parë që do ta bëjë Isau alejhis-selam pas zbritjes së tij. Pas faljes së namazit, ai dhe ushtria muslimane do të drejtohen nga Mesxhidul-Aksaja në Jerusalem, ku Dexhxhalli ka rrethuar një grup të muslimanëve.

Transmeton Ebu Umame se Muhammedi alejhis-selam tha: “...Kur ai largohet, thotë Isa: Hapeni derën (ku janë të rrethuar muslimanët). E hapin atë dhe prapa saj është Dexhxhalli me 70.000 hebrenj, të gjithë ata me shpata (të armatosur) të ngritura dhe me mburoja. Kur ta shohë atë (Isaun) Dexhxhalli, shkrihet sikurse kripa në ujë dhe lëshohet duke ikur, e kapë atë (Isau) te dera lindore Lud (e Jerusalemit) dhe e vret, e i shkatërron All-llahu çifutët.”

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam, pasi që përmendi namazin e Isaut alejhis-selam me muslimanët dhe shkuarjen e tij në Jerusalem, tha: “... Kur armiku i All-llahut e sheh atë shkrihet sikurse shkrihet kripa në ujë, e sikur All-llahu ta lejojë, do të shkrihej në

përgjithësi, por All-llahu e vret atë me dorën e tij (Isaut). Atëherë ua tregon gjakun e tij në bajonetën e tij.”

Fshehtësia në fjalën e Muhammedit alejhis-selam “shkrihet sikurse kripa në ujë” është se: All-llahu i Lartësuar i dha frymëmarrjes së Isaut alejhis-selam një erë të posaçme e cila i bënte pabesimtarët të vdesin kur ajo i përfshinë ata.

Transmetoi Muslimi nga En-Nuvas Ibni Semani se Muhammedi alejhis-selam tha: “..derisa ai është në atë gjendje, All-llahu dërgon Mesihun, të birin e Merjemes, e zbret ai te Minarja e bardhë në lindje të Damaskut, në dy rroba të ngjyrosura, të vendosura shuplakat e tij në krahët e dy melekëve; kur ai ul kokën pikon ajo e kur e ngre atë, bien nga ajo perla si margaritarë (pika të ujit të ngjashme me perlat), e çdo pabesimtar që e arrinë era e frymëmarrjes së tij vdes, e frymëmarrja e tij arrinë aq sa arrin shikimi i tij, e kërkon atë (Dexhxhallin) derisa e zen te dera Lud dhe e vret. Pastaj vjen Isau, i biri Merjemes te ndonjë popull që All-llahu e mbrojti nga ai (Dexhxhalli) dhe ua përshkon fytyrat e tyre dhe ua tregon shkallët e tyre ne Xhennet.”

Isau alejhis-selam e vret Dexhxhallin me dorën e tij, e jo me frymëmarrjen e tij, që të binden njerëzit se Dexhxhalli ishte një njeri i dobët dhe një mashtrues e jo zot, siç pretendonte ai.

ROLI I ISAUT PAS VRASJES SË DEXHXHALLIT DHE PAS SHKATËRRIMIT TË JE'XHUXHËVE DHE ME'XHUXHËVE

Pasi që Isau alejhis-selam e vret Dexhxhallin, në kohën e tij paraqiten Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët, siç do të sqarojmë më poshtë, të cilët do të shkaktojnë çrregullime dhe fesade të mëdha në tokë. Atëherë, Isau alejhis-selam i lutet Zotit dhe të gjithë ata vdesin, saqë asnjë nga ata nuk mbetet, e pastaj Isau alejhis-selam përgatitet për misionin e tij kryesor, për shkak të të cilit, All-llahu e zbriti atë përsëri në tokë: **VENDOSJA E LIGJIT ISLAM NË TOKË, VENDOSJA E LIGJIT TË ALL-LLAHUT DHE SHKATËRRIMI I IDEVE DHE FEVE DEVIJUESE.**

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Betohem në Atë që shpirti im është në dorën e Tij, gati është të zbresë në mesin tuaj i biri i Merjemes, si një gjykatës dhe një i drejtë, e then ai kryqin, e vret derrin, merr fund lufta dhe shtohet pasuria saqë askush nuk pranon atë (sadikanë). Atëbotë, një sexhde është më e mirë (te All-llahu) sesa e tërë bota dhe çka ka në të.” Në një transmetim tjetër shtohet edhe kjo “merr fund urrejtja (mes popujve) dhe zilia”.

Në një hadith tjetër të gjatë, pasi që Muhammedi alejhis-selam përmendi zbritjen e Isaut, vrasjen e Dexhxhallit dhe shkatërrimin e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve, thotë Muhammedi alejhis-selam: “... Pastaj i thuhet tokës (nga ana e All-llahut): mbij frytet tua dhe kthe begatinë tënde. Atë ditë një grup hanë prej një shege dhe mbulohen me gjethet e saj dhe All-llahu e bën të begatshëm qumështin (e shtazëve) derisa (qumështi) i një deveje i mjafton një grupi të madh (njerëzish),

qumështi i një lope i mjafton një fisi dhe qumështi i një deleje i mjafton familjes dhe të afërmve të tyre.”

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË NGA KËTO CITATE PËR ÇËSHTJEN E ISAU ALEJHI-SELAM

1 - SE AI PATJETËR DO TË ZBRESË NË FUND TË KOHËS:

Sepse këtë e vërtetojnë Kur’ani dhe fjalët e Muhammedit alejhis-selam të cekura më parë.

2 - SE ISAU alejhis-selam DO TË VIJË QË TË VENDOSË LIGJIN ISLAM (Ligjin e Allahut) NË TOKË.

3 - AI DO T’I SHKATËRROJË TË GJITHA FETË DHE NUK PRANON ASNJË FE TJETËR PËRVEÇ ISLAMIT, madje edhe xhizjen (tagrën) nuk do ta pranojë:

Ai then kryqin, sepse ai është simbol i fesë krishtere të devijuar të formuar nga Pali; vret derrin të cilin e ndaluan si feja islame ashtu edhe krishtere, d.m.th. ndalohet përdorimi i mishit të tij për ushqim dhe nuk pranon xhizjen.

Transmetoi Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “... Ai lufton njerëzit derisa ta pranojnë Islamin, e then kryqin, e vret derrin, e largon xhizjen dhe në kohën e tij All-llahu zhduk të gjitha fetë përveç Islamit.”

4 - NË KOHËN E TIJ MBRETËRON BOLLËKU, PAQJA DHE SIGURIA:

Më parë përmendëm se si merr fund urrejtja dhe zilia mes popujve, e nuk është çudi se gjithë kjo do të ndodhë kur dihet se edhe të krishterët e presin ardhjen e tij. Prandaj, me ardhjen e tij u zbulohet atyre realiteti dhe pothuajse të gjithë të krishterët i kthehen realitetit dhe fesë së drejtë e të vërtetë. Shiko ungjijtë se sa shumë përshkruajnë ardhjen dhe zbritjen e Isaut alejhis-selam para Kijametit dhe vendosjen e fesë së Zotit në Tokë. Mirëpo, kur them fenë e Zotit, nuk kam për qëllim fenë e Palit dhe të të krishterëve të devijuar, por fenë e vërtetë të All-llahut. Andaj, edhe Isau alejhis-selam qysh në fillim i bashkangjitet atij grupi të muslimanëve që do ta luftojë Dexhshallin, e ndoshta atë ditë me Dexhshallin do të ketë edhe të krishterë që i janë bashkangjitur atij.

SA DO TË QËNDROJË ISAU ALEJHIS-SELAM NË TOKË?

Ai do të jetojë në tokë dyzet vjet siç transmetohet nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha:

“... Qëndron ai (Isau) në tokë dyzet vjet, pastaj vdes dhe ia falin xhenazen e tij muslimanët.”

Në disa hadithe thuhet se ai do të martohet dhe do të varroset mes Muhammedit alejhis-selam dhe Ebu Bekrit, ku ka mbetur një vend vetëm edhe për një varr. Ky varrim pra do të bëhet në Xhaminë e Muhammedit alejhis-selam në Medine.

VLERA E ATYRE QË DO TA SHOQËROJNË ISAUN ALEJHIS-SELAM

Transmetoi imam Ahmedi nga Thevbani se Muhammedi alejhis-selam tha: “Dy grupe nga ummeti im All-llahu i ka ruajtur nga zjarri (i xhennemit). Grupin i cili do ta çlirojë Indinë dhe grupin që do të jetë me Isaun, të birin e Merjemes.”

6) DALJA E JE'XHUXHËVE DHE ME'XHUXHËVE

All-llahu i Lartësuar përmendi një ngjarje që ndodhi ndërmjet Dhul-Karnejnit (ky ishte një profet apo një besimtar i Zotit shumë i afërt) dhe Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve në suren El-Kehf. Politeistët e kishin pyetur Muhammedin alejhis-selam, me inicimin e çifutëve të Medines, për çështjen e Dhul-Karnejnit. Atëherë, All-llahu i zbriti atij një pjesë të sures El-Kehf ku tregohet rrëfimi për të.

“Deri kur ai (Dhul-Karnejni) arriti mes dy kodrave (si penda) dhe pas tyre gjeti një popull që thuajse nuk kuptonte asnjë fjalë (gjuhë përveç gjuhës së tyre). Ata thanë: “O Dhul-Karnejn, njëmend, Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët bëjnë shkatërrime në tokë, a të japim ne ty një pagesë që të na bësh një pendë në mes nesh dhe mes atyre? Ai (Dhul-Karnejni) tha: “Atë që mua ma mundësoi Zoti im është shumë më e mirë (se ajo pagesë që më ofroni ju), por ju më ndihmoni me fuqinë punëtore të bëjë një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre (Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve)! Më sillni copa të hekurit. Kur ai e nivelizoi atë me dy anët e kodrave, tha:

“Ndizeni!” E kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: “Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedh atij!” E ata (Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët) as nuk arritën ta kapërcenin atë e as ta shponin. Ai (Dhul-Karnejni) tha: “Kjo është një mirësi nga Zoti im, E KUR TË VIJ CAKTIMI I ZOTTI (thonë disa komentues se ka për qëllim Kijametin) TIM, AI E BËNË ATË RRAFESH DHE CAKTIMI I ZOTTI TIM ËSHTË I SIGURT. Atë ditë (kur të dalin Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët) ne bëjmë që ata të përzihen si valët njëra me tjetrën. Dhe i fryhet surit e të gjithë ata Ne i tubojmë.” (El-Kahf: 93-99)

“DERISA TË HAPET (penda) JE’XHUXHËT DHE ME’XHUXHËT DHE ATA ZBRESIN NGA ÇDO KODËR ME SHPEJTËSI.” (El-Enbija: 96)

Këto pra ishin ajetet të cilat i përmendin ata popuj. Dhul-Karnejni ishte pra një mbret i fuqishëm, që jetoi në kohën para Isaut alejhis-selam. Ai shëtitu botën në përgjithësi. All-llahu i Lartësuar në këtë ngjarje të tij me Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët na rrëfen se si ai ndërtoi një pendë të lartë dhe të fortë saqë ata me gjithë fuqinë e madhe të tyre nuk mundën ta kalojnë atë. Por, kur do të vijë momenti i caktuar, për të cilin shumica e komentuesve të Kur’anit e komentojnë me afrimin e Kijametit e disa të tjerë thonë se ai është momenti i ringjalljes, kur të vijë ai moment, All-llahu do ta bëjë atë pendë rrafsh dhe ata popuj do të dalin. Atëherë edhe do të shkaktojnë trazira në tokë.

Je’xhuxhët dhe Me’xhuxhët janë dy popuj shumë të mëdhenj dhe me pasardhës të shumtë. Ata janë pasardhës të Ademit alejhis-selam, pra janë njerëz.

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi se Muhammedi alejhis-selam tha: “All-llahu i Lartësuar thotë (Ditën e Kijametit): O Adem! Thotë ai: Si urdhëroni. E i thotë: Dërgo grupin e zjarrit. E thotë ai (Ademi): Ç’është grupi i zjarrit? E i thotë (All-llahu): Prej çdo një mijë e nëntëqindë e nëntëdhjetë

e nëntë veta në xhennem e një në xhennet. Ky është momenti kur plaket fëmija (nga trishtimi) dhe çdo femër me barrë hedh barrën e saj. Tha ai: Me ju janë dy popuj që nuk ishin në asgjë përveç se me numrin e madh të tyre, Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët.”

Muhammedi alejhis-selam tregoi se që në kohën e tij është hapur pak penda e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve. Transmeton Buhariu nga Zejneb binti Xhahshi se Muhammedi alejhis-selam hyri me një rast tek ajo i frikësuar dhe tha:

“La ilahe il-l-all-llahu, mjerë për arabët nga sherri që u është afruar! është hapur sot penda e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve kaq”, bëri një rreth me dy gishtat e parë. Tha Zejnebi (gruaja e tij): I thashë: O i Dërguar i All-llahut, a do të shkatërrohemi derisa në mesin tonë ka të mirë? Tha: “Po, nëse shtohet e keqja.”

Shkatërrimi i tyre do të ndodhë pas zbritjes së Isaut alejhis-selam dhe pas vrasjes së Dexhxhallit. Transmetoi Muslimi nga En-Nuvas Ibni Semani se Muhammedi alejhis-selam, në një hadith të gjatë, tha:

“... Pastaj shkon Isau, i biri i Merjemes, te ndonjë popull që All-llahu e ka mbrojtur nga ai (Dexhxhalli) dhe ua përshkon fytyrat dhe u tregon pozitat e tyre në xhennet. Derisa ata janë në atë gjendje, All-llahu i shpall Isaut se: Unë kam nxjerrë disa robër të Mi, që nuk mund t'i luftojë askush ata, ngriti ti robërit e Mi në (kodrën) Tur. Atëherë All-llahu i dërgoi Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët dhe ata zbresin nga çdo kodër me shpejtësi, kalojnë të parët e tyre afër liqenit Taberije (liqe në Palestinë në kufi me Sirinë) dhe e pijnë atë në tërësi, kurse të fundit e tyre kalojnë aty e thonë: Këtu njëherë kishte ujë. Isau dhe shokët e tij janë të rrethuar (të siguruar në atë kodër)... Atëherë Isau dhe shokët e tij i luten All-llahut, e Ai u dërgon në qafat e tyre

(Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve) krimbat (që gjenden në hundët e deveve e të deleve) dhe gdhinë ata të vdekur si vdekja e një personi. Pastaj Isau dhe shokët e tij zbresin në tokë (nga ajo kodër), e nuk gjejnë asnjë vend në tokë përveçse është i zënë nga dhjami dhe qelbësira e tyre. Atëherë i luten i dërguari i All-llahut, Isau, dhe shokët e tij All-llahut, e Ai i dërgon disa shpezë me qafa të gjata, i marrin ata dhe i hedhin ku All-llahu dëshiron. Pastaj All-llahu dërgon një shi që nuk lë asnjë shtëpi të dheut apo të lëkurave (pa e përfshirë), kështu që e pastron tokën derisa ajo mbetet si pasqyrë.”

Në një transmetim tjetër shton Muslimi se ata (Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët) thanë: “... Vramë të gjithë ata që janë në tokë, e jani t'i vrasim edhe ata që janë në qiell, e hedhin me shtizat (armët) e tyre qiellin, e All-llahu ua kthen ato të përgjakura.”

Transmetojnë Termidhiu, Ibni Maxhe dhe imam Ahmedi se Muhammedi alejhis-salam tha: “Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët gërmojnë (tokën) çdo ditë, dhe gati sa e shohin dritën e diellit, thotë i pari i tyre: Kthehuni se do ta gërmojmë nesër, e rikthen All-llahu atë (tokën) më të vështirë sesa ishte, kështu derisa të vijë koha e tyre dhe dëshiron All-llahu që t'i dërgojë tek njerëzit. E gërmojnë atë gati sa e shohin dritën e diellit, thotë i pari i tyre: Kthehuni se nesër, in sha All-llahu teala, do ta gërmojmë (do ta hapim atë), kështu që ata veçorizuan (thanë in sha All-llahu), e kur kthehen te ai (vendi i gërmimit) e gjejnë sikurse e kishin lënë dje (pas gërmimit). E gërmojnë atë dhe dalin tek njerëzit, e shterin ujin dhe njerëzit mbyllen në kalatë e tyre...” dhe vazhdon hadithi deri në fund.

Ndoshta Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët janë ata që i përmend libri i Apokalipsës në Dhjatën e Re, ku thuhet:

“Dhe kur të kryhen të një mijë vjetët, Satana do të zgjidhet nga burgu i tij. Dhe do të dalë të mashtrojë kombet që janë në të katër anët e dheut, GOGUN dhe MAGOGUN, që t’i mbledhë ata për luftë: numri i tyre do të jetë si rëra e detit, dhe ata do të lëvizin në gjithë sipërfaqen e dheut dhe do ta rrethojnë fushën e shenjtorëve dhe qytetin e dashur. Por nga qielli do të zbresë zjarr, i dërguar nga Perëndia, dhe do t’i përpijë.” (Zbulesa 20:7-9)

Pra vëllai im, ti e vëren se hadithet që flasin për këta dy popuj janë shumë të çuditshme, saqë disa dijetarë u munduan t’i komentojnë në mënyra të ndryshme, duke thënë se ata popuj janë kinezët e japonezët, vetëmse, nga hadithet është vështirë të kuptohet se ata në të vërtetë janë Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët. Gjithashtu, nuk është e qartë se ku janë të vendosur apo ku është vendi i tyre.

Nuk është çudi të jenë ata popuj që ne nuk i kemi parë dhe nuk janë të zbuluar, kur dihet se kjo botë është përplot fshehtësi. Edhe sot e kësaj dite në “Trekëndëshin e Bermudeve” nuk është e qartë se ç’fshihet në të, edhe pse ekzistojnë thënie të ndryshme. Ai është vendi ku u zhdukën njerëz, anije dhe aeroplanë, por megjithatë, askush, përpos All-llahut, nuk e di të vërtetën për atë vend.

Sidoqoftë, dalja e Je'xhuxhëve dhe Me'xhuxhëve është një nga shenjat e mëdha të Kijametit dhe ajo, gjithqysh, do të realizohet kur t’i vijë koha.

7) TYMI (ED-DUHAN)

Nga shenjat e mëdha të Kijametit është tymi i cili do të mbulojë Tokën. Thotë All-llahu i Lartësuar:

“Ti pra, prite (vëzhgo) ditën kur qielli sjell një tym të qartë. Ai (tymi) i mbulon njerëzit. Ky është një ndëshkim i mundimshëm.” (Ed-Duhan: 10-11)

Në temën e mëparshme paraqitëm hadithin e gjatë të Muhammedit alejhis-selam në të cilin përmendi dhjetë shenjat e Kijametit, e në mesin e tyre përmendi edhe tymin.

Ibn Kethiri duke e komentuar këtë ajet tha se kjo shenjë është afër Kijametit dhe përmendi një hadith të transmetuar nga Malik El-Eshariu, i cili tha:

Tha i Dërguari i All-llahut, Muhammedi alejhis-selam: “Njëmend, Zoti juaj ju këshillon për tri gjëra: Për tymin, i cili besimtarin e kap si flama, kurse pabesimtarin e fryn saqë i del ai nga çdo venddëgjim i tij. E dyta është shtaza kurse e treta Dexhxhalli” (këtë hadith e transmetoi Ibn Xheriri).

Thotë imam En-Neveviu duke e komentuar hadithin e dhjetë shenjave të Kijametit, e kur përmendi tymin, tha: “Ky hadith përkrah thënien e atyre që thanë se: ky tym ua merr shpirtin pabesimtarëve, kurse besimtarin e kap si flama. Kjo shenjë ende nuk është paraqitur por ajo do të ndodhë pak para Kijametit.”

8) DALJA E SHTAZËS

Kjo shtazë do të paraqitet në fund të kohës. Ajo është një nga mrekullitë e All-llahut dhe do të paraqitet kur të shtohen sherri dhe fesadi. Këtë shtaze All-llahu e përmendi në Kur'an, ku thotë:

“E kur fjala (Ime) u bie atyre (njerëzve), Ne do t'u nxjerrim atyre një SHTAZË nga toka që do t'u flasë atyre (njerëzve): se, njëmend, njerëzit nuk ishin të bindur në argumentet (dhe Kur'anin) Tona.” (En-Neml: 82)

Ky pra është ajeti i Kur'anit që paralajmëroi daljen e asaj shtaze para Kijametit. Pa dyshim, kjo shtazë nuk është e ngjashme me shtazët që jemi mësuar t'i shohim, sepse kjo u flet njerëzve, i këshillon ata dhe u tregon se ata nuk besuan në argumentet dhe fjalët e Zotit.

Në fillim të shenjave të Kijametit përmendëm hadithin ku Muhammedi alejhis-selam ceku dhjetë shenjat e mëdha të Kijametit, e në mesin e tyre ishte edhe “dalja e shtazës”.

Transmetojnë Imam Ahmedi dhe Buhariu nga Ebu Umame se Muhammedi alejhis-selam tha: “Do të dalë shtaza dhe do t'u vë shenja njerëzve në hundët e tyre, dhe jetojnë ata në mesin tuaj, dhe kur njeriu blenë deven pyetet. Nga kush e bleve? E thotë: E bleva nga një njeri me shenjë në hundë.”

Transmetoi Talha nga Ibni Umeri, radiall-llahu anhu, në një hadith të gjatë, e tha: E përmendi Muhammedi alejhis-selam shtazën, e tha: “Ajo gjatë tërë kohës ka tri dalje. Njëherë ajo del larg në shkretëtirë (në fshatra të largëta) dhe ajo nuk përmendet në Mekke (nuk dëgjojnë për daljen e saj), fshehet një kohë të gjatë, pastaj del edhe njëherë dhe përmendet ajo në fshatra dhe në Mekke”.

Tha Muhammedi alejhis-selam: “Pastaj, derisa njerëzit janë në xhamitë më të mëdha të Zotit, e më e ndaluara dhe më fisnikja në mesin e tyre El-Mesxhidul-Haram (Qabja), nuk është larg nga ata kur ajo fillon të pëllet mes ruknit dhe mekemit (brenda në Qabe) e shkund kokën e saj, e njerëzit ikin nga ajo në çdo anë, përveç një grupi të besimtarëve që e kishin të qartë se nuk mund t’i ikin All-llahut. Ajo fillon me ata dhe ua ndritë fytyrat e i bënë ato sikurse ylli ndriçues, pastaj fillon të lëvizë nëpër tokë, nuk mund ta zë atë ai që e kërkon dhe nuk i shpëton asaj ikësi, saqë njeriu lutet në namaz kundër saj e ajo i vjen mbrapa e i thotë: O filan, a tani falesh?! I afrohet ai asaj e i vë ajo atij një shenjë në fytyrën e tij, pastaj largohet. Njerëzit bëjnë tregti dhe shoqërohen në qytetet e tyre, njihet besimtari nga jobesimtari, e thonë: O besimtar, ma jep hakun tim..”

Në disa hadithe përshkruhet se kjo shtazë është e krijuar nga pjesë të ndryshme të shtazëve. Sidoqoftë, neve na intereson se ajo është shenjë dhe mrekulli e All-llahut që do të paraqitet para Kijametit dhe se ajo do t’ua ndritë fytyrat besimtarëve dhe do t’u vë shenja të posaçme pabesimtarëve në hundë e do t’i lajmërojë njerëzit se ishin mohues të argumenteve të All-llahut.

9) LINDJA E DIellit NGA PERËNDIMI

Thotë All-llahu i Lartësuar në Kur’an: “... Në ditën kur vijnë disa shenja të Zotit tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i tij nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë në besimin e tij kurrfarë të mire.” (El-En’am: 158)

Thonë komentuesit e Kur'anit se All-llahu me këtë ajet ka për qëllim, posaçërisht, lindjen e Diellit nga Perëndimi, sepse kur njerëzit ta shohin këtë shenjë të madhe besojnë, por, atë ditë nuk i pranohet besimi askujt.

Transmetoi Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Ai që pendohet para se të lind Dielli nga Perëndimi, do t'ia falë All-llahu atij. E kur Dielli lind nga Perëndimi mbyllet dera e pendimit.”

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të vijë Kijameti para se të lind Dielli nga Perëndimi i tij, e kur ai lind dhe njerëzit e shohin atë, besojnë të gjithë, ai është momenti kur askujt besimi nuk i bënë dobi nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka fituar asnjë të mirë në besimin e tij.”

Transmetohet nga Hudhejfe se tha: E pyeta të Dërguarin e All-llahut, e i thashë: O i Dërguar i All-llahut! Cila është shenja e lindjes së Diellit nga Perëndimi? Tha Muhammedi alejhis-selam: “Zgjatë ajo natë derisa duket sa dy netë, zgjohen atë natë ata që e kishin shprehur të faleshin dhe veprojnë sikurse vepronin më parë. Yjet nuk duken, janë fshehur nga vendet e tyre, pastaj ata bien e zgjohen përsëri për t'u falur, pastaj bien e zgjohen prapë, dhe kështu derisa u lodhet trupi atyre dhe u duket ajo natë e gjatë. Atëherë, njerëzit fillojnë të frikësohen që nuk gdhinë, e derisa presin lindjen e Diellit nga Lindja e tij kur ai lind nga Perëndimi, kur njerëzit ta shohin besojnë (të gjithë) por nuk u bënë dobi besimi i tyre..”

Lindja e Diellit nga Perëndimi, siç kuptohet nga këto tekste, është realitet e jo siç mendojnë disa se kjo do të thotë se: Perëndimi do të përparojë, kurse Lindja do të mbetet në errësirë, etj..

Ky është një çrregullim në sistemin diellor apo të Tokës që do të ndodhë para Kijametit. All-llahu është për çdo gjë i fuqishëm.

SHKATËRRIMI I QABES NGA DORA E DHUS-SUVEJKATEJNIT

Para Kijametit do ta shkatërrojë Qaben një njeri nga Etiopia i quajtur Dhus-Suvejkatejn. U quajt kështu ndoshta sepse nëngjunjtë e këmbëve i ka të shkurtra. Dhus-Suvejkatejn në gjuhën arabe i thuhet atij që i ka nëngjunjtë e këmbëve të shkurtra. Këtë shenjë të Kijametit e shënojmë këtu, sepse siç vërehet nga hadithet, ajo do të ndodhë me shenjat e fundit të Kijametit.

Transmetoi imam Ahmedi nga Abdull-llah Ibni Umeri se Muhammedi alejhis-selam tha: “Do ta prishë Qaben Dhus-Suvejkatejni nga Etiopia (Habeshi), ia merr zbukurimet e saj, ia heq mbulesën asaj, e sikur unë e shikoj atë, një qeros dhe i shtrembëruar (në shpinë), e godet atë me (mjetet) fshirëset dhe gërmueset e tij.”

Transmeton Buhariu nga Ibn Abbasi se Muhammedi alejhis-selam tha: “Sikur e shikoj atë (shkatërruesin e Qabes), i zi dhe me këmbë të shtrembëruara (bajmak), e prish atë gurë për gurë.”

Nëse thotë dikush se si lejon All-llahu të shkatërrohet Qabja, kurse në Kur’an Ai thotë se atë e bëri vend të sigurt? Përgjigjja është se ajo është vendi i sigurt deri afër Kijametit dhe shkatërrimit të botës, e pastaj edhe ajo do të shkatërrohet.

ZHDUKJA E ISLAMIT, NGRITJA E KUR'ANIT DHE ZHDUKJA E NJERËZVE TË MIRË

Përmendëm më parë se në kohën e Isaut alejhis-selam, Islami do të përfshijë gjithë botën dhe do të gjykohet me Ligjin e Kur'anit. Por, pas Isaut alejhis-selam Islami do të fillojë të dobësohet derisa ngrihet në përgjithësi së bashku me Kur'anin nga kjo botë dhe me njerëzit e mirë e besimtarë. Kështu Kijameti do të ndodhë mbi njerëzit me të këqij të cilët nuk shqiptojnë as fjalën All-llah.

Transmetoi Ibni Maxhe nga Hudhejfeja se Muhammedi alejhis-selam tha: “Do të fshihet Islami (nga mendja e njerëzve) sikurse fshihet stolia e rrobës, saqë nuk do të dihet se çka është agjërimi, namazi, kurban, sadakaja dhe do të bartet Kur'ani në një natë dhe nuk do të mbetet në Tokë nga ai asnjë ajet, dhe mbesin disa grupe të njerëzve, e plaku i vjetër thotë: I kemi takuar baballarët tanë duke thënë këtë fjalë “la ilahe il-l-all-llah” dhe ne e themi.”

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre se Muhammedi alejhis-selam tha: “All-llahu do të dërgojë një erë nga Jemeni më të butë se mëndafshi, nuk do të lë asnjë që në zemrën e tij ka iman sa pesha e një thërmije pa ia marrë shpirtin.”

Në hadithin që e transmetoi Enesi, radiall-llahu anhu, Muhammedi alejhis-selam thotë: “Nuk do të ndodhë Kijameti derisa në Tokë thuhet: All-llah, All-llah.”

Pra, këto janë momentet e fundit para shkatërrimit të Gjithësisë, por, All-llahu një herë do t'i marrë të gjithë shpirtrat e atyre që në zemrën e tyre kanë besim sa pesha e një thërmije, e pastaj

në Tokë mbeten njerëzit më të këqij, të cilët nuk dinë se ç'është e mira, nuk thonë as All-llah dhe martohen nëpër rrugë sikur shtazët, e mbi ta pra, bëhet Kijameti.

Por, para se të ndodhë Kijameti mbi ata njerëz, ata do t'i rikthehen adhurimit të idhujve siç ishte në kohën e injorancës.

Thotë Muhammedi alejhis-selam se këtyre njerëzve u paraqitet shejtani e u thotë: A nuk më përgjigjeni? Thonë ata: Çka na urdhëron? E i urdhëron ai t'i adhurojnë idhujt. Atëherë, i fryhet Surit (bririt) derisa ata janë duke kërkuar rrizkun e tyre.

10) ZJARRI QË I TUBON NJERËZIT

Kjo është shenja e fundit nga shenjat e mëdha të Kijametit, sepse Muhammedi alejhis-selam në hadithin e tij ku përmendi dhjetë shenjat e mëdha të Kijametit tha: "...dhe e fundit nga ato, është zjarri që del nga Jemeni, i cili i tubon njerëzit në vendtubimin e tyre (në mahsher)."

Toka në të cilën do t'i tubojë njerëzit ky zjarr, është toka e Shamit (vendet e Shamit janë: Palestina, Siria, Jordania dhe Iraku).

Transmetoi Ebu Dherri se Muhammedi alejhis-selam tha: "Shami është toka e tubimit dhe vendi i zgjerimit."

Në një hadith tjetër Muhammedi alejhis-selam sqaroi se ky zjarr (vullkan i madh siç duket) nuk u lë vend njerëzve, kudo që ata ndalen ai i arrinë derisa të tubohen në vendet e Shamit.

FUNDI I KËSAJ BOTE APO DITA E KIJAMETIT

Nuk kam për qëllim këtu të përshkruaj mënyrën e Kijametit apo të shkatërrimit të Gjithësisë, sepse kjo është një temë e veçantë për të cilën mund të shkruhet një libër. All-llahu i Lartësuar në shumë ajete të Kur'anit e përshkroi si një ditë të trishtueshme dhe shumë të vështirë, saqë femija plakët atë ditë. Ekzistimi i shumë emrave të Ditës së Kijametit në Kur'an, argumenton se ajo është një ditë e vështirë. Të gjithë ata emra janë cilësi tmerruese të asaj dite. Nuk ka dyshim se All-llahu atë ditë do t'i mbrojë besimtarët e Tij dhe do t'ua bëjë këtë ditë të lehtë. Fjala është pas ringjalljes, kurse vetë Kijametin e përjetojnë vetëm njerëzit më të këqij të atyre ditëve.

Transmetoi Abdull-llah Ibni Umeri se Muhammedi alejhis-selam tha: “Nuk do të bëhet Kijameti derisa All-llahu mos të dërgojë një erë e cila nuk le pa i marrë shpirtin askujt që në zemrën e tij ka iman sa peshja e thërrmijës; pas kësaj çdonjëri (nga ata që mbesin) i kthehet adhurimit të atyre që baballarët e tyre adhurorin në kohën e injorancës (adhurimit të idhujve), e mbesin disa njerëz si pluhuri që nuk urdhërojnë në të mira e as nuk pengojnë nga e keqja, martohen në rrugë sikurse shtazët, e kur kjo e tëra të ndodhë, shtohet hidhërimi i All-llahut ndaj tyre dhe mbi ta e bënë Kijametin.”

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E DISA SHENJAVE TË KIJAMETIT TË ARDHURA NË HADITHET SAHIHE (TË VËRTETA), HASEN (TË MIRA) DHE DAIFE (TË DOBËTA)

- * Muhammedi alejhis-selam tregoi se çka ka ndodhur dhe çdo të ndodhë, përmendi luftërat e ndodhitë tjera derisa hynë banorët e xhennetit në xhennet dhe banorët e xhehennemit në xhehennem.
- * Çdo ditë e ardhme është më e keqe se ajo që kalon derisa ta takojmë Zotin tonë.
- * Lindja është burimi i trazirave, prej atje lind briiri i shejtanit dhe koka e kufrit dhe atje ndodhin dridhje të shumta.
- * Do të ndodhin trazira të mëdha. Ai që është ulur është më i sigurt se ai që është në këmbë, e ai që gjenë ndonjë vend për t'u fshehur, le të fshehet.
- * Trazira që janë si pjesët e netëve të errëta, gdhinë njeriu besimtar e ngrysë pabesimtar, e shet fenë e vet për një plaçkë të kësaj bote dhe ai që pak është i kapur për fenë është sikur ai që mban gacën e zjarrit në dorën e tij.
- * Trazirat u paraqiten zemrave, vdesin mendjet sikurse vdesin edhe trupat në kohën e fundit; shtohet dëshira dhe preokupimi, e pothuajse nuk sheh asnjë njeri të mençur; nuk e njohin hallallin e as haramin ata që i kanë përfshirë ato trazira në kohën e fundit.

- * Trazirat e grave e mundojnë të pasurin dhe e rëndojnë të varfërin, ua humbin mendjen burrave, nuk ka sukses një popull që emëron për udhëheqës të tyre gruan, dhe do të shkatërrohen burrat kur t'ju nënshtrohen grave.
- * Trazirat e pasurisë, zgjerimi i kësaj bote (paraqitja e pasurisë së saj) dhe garimi për të, hapja e thesarëve, nënshtimi i njerëzve njëri-tjetrit dhe shkatërrimi i tyre me dinarin e derhemit, ngritja e shtëpive dhe zbukurimi i tyre.
- * Paraqitja e dy lloj njerëzve: Të parët mbajnë në dorën e tyre një shkop të ngjashëm me bishtin e lopës dhe i rrahin njerëzit, dhe të tjerët janë gra të mbuluara por në të njëjtën kohë të zbuluara (sepse veshin rroba të ngushta dhe të tejdukshme), kokat e tyre i ngjajnë kurrizit të deveve.
- * Afër Kijametit shtohet homoseksualizmi, kurvëria, alkooli, femrat, pakësohen burrat, kryhen vepra amorale në rrugë dhe vizitohen njerëzit që të bëjnë imoralitet.
- * Në kohën e fundit nuk turpërohet njeriu nga kurvëria dhe ajo bëhet haptas në rrugë siç veprojnë gomarët.
- * Në kohën e fundit nuk respektohet nëna, internohet babai, nuk respektohet gruaja, shkëputen marrëdhëniet farefisnore.
- * Para Kijametit shtohen vdekjet e rastit (pika në zemër), dridhjet e Tokës, marrja e mendjes, afrohet koha (për shkak të shpikjeve të mjeteve transportuese), ngrihet dituria (ka për qëllim diturinë e pastër fetare), xhamitë bëhen vende parakaluese (kalojnë afër tyre njerëzit e nuk hynë të falen në to).

- * Pakësimi i të mirëve dhe shtimi i të këqijve, Islami bëhet si i huaj (garib) dhe ai përkufizohet në Mekke dhe në Medinë.
- * Njerëzit falen, agjërojnë, kryejnë Haxhxin, por ata nuk janë muslimanë, e lënë Sunnetin (rrugën e Muhammedit alejhis-salam) pak nga pak, dhe do të falen njerëz që nuk kanë aspak moral dhe vepra të mira.
- * Do të shkëputen nyjet e Islamit gradualisht, xhamitë e tyre të ndërtruara e të zbukuruara, por të prishura nga udhëzimi; dijetarët e asaj kohe janë më të këqijtë në atë nënqiell; nyja e parë e Islamit që shkëputet është FRIKA (ndaj All-llahut) e thujse nuk sheh asnjë njeri që i frikësohet Atij; e quajnë veten muslimanë, kurse ata janë shumë larg Islamit.
- * Do të vijnë trazira të shurdhëta, të verbëta dhe memece që do t'i shkatërrojnë arabët dhe persianët, të vrarët e tyre janë në zjarr.
- * Në Basra të Irakut ndodhin shafitje të Tokës, gjuajtje (nga qielli), dridhje dhe deformime të njerëzve në majmunë e derra dhe u dalin banorëve të Irakut dhe të Kufes nga tokat e tyre.
- * Lumi Eufrat zbulon një kodër me ar dhe zbulohen minerale afër Hixhazit (Mekkes e Medines), vriten njerëzit për to.
- * Gadishulli Arabik shndërrohet në lumenj dhe kopshte, shtohen vrasjet dhe luftërat.
- * Të folurit e shtazëve dhe e gjërave të ngurta.
- * Ai që është i lidhur për Islamin, në kohën e fundit, ka shpërblimin e 50 shokëve të Muhammedit alejhis-salam dhe 100 shehidëve dhe ai është i ngjashëm me atë që ka zjarrin

në dorën e tij; ibadeti në kohën e trazirave dhe luftërave është si emigrimi te i Dërguari alejhis-selam (në kohën e tij).

- * Vërsulja e popujve kundër muslimanëve sikur tubohen ngrënësit rreth pjatës, humb vëllazërimi fetar, urrehen zemrat dhe nga armiku nxirret frika ndaj këtij ummeti.
- * Në kohën e fundit shtohen luftërat, luftëtari nuk e di se për çka lufton dhe i vrari pse është vrarë; shtohen dridhjet e Tokës dhe trazirat.
- * Nuk do të ndodhë Kijameti para se muslimanët t'i luftojnë mongolët dhe turqit, si dhe përmendja e cilësive të tyre.
- * Ky ummet nuk shkatërrohet nga tufani (vërshimet e ujit) dhe nuk mund t'i shkatërrojë ata ndonjë armik, por ata shkatërrojnë njëri-tjetrin (me luftërat e përçarjet ndërmjet veti).
- * Luftimi i çifutëve dhe fitorja e muslimanëve, thertorja (luftë e madhe); çlirimi i Konstantinopojës dhe dalja e Dexhxhallit ndodhin brenda shtatë muajve.
- * Në kohën e fundit lajmërohen disa të rinj që lexojnë Kur'anin, dalin nga feja si shtiza nga harku; në vrasjen e tyre ka shpërblim të madh; humbet Islami saqë nuk dihet se çka është namazi, agjërimi, zeqati etj.; saqë njeriu fyhet për shkak të namazit të tij siç fyhet lavirja.
- * Lindja e dallimeve, e lidhjeve dhe animeve si dhe e oportunitizmit; trazira e zezë dhe shkelja e marrëveshjeve.

- * Do të zhvillohen luftëra të mëdha e tmerruese të cilat nuk do të lënë asgjë përpara; derdhet gjaku dhe grabitet pasuria dhe familja, nuk kanë ku të ikin njerëzit nga ato, emrat e tyre dhe numri i tyre.
- * Paraqitja e udhëheqësve ateistë dhe devijues, zemrat largohen nga ata dhe rrëqethen lëkurët nga mizoria e shfrenimi i tyre.
- * Paraqitja e risive në fe dhe e sekteve të shumta të cilat ndjekin epshtet dhe devijimet e tyre; do të vijnë njerëz që nuk turpërohen nga All-llahu, zemrat e tyre janë të huaja dhe gjuhët e tyre janë gjuhë të arabëve.
- * Ummeti Islam do të ndjek rrugën e popujve të mëparshëm, nëse ata hynë në vrimën e hardhucës këta do t'i pasojnë; emitimi i tyre në veshje e ushqim dhe urrejtja e fesë.
- * Shkuarja e dijetarëve, gjykimi i injorantëve, lejimi i haramit e ndalimi i hallallit, pirja e alkoolit, paraqitja e kurvërisë dhe rrënimi i Islamit.
- * Në krye të çdo 100 vjetëve All-llahu dërgon reformator që përmirëson gjendjen fetare dhe e reformon atë dhe ummeti i Muhammedit alejhis-selam nuk bashkohet në devijim. Një grup i muslimanëve janë deri në fund në të drejtë, ata janë në Sham rreth Mesxhid El-Aksas.
- * Mosrespektimi i vlerave dhe i pikëpamjeve fetare, si dhe i ritualeve fetare, ngritja e fëmijës kundër të vjetrit, bërja keq fqjuit.
- * Përsëritja vetëm e atyre që i njohim; lirimi i grave (nuk u jepet kurrfarë vlere njerëzore) dhe i kuajve dhe nuk shtrenjtohet më deri në Ditën e Kijametit.

- * Do të paraqiten në kohën e fundit njerëz që kanë trupin e njerëzve e zemrat e djajve, janë ujqër që nuk kanë pikë rahmeti, derdhin gjakun e plakut, gruas e femijës.
- * Fiset i udhëheqin njerëzit dyfytyrë të tyre; zbukurimi i xhamive dhe i mihrabeve, leximi i Kur'anit vetëm për zë melodik e mosaplikimi i tij.
- * Do të vijë dita që besimtari të bëhet edhe më i nënshtruar se robëresha, lëvizë i fshehur; nuk dijnë njerëzit të mirën dhe tretet zemra e besimtarit në mbrendësi nga të këqijat që sheh.
- * Islami do të ekzistojë deri në fund dhe një grup i tij do të luftojë në të drejtë, nuk i pengon asgjë ata.
- * Do të rriten popuj na ky ummet në begati; me rëndësi për ta është barku i tyre, llojet e ushqimit dhe të veshjeve, ata janë njerëzit më të këqij.
- * Në kohën e fundit falen 1000 persona në xhami, asnjë nga ata nuk është besimtar, falen, agjërojnë, bëjnë haxhxin dhe flasin çka nuk kanë dëgjuar baballarët e tyre, ruaju nga këta mos të të devijojnë.
- * Ngritja e ndërtesave, të zhveshurit e të zbathurit bëhen të parët e njerëzve; përçarja e vëllezërve dhe djegia e Qabes.
- * Emërtimi i alkoolit me emra të ndryshëm, shtimi i homoseksualitetit dhe dhunimi i fëmijës siç dhunohet femra, si dhe shtimi i fëmijëve të zinasë.

- * Nuk mbetet askush pa e shfrytëzuar kamatën; edhe ai që nuk e pranon atë nuk mbetet pa u zhytur me të; zeqati bëhet tregti dhe nuk mërzitet njeriu se nga e fiton pasurinë.
- * Afrimi i kohës dhe i tregjeve, lindja e lakmisë së madhe.
- * Do të vijë koha kur nuk do të urdhërohet në të mira dhe nuk do të pengohet nga e keqja; Sunneti (i Muhammedit alejhis-selam) llogaritet risi ndërsa risia Sunnet, degjenerohen rinia dhe femrat; pushtetin e marrin të rinjtë, të vjetrit merren me imoralitet dhe njerëzit mendjelehtë merren me dituri.
- * Kur dikush bën ndonjë mëkat, thotë: All-llahu është i mëshirshëm, ma falë; nuk ndjejnë kënaqësi kur lexojnë Kur'an.
- * Gjëja e parë që ngrihet nga njerëzit është amaneti dhe turpi, kurse e fundit është namazi; do të falen njerëzit që s'kanë aspak vlerë e moral.
- * Do të vijë koha kur njerëzit nderohen për dituri (siç duket ka për qëllim shkollat e universitetet, në të cilat kalojnë të gjithë nxënësit), mësojnë jo që të punojnë me atë që mësojnë dhe nuk kanë për qëllim Zotin, por vetëm fitimin e interesin, shtohen dijetarët por nuk ka dobi nga ata.
- * Në kohën e fundit kalon njeriu pranë varrit e shpreson të jetë në te nga trazirat që ndodhin.
- * Në kohën e fundit shtohen xhamitë, por nuk gjejnë imam të falet me ta, e ata që janë, flasin atë që nuk e punojnë.

- * Do të ndodhin ngjarje shumë të mëdha, do të pyesin njerëzit njëri-tjetrin: A i përmendi Muhammedi alejhis-selam këto? Kodrat do të lëkunden prej vendit, devet nuk do të përdoren më për bartjen e gjërave.
- * Në kohën e fundit njerëzit nuk njihen ndërmjet veti dhe vrasin njëri-tjetrin mizorisht.
- * Do të vijnë njerëz që duhen me gjuhë e urrehen me zemra, me gjuhë janë vëllezër, kurse me zemra janë armiq, dhe i frikësohen njëri-tjetrit.
- * Në kohën e fundit do të ndërtohet Mekka dhe do të mbushet me banorë dhe ndërtesat e saj do t'i kalojnë kodrat e saj, edhe Medineja po ashtu.
- * Ndërtimi i Jerusalemit është shkatërrimi i Medines, shkatërrimi i Medines është ndodhja e thertoresh, ndodhja e thertoresh është çlirimi i Konstantinopojës dhe kështu derisa të vijë Isau alejhis-selam.
- * Një ushtri do ta sulmojë Qaben, por kur i afrohen shafiten të gjithë në Tokë, ajo ushtri është nga popuj të ndryshëm.
- * Shkaktimi i një zjarri të madh në Jemen dhe ikja e njerëzve drejt Shamit nga ai zjarr.
- * Në kohën e fundit do të paraqiten shumë gënjeshtarë, që e quajnë veten të dërguar dhe flasin gjëra të çuditshme. Mjerë ata që u besojnë.
- * Prej shenjave të Kijametit është që mbretërit bëjnë Haxhxin për shëtitje, të pasurit për tregti kurse të varfërit që ta shtrijnë dorën.
- * Në kohën e fundit do të paraqitet një yll apo planet me bisht.

- * Shtohet hidhërimi dhe njeriu nuk e di a është besimtar apo jobesimtar, lindja e zilisë, kërkimi i kësaj bote me vepra të ahiretit, fshehja e dëshmisë dhe dëshmimi i rrejshëm, përhapja e mitës dhe blerja e vendimeve dhe gjykimeve.
- * Shtimi i forcave të sigurisë (policore), përhapja e lapsit dhe e librave, pakësimi i shiut.
- * Paraqitja e njerëzve që pretendojnë dashurinë e familjes së Muhammedit alejhis-selam (Ehlul-Bejtit) të cilët refuzojnë Islamin dhe janë larg nga ai, siç thotë Aliu, radiall-llahu anhu: Ata pretendojnë dashurinë tonë, kinse ndjekin rrugën tonë, kurse nuk zbatojnë urdhrat tona.
- * Do të vijnë njerëz që e teprojnë me zbulimin e zërit gjatë leximit të Kur'anit, kurse ata nuk punojnë sipas tij dhe nuk e lexojnë atë sikurse të parët.
- * Do të vijnë njerëz që do ta refuzojnë Sunnetin, e do të thonë: ne punojmë vetëm me atë që është në Kur'an; ata kanë devijuar dhe të tjerët i devijojnë.
- * Ngritja e ajeteve të Kur'anit, saqë në Tokë nuk mbetet asnjë ajet.
- * Romakët (me fjalën romakë gjithmonë mendohet në shtetet e Perëndimit, apo vendet që i përfshinte Perandoria Romake), do të jenë më të shumtit para Kijametit.
- * Njerëz më të këqij janë ata të cilët do ta përjetojnë Kijametin.
- * Do të vijë koha kur njeriu që thotë: All-llah, All-llah, do të vritet, dhe do të lind një armiqësi ndërmjet Irakut dhe të huajve (joarabëve) dhe ndërmjet romakëve dhe banorëve të Shamit,

pastaj lajmërohet imam Mehdiu, që është nga familja e Muhammedit alejhis-selam, e mbushë Tokën me drejtësi sikurse ishte mbushur me mizori para ardhjes së tij.

- * Para Kijametit muslimanët do ta çlirojnë Romën dhe qytetin që gjysma e tij është në ujë e gjysma e tij në tokë.
- * Dhe paraqitja e dhjetë shenjave të mëdha të Kijametit dhe ndodhive të tyre mahnitëse, siç i përshkruam më parë.

Kjo ishte vetëm një përmbledhje e shkurtë e disa shenjave dhe lajmeve të kohës së fundit. Dijetarët islamë të cilët i përmbloodhën në përgjithësi këto shenja i përmbloodhën në disa vëllime, siç është p.sh. libri “Përmbledhje e lajmeve të kohës së fundit dhe shenjat e Kijametit” të dijetarit Abdull-llah El-Mishali etj.

Ne me këtë libër kemi për qëllim të paraqesim vetëm një përshkrim të përgjithshëm të atyre shenjave, që besimtari musliman ta dijë se ai jeton të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen, si dhe të ruhet që mos të zhytet në ato trazira të paralajmëruara.

Lutja ime e fundit është “I gjithë falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve” dhe paqja e Tij qoftë mbi Muhammedin alejhis-selam, mbi familjen e pastër të tij dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Kijametit.

FJALA E FUNDIT

Kjo ishte një pasqyrë dhe një vështrim i shenjave dhe i paralajmërimeve të Kur'anit të madhërishtëm e të Muhammedit alejhis-selam, që do të ndodhin para Ditës së Kijametit.

Çka pas gjithë kësaj?

Ne, si muslimanë, duhet të përfitojmë nga këto paralajmërime dhe të ruhem i qetë që mos të zhytemi në to. Njëherit, ato paralajmërime na paralajmërojnë se çfarë nuk duhet bërë dhe çka duhet vepruar. Andaj, përmendëm më parë se si Hudhejfe e pyeste Muhammedin alejhis-selam shumë për ato, që të ruhet nga shërra të tyre dhe të mos bie në atë kurthë. Disa nga ato paralajmërime na e mësuuan rrugëdaljen nga ato trazira, kështu që kur Hudhejfe e pyeti Muhammedin alejhis-selam se si të gjejë rrugëdaljen, i tha: “PËRMBAJU XHEMATIT TË MUSLIMANËVE DHE IMAMIT TË TYRE”.

Gjithashtu, nga këto paralajmërime kuptojmë se Islami dhe muslimanët do të dobësohen dhe bota do të prishet, por, në të njëjtën kohë nga ato mësojmë se Islamit përsëri do t'i rikthehet fuqia dhe autoriteti që kishte më parë, e poaqërisht në kohën e ZBRITJES SË ISAUT alejhis-selam, kur Islami do të zotërojë në tërë botën.

Të gjitha këto paralajmërime e shenja do të realizohen me urdhrin e All-llahut, ashtu siç u realizuan ato të shekujve të kaluar dhe disa nga ato po realizohen sot në ditët tona. E gjithë kjo dëshmon se kjo fe njëmend është fe e lartë, është fe e Zotit, është feja e kohës së fundit dhe është fe e vërtetë. Andaj, atë duhet ta kuptojmë seriozisht, ta praktikojmë në jetën tonë të përditshme, ashtu siç kërkon Islami. Pra, ne nuk duhet të mbështetemi dhe të presim se kur do të realizohen

këto shenja, por duhet të angazhohemi me të gjitha mundësitë tona për lartësimin e kësaj feje, sepse ne përgjigjemi për veprat tona. All-llahu dhe paqja e Tij qoftë me Muhammedin alejhissalam, familjen e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij.